

VONESAT NE
ARSYETIMIN DHE DORËZIMIN
E VENDIMEVE GJYQËSORE

VITI 2014
EDICIONI I DYTË I VLERËSIMIT

Botim nga
Qendra për Çështje të Informimit Publik
INFOÇIP

Tiranë, 5 maj 2015



Botim nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOCIP

© copyright: Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOCIP,
10 Maj, 2015

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Materiali që përmban ky publikim mundet vetëm
të citohet me kusht që të njihet autorësia e tij përmes referimit të plotë të atributeve
(© copyright, data e botimit, shtëpia botuese, autorët, ISBN, etj).

Një kopje e publikimit që përmban materialin e rishtypur/referuar duhet t'i dërgohet INFOCIP.
Çdo përdorim i metodës, të dhënavë teorike apo gjetjeve sasiore në këtë studim, për qëllime komerciale ose
jo-komerciale nga të tretë është i ndaluar dhe subjekt penalizimi ligjor.

Drejtor i research-it & autor i metodës:

Gerti Shella

Koordinatore të grupit monitorues:

Arlinda Selmani
Gejsi Ndoja

Përpunimi i të dhënavës dhe vizualizimi grafik"

Sereta Ylli
Gerti Shella

Design Layout

Altin Aliaj

Imazhi në Korpertinë:
Në pritje të zbardhjes së vendimit

Shtypur në Tiranë nga:
ISBN:

U realizua në kuadër të projektit:

"Vonesat në arsyetimin dhe shpalljen e vendimeve gjyqesore-2"



Ky projekt është mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) në kuadër të programit
Shteti i së Drejtës

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të OSFA-s.

PERMBATJA

KAPITULLI 1- OBJEKTI, LEGJITIMITETI & GJETJETE MONITORIMIT	7
MBI OBJEKTIVAT E STUDIMIT	9
BAZA LIGJORE PËR ARSYETIMIN DHE DORËZIMIN E VENDIMEVE	15
KAPITULLI 2 - GJYKATATE ZAKONSHME & GJYKATA E LARTE	27
GJETJETE MONITORIMIT, GJYKATA E LARTE E RSH	29
GJETJETE MONITORIMIT, GJYKATA E APELIT, TIRANË	41
GJETJETE MONITORIMIT, GJYKATA E FAKTIT, TIRANË	51
GJETJETE MONITORIMIT, GJYKATA E FAKTIT, DURRËS	59
KAPITULLI 3 - GJYKATAT ADMINISTRATIVE	67
GJETJETE MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT	71
GJETJETE MONITORIMIT, GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES PARE, TIRANË	75
SHKURT MBI METODOLOGJINË	79
KAPITULLI 4 - COMPENDIUM / VENDIME TE KLD	81
VENDIM I KLD NR. 44, DATË 15.04.2014	92
VENDIM I KLD NR. 45, DATË 15.04.2014	100
VENDIM I KLD NR. 62, DATË 28.05.2014	104
VENDIM I KLD NR. 65, DATË 28.05.2014	113
VENDIM I KLD NR. 104, DATË 21.07.2014	121
VENDIM I KLD NR. 105, DATË 21.07.2015	131
VENDIM I KLD NR. 18, DATË 04.02.2015	143

LISTA E SHKURTIMEVE

AP – Avokati i Popullit

FZ – Fletore Zyrtare

GJEDNJ – Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

KiE – Këshilli i Europës

GJK – Gjykata Kushtetuese

GJL – Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë

GJA – Gjykata e Apelit

GJSHP – Gjykata e Shkallës së Parë

VGJK – Vendim i Gjykatës Kushtetuese

VUGJL – Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë

VKB – Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

KM – Këshilli i Ministrave

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

MD – Ministria e Drejtësisë

KB – Kolegjet e Bashkuara

QBZ – Qendra e Botimeve Zyrtare

KPrC – Kodi i Procedurës Civile (në disa raste: **KPC**)

KPrP – Kodi i Procedurës Penale (në disa raste: **KPP**)

RSH – Republika e Shqipërisë

INFOÇIP – Qendra për Çështje të Informimit Publik

FALENDERIME

Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOÇIP, falenderon kryetarët e gjykatave që targetoi ky vlerësim tematik, të cilët mirëpritën ekipet monitoruese dhe lejuan akses në të dhënat që administron gjykata, posaçërisht ato që lidhen me dorëzimin e vendimeve.

INFOÇIP falenderon veçanërisht kryetarin e Gjykatës së Lartë të RSH, Z. Xhezair Zaganjori për sensin e lartë të bashkëpunimit dhe hapjes ndaj aktorëve të shoqërisë civile të cilët monitorojnë punën e gjykatave. Po ashtu, INFOÇIP i shpreh mirënjojen e thellë edhe kreut të Gjykatës së Apelit, Tiranë, z. Alaudin Malaj për mirëkuptimin dhe lehtësitetë e jashtëzakonshme që ai krijoi gjatë implementimit të këtij studimi.

Një falenderim i veçantë shkon për kryetarin e Gjykatës Administrative të Apelit, Z. Kastriot Selita si dhe për kryetarin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, Z. Eriol Roshi, të cilët mirëpritën dhe akomoduan ekipet e INFOÇIP për të përbushur detyrat e ngarkuara. Bashkëpunimi i ofruar prej tyre ka qenë ekselent dhe mjaft i singertë.

INFOÇIP falenderon edhe sekretaritë e gjykatave që targetoi ky studim, për gjithë ndihmën dhe bashkëpunimin e ofruar në mbledhjen e të dhënave. Personeli i sekretarive gjyqësore u tregua gjithmonë i disponueshëm, pavarësisht presionit të kohës dhe ngarkesës së punëve të përditshme.

Një falenderim i fundit, por i pari për nga rëndësia, shkon për Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (SOROS) i cili mbështeti për të dytin vit rradhazi realizimin e këtij monitorimi, nga më voluminozës dhe më të rëndësishmit sot për sot që i behet performancës së gjyqësorit nga aktorë të pavarur të shoqërisë civile.

KAPITULLI I

OBJEKTI, LEGJITIMITETI
&
GJETJET E MONITORIMIT

1. Vendimet gjyqësore duhet të janë të arsyetuara.
2. Gjykata e Lartë duhet t'i botojë vendimet e saj si dhe mendimet e pakicës.
3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

Neni 142. Kushtetuta e Shqipërisë

MBI OBJEKTIVAT DHE RISITË E VLERËSIMIT TEMATIK, 2014

NGA GERTI SHELLA

DREJTOR I STUDIMIT

Për të dytin vit rradhazi, INFOÇIP ka vlerësuar dorëzimin e vendimeve gjyqësore në raport me afatet që cakton ligji procedural në RSH. Ky përbën një nga vlerësimet tematike më të rëndësishme sot për sot në RSH, si në terma të gjetjeve ashtu edhe në terma të volumit të dhënavë të përpunuara, të cilat kapërcejnë me disa-fish ato të institucioneve të specializuara shtetërore.

Për të realizuar të gjitha vlerësimet për vitin 2014, INFOÇIP disponoi dhe përpunoi 15235 vendime gjyqësore. Kjo është një shifër jashtëzakonisht e lartë dhe cakton një rekord të ri të procesimit të të dhënavë zyrtare për efekt monitorimi në Shqipëri. Të gjitha të dhënat janë disponuar në hard copy dhe janë procesuar elektronikisht në sistemet e inxhinieruara nga ekspertët e INFOÇIP.

Objekt vlerësimi për vitin 2014 kanë qenë gjykatat më të rëndësishme në vend, konkretisht Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit, Tiranë dhe Gjykata e Faktit, Tiranë. Për herë të parë, INFOÇIP ka zgjeruar gjeografinë e monitorimit duke përfshirë edhe Gjykatën e Faktit Durrës, një tjetër gjykatë kjo shumë e rëndësishme.

Për herë të parë sivjet, INFOÇIP ka përfshirë në vlerësimin e vitit 2014 edhe gjykatat administrative. Kjo është një risi absolute. Objekt monitorimi mbi afate e dorëzimit të vendimeve u bënë Gjykata Administrative e Apelit, e vetme

në llojin e saj, si dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë. Kjo e fundit është edhe më e rëndësishmja ndër 6 gjykatat administrative të vendit.

Vlerësimi tematik 2014 për vonesat në dorëzimin e vendimeve është i pasur edhe në risi të tjera. Për herë të parë është realizuar një analizë e detajuar krahasuese mes treguesve të vitit 2013 dhe 2014 për gjykaten e Faktit Tiranë, Gjykaten e Apelit Tiranë si dhe për vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Vend të posaçëm në këtë analizë krahasuese kanë zënë edhe vendimet unifikuese të GJL, jo vetëm sa i takon arsyetimit dhe zbardhjes së plotë të tyre, por edhe botimin në fletore zyrtare. Baza krahasuese për këtë lloj vlerësimi është vendosur që në vitin 2011 dhe përllogaritjet e vonesave ofrojnë mundësi për analizimin e trendit dhe për të dalë në konkluzione solide sa i takon përmirësimit apo përkeqësimit të gjendjes.

Për herë të parë INFOCIP e pasuron këtë vlerësim tematik me instrumente të reja metodologjike, të tilla si **Treguesi DAV** (Dorëzimi në Afat i Vendimeve). Ky i fundit realizon matje të hollësishme si mes treguesve vjetore brenda një gjykate, ashtu edhe të treguesve të bashkëmatshëm midis dy apo më shumë gjykatave të ndryshme të të njëjtit lloj (*psh midis G.J.F.Tiranë dhe G.J.F. Durrës*).

INFOCIP, me ekspertizën dhe përvojën e gjerë të krijuar, synon t'i vijë në ndihmë së pari trupës gjyqësore në R.SH, duke i dhënë mundësi kësaj të fundit të njihet me rezultatet e këti vlerësimi. Ndryshe nga vonesat në procesin gjyqësor, ku palët kanë një ndikim shumë më të shprehur, arsyetimi dhe dorëzimi i vendimit gjyqësor implikon vetëm gjyqtarin apo trupin gjykues. Në këtë proces gjyqtari është përballë vetvetes dhe përgjegjësia për vonesa eventuale është vetëm e tij/tyre.

Të dhënat sasiore janë përpunar në mënyrë të tillë që të mundësojnë përmes atributeve të vendimit edhe identifikim e emrit korrespondues të gjyqtarit apo trupës gjyqësore që e ka dhënë atë. Ky ushtrim mund të realizohet fare mirë nga cilido i interesuar përmes rakordimit të dhënave të INFOCIP me arkivat e vendimeve gjyqësor online që administrohen nga gjykatat e targetuara. Kjo është një përmasë e re vlerësimi, që kapërcen hermetizmin që karakterizon në përgjithësi organet shtetërore që kanë për detyrë inspektimin e performancës profesionale të trupës gjyqësore.

Po ashtu, një tjetër avantazh i rëndësishëm i metodës dhe qasjes vlerësuese të INFOCIP është kontrolli abstrakt dhe jo incidental i vonesave në arsyetimin



dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore (2013 dhe 2014). Kjo qasje e diferencon atë nga metodat verifikuese që përdoren rëndom nga inspektoriatet e KLD dhe të MD, të cilat vihen në lëvizje si rregull pas marrjes së sinjaleve për parregullsi, ose përmes planizimit jo-sistematik.

Kapaciteti i lartë në marrjen, hedhjen dhe përpunimin e të dhënave përvlerësimë tilla e pozicionon bindshëm INFOÇIP si partner krah inspektoriatit të KLD dhe atij të MD. Vlerësimi një për një i 15235 vendimeve gjyqësore nga INFOÇIP në një periudhë më të shkurter se 5 muaj flet vetë përfuqinë e lartë procesuese të operatorëve të specializuar të shoqërsë civile në Shqipëri, të cilët janë gati të marrin dhe të ushtrojnë përgjegjësi më të mëdha, për ta bërë sistemin gjyqësor më të përgjegjshëm përmes mbikqyerjes së vazhdueshme.

Inspektoriatet e KLD dhe të MD janë të latur që të disponojnë të dhënat që bëhen publike në këtë raport dhe, pasi t'i verifikojnë dhe konsolidojnë ato, të ndërmarrin veprimet e nevojshme për adresimine problematikës së identifikuar. INFOÇIP shpehet e gatshme t'u vendosë atyre në dispozicion të gjithë bazën materiale që ka në dispozicion për një rakordim të plotë të çdo verifikimi nga ana e tyre sit ë gjetjeve tona, ashtu edhe të dhënave kritike për trupën gjyqësore.

Thënë kjo, INFOÇIP garanton paanshmëri dhe objektivitet në vlerësimin e afateve të dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Gjetjet e paraqitura në këtë raport vlerësimi janë të hapura për t'u verifikuar nga cilido aktor i interesuar.

E fundit, por jo për nga rëndësia është fakti i aplikimi për herë të parë si mjet përmarrjen e informacionit në gjykata të ligjit të ri 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Të gjitha të dhënat për vitin 2014 të mbledhura në dy gjykatat administrative, u morën përmes depozitimit të kërkesës për informim. Vlen të theksohet se gatishmëria e të dyja gjykatave për të përpunuuar dhe dorëzuar informacionin e kërkuar nga INFOÇIP ka qenë maksimale dhe është vërtet për t'u përshëndetur. Kjo shënon edhe aplikimi e parë direkt të ligjit 119/2014 përmarrje të informacionit nga gjykatat administrative.

Shpresojmë që analizat dhe vlerësimet e këtij studimi voluminoz, të realizuar nga INFOÇIP në bashkëpunim me ekspertë dhe profesionistë të njojur të sistemit gjyqësor, të shërbejnë si një instrument efikas për autoritetet përgjegjëse në organet e drejtësisë, në orientimin më të mirë të përpjekjeve të tyre në përmirësimin e sistemit gjyqësor. Po ashtu, INFOÇIP shpreson që gjetjet e këtij monitorimit të meritojnë vëmendjen e medias, por edhe të aktorëve të shoqërisë civile shqiptare, që punojnë me përkushtim çdo ditë përritjen e eficiencës së gjyqësorit në Shqipëri.



Mbi problematikën e vonesave në dorëzimin e vendimeve gjyqësore

Problematika e shpalljes me vonesë të vendimeve gjyqësore ka gjetur trajtim në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. Këto gjykata kanë theksuar se mos-shpallja e vendimeve brenda afateve të arsyeshme bie në kundërshtim me ligjin procedural dhe cënon të drejtën kushtetuese të të gjykuarit për ankim dhe akses në gjykatë, për shkaqe që rrjedhin nga gabimet në veprintarinë e vetë organeve shtetërore. Sipas GJK, shpallja e vendimit përfundimtar të arsyetuar është detyrim ligor me pasojë pavlefshmërinë e tij.

Arsyetimi ligor i vendimit është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligor i cili ka për qëllim: a) ushtrimin e kontrollit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë dhe b) ushtrimin e kontrollit publik në administrimin e drejtësisë. Të dy këta elementë lidhen ngushtësisht me të drejtën e ankimit të subjektit procedural pasi kontrolli gjyqësor nuk ushtrohet në mënyrë incidentale, por mbi bazën e shkaqeve të ngritura nga palët në proces. Kufizimi në kohë i së drejtës së ankimit lidhet me përcaktimin jo vetëm të detyrimit të gjykatës për ta arsyetuar vendimin përfundimtar por edhe dorëzimin e vendimit në sekretarinë gjyqësore.

Trajtim edhe më të hollësishëm të këtij problemi ofron jurisprudanca e GjEDNj-së, ku, për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e një gjyqi është apo jo e arsyeshme, duhet të merret parasysh e gjithë periudha nga momenti i depozitimit të kërkesë-padisë deri sa vendimi merr formë të prerë (depozitohet në sekretari). Një zgjatje e tepruar nga seanca e fundit deri në nxjerrjen e një vendimi të arsyetuar mund të cënojë të drejtën e gjykimit pa vonesa të panevojshme dhe të pengojë mundësinë e palëve për të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën e ankimit. Në rastin e Shqipërise kjo e fundit është e parashikuar nga nen 43 i Kushtetutës.

Pavarësisht kësaj jurisprudence, prej vitit 2010, INFOCIP kishte konstatuar vonesa sistematike në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve unifikuese nga trupa e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Këto janë vendimet më të rëndësishme të Gjykatës së Lartë, pasi normojnë praktikën e shqyrimit gjyqësor për të sistemin e gjykatave në RSH. INFOCIP ekspozoi edhe raste flagrante ku vonesat në arsyetimin e plotë të vendimeve të Kolegjeve të bashkuara ishin bërë shkas që persona konkretë të kishin qëndruar padrejtësisht në burg, vetëm për shkak të vonesës në zbardhjen dhe ekzekutimine vendimit gjyqësor të GJL

Pavarësisht rasteve flagrante të ekspozuara, vemendja mediatike dhe me aktorëve të drejtësisë ishte “e vakët” deri në 13 shtator 2012, kohë në të cilën

ndodhi vrasja tragjike e komisarit të policisë Adem Tahiri nga shtetasit I. Xhakja. Nga verifikimi që organet e hetimit dhe MD i bënë rrethanave që çuan në këtë krim të rëndë, u evidentua dhe fakti i mos-apelimit prej prokurorisë të një çështjeje penale në proces, në ngarkim të shtetasit I.XH.

Nga vlerësimet rezultoi se, edhe pse kishte përfunduar shyrtimi i çështjes penale në ngarkim të këtij të fundit tij në Gjykatën e Faktit Durrës, dorëzimi i vendimit në sekretarinë gjyqësore ishte vonuar me 1 viti, 7 muaj e 5 ditë; vetë shqyrtimi gjyqësor kishte zgjatur më pak, rrëth 1 vit e 7 ditë. Hetimi nxorri në pah se vonesa të ngjashme ishin aplikuar edhe në rrëth 60 dosje të tjera të shqyrtuara nga i njëjtë gjyqtar .

Duke vendosur në sfond rrethanat e mësipërme, në vitin 2013 INFOÇIP nisi implementimin e një vlerësimi tematik të posaçëm me objekt vonesat në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore. Metoda e hartuar nga INFOÇIP ishte autentike, “e qepur” pas trupit të dispozitave ligjore në kodet e procedurës penale dhe civile. Vlerësimi bëhen nëj për një ndaj të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna në periudha kohore ndër të cilat më e vogla ishte 4-muaj, kurse më e larta 1 vit. Kjo eleminonte kampionimin rastësor me 30-40 vendime, dhe mbi të gjitha ishte e aftë të identifikonte vendime konkrete të cilat ishin dorëzuar në shkelje të fateve procedura Brenda periudhës në të cilën realizohej vlerësimi. Avantazhet e këtij lloji vlerësimi ishin të padiskutueshme.

Për të realizuar këtë lloj vlerësim, paraprakisht ishte i domosdoshëm identifikimi me saktësi i dispozitave në korpusin e brendshëm ligjor (kode dhe ligje) të cilat përcaktojnë afatet e arsyetimit/dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Veçimi i tyre dhe adresimi korrekt i mangësive të hasura ishte një tjetër objektiv parësor i botimit të parë.

Domosdoshmëria e shpalljes së vendimeve gjyqësore brenda afateve kohore të arsyeshme është adresuar edhe nga Raport Progresi i Komisionit European për Shqipërinë, për vitin 2013. Në Kapitullin 23 të këtij dokumenti “*Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut*”, theksohet se *vendimet gjyqësore dorëzohen të paarsyetuara dhe në shumicën e rasteve shpallen pas një vonese të konsiderueshme¹*.

Tiranë,

5 Maj, 2015

¹ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/al_rapport_2013_en.pdf (page 38, para.7)

LEGJITIMITETI I MONITORIMIT, 2014

BAZA LIGJORE PER ARSYETIMIN & DOREZIMIN E VENDIMEVE GJYQESORE NË R.SH.

1. GJYKATAT E SHKALLES SE PARE

Procesi i shqyrtimit gjyqësor në gjykatat e shkallës së parë normohet posaçërisht nga Kodi i Procedurës Penale (më poshtë: KPrP) dhe Kodi i Procedurës Civile (KPrC). Ky ifundit, në rreth gjysmën e neveve të tij, rregullon gjykimin në shkallë të parë (nenet 153-439¹). Sipas nenit 308 (para.2) të KPr.C, *në çështje të ndërlikuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se 10 ditë. Gjykata mund shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në 5 ditë*. Sipas një arsyetimi interpretues të nenit 308, në procesin e dhënisë së një vendimi gjyqësor përfundimtar, presupozohet se gjyqtari **duhet ta shpallë atë të arsyetuar dhe, të nënshkruar, ta dorëzojë menjëherë në sekretari**. Në qoftë se çështja është e ndërlikuar, dhe të tilla sigurisht që ka, gjyqtari ka dy alternativa: **1-** të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit dhe ta dorëzojë vendimin të arsyetuar brenda dhjetë ditëve ose, **2-** ta shtyjë shpalljen e vendimit por, brenda pesë ditëve, ta shpallë atë të arsyetuar.

Gjithsesi, rapporti midis dispozitave të fjalisë së parë dhe të dytë në nen 308 është disi i errët, po të mbahet parasysh se afati 10 ditor (rregulli i përgjithshëm) është shterruar përmes formulimi. Një pyetje që mund të kërkojë përgjigje përrastin përjashtimor është se në cilin moment gjykata e kërkon shtyrjen edhe me 5 ditë të shpalljes së vendimit të arsyetuar: *para apo pas shterrimit të afatit 10 ditor?*

K.Pr.C përcakton se *vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese* (neni 310²). Në pjesën përshkruese-arsyetuese

1 Pjesa e dytë, "Gjykimi Në Shkallë Të Parë", Kodi i Procedures Civile, Version i Perditesuar, Tetor 2013

2 Neni 310 Shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 122/2013, nen 2, KODI I PROCEDURËS CIVILE I R.SH.,

Miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 dhe ndryshuar me ligjet nr.8431, datë 14.12.1998; nr.8491, datë

27.5.1999; nr.8535, date 18.10.1999; nr.8812, datë 17.5.2001; nr.9953, datë 14.7.2008, nr.10 052, datë

29.12.2008, nr. 122/2013 dhe ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative



duhet të përmenden: (1) *rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata*, (2) *provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi*, (3). *dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi*. Vendimet përfundimtare, jo-përfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tre ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar (neni 316³)

Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë (neni 443⁴, paragrafi pare). Afatet e caktuara në nenin e mësipërm (443) janë të prerë dhe fillojnë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar. Kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njërsës palë, ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit (neni 444⁵ i KPrC)

Kodi i Procedurës Penale, në ndryshim nga KPrC, nuk parasheh shpalljen e vendimeve penale në dy kohë. Neni 384⁶ përcakton se vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit. Shpallja vlen edhe si njoftim për palët që janë ose që duhet të konsiderohen të pranishme në seancë. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes. Nëpunësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit (*neni 386 "Depozitimi i vendimit"*).

Neni pararendës, 383, rendit të gjithë elementët që vendimi duhet të përmbarë: konkretisht: (a) *gjykaten që e ka dhënë*; (b) *gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejnë për ta identifikuar, si dhe gjeneralitetet e palëve të tjera private*; (c) *akuzën*; (ç) *parashtrimin e përbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta*; (d) *dispositivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit*; (dh) *datën dhe nënshkrimin e anëtarëve të trupit gjykues*.

Ky “unitet” i shpalljes së arsyetuar të vendimit penal në seance dhe depozitimi menjëherë në sekretari në formën e tij përfundimtare, me të gjithë elementët që parashikon KPrP, vihet në diskutim nga neni 113 i po të njëjtit Kod. Sipas këtij neni “*Origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre. Për aktet e ankueshme njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim*”. Përderisa Gjykata disponon vetëm me

³ *dhe gjykin e mosmarrëveshjeve administrative*”, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtares, Tetor 2013

⁴ Neni 316 “*Njoftimi i vendimeve*” (Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, neni 27)

⁴ Neni 443 “*Afati i ankimit*” (Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 72, 126)

⁵ Neni 444 “*Fillimi i afateve të ankimit*” (Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 73)

⁶ Neni 384 “*Shpallja e vendimit*”

vendim ose me urdhër (neni 112⁷) kjo nënkupton depozitimin edhe të vendimeve (akte të ankueshme) brenda 5 ditëve dhe njëkohësisht njoftimin e palëve për të nisur kështu procedurat e ankimit. Në fakt afati 5-ditor që cakton nenit 113 kontradikton afatet e paracaktuara nga nenet 384-386 dhe kjo mos-përputhje sugjeron ri-harmonizim (rregullim) në ligj.

Sipas nenit 415 të Kodit të Pr. Penale⁸, afati për të bërë ankım ndaj një vendimi që është marrë në shkallë të parë është dhjetë ditë. *Ky afat fillon nga dita e nesërme e shpalljes ose njoftimit të vendimit; (2) Ai që ka bërë ankım ka të drejtë që deri pesë ditë para seancës të paraqesë në sekretarinë e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen, arsyet e tjetra që lidhen me ankimin; (3) Afatet e parashikuara nga ky nen nuk mund të zgjaten për asnje shkak, përvëç rasteve të parashikuara me ligj.*

2. GJYKATATE APELIT

Republika e Shqipërisë ka 6 gjykata apeli. Ato zhvillojnë një aktivitet intensiv për shqyrtimit të ankimeve gjyqësore. Ankimit dhe gjykimi në Apel i çështjeve civile dhe penale rregullohet kryesisht nga Kodet respektive te Procedurës.

Për **çështjet civile** ankimi në shkallë të dytë trajtohet gjerësisht në Pjesën e Tretë të Kodit të Procedurës Civile⁹. Lidhur me vendimet në Apel, Kodi shqiptar nuk parashikon në mënyrë eksplikite afate për dorëzimin në sekretari të vendimit të arsyetuar. Edhe ndarja e momentit të shpalljes fillimisht të dispozitivit të vendimit nga momenti i arsyetimit të plotë të tij e të dorëzimit kësisoj në Sekretari nuk gjen përcaktim eksplicit në Kodin shqiptar të Pr. Civile. Kjo duket se i “shfajëson” gjyqtarët lidhur me vonesa, të qëllimshme ose jo, në arsyetimin e vendimit.

Neni 443 “**Afati i ankimit**”¹⁰, parashikon në paragafin 2 të tij se “Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë”. Pyetja që shtrohet në këtë rast se në cilin moment nis ky afat: në momentin kur gjykatësi shpall dispozitivin e vendimit apo në momentin kur vendimi i arsyetuar depozitohet në sekretarinë e gjykatës?!

Neni 444¹¹ përcakton se “Afatet e caktuara në nenin e mësipërm janë të prerë

⁷ Neni 112 “Format e disponimit të gjykatës” (Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

⁸ KODI I PROCEDURËS PENALE I RSH, Botim i QBZ, Tetor 2013, ISBN 978-9928-01-031-5

⁹ KODI I PROCEDURËS CIVILE I RSH, Miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 dhe ndryshuar me ligjet nr.8431, datë 14.12.1998; nr.8491, datë 27.5.1999; nr.8535, datë 18.10.1999; nr.8812, datë 17.5.2001; nr.9953, datë 14.7.2008, nr.10 052, datë 29.12.2008, nr. 122/2013 dhe ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” - Botim i QBZ, Tetor 2013

¹⁰ Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 72, 126

¹¹ Neni 444 “Fillimi i afateve të ankimit” - Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 73



*dhe fillojnë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar". Cili është pra vendimi përfundimtar i shpallur në këtë rast: **dispositivi apo vendimi i arsyetuar**?! Një hamendësim logjik mund të ishte pér të dytën, por, sa kohë që nuk ka një afat të caktuar në mënyrë eksplikite pér arsyetimin e vendimit dhe dorëzimin e tij në sekretari në "të tillë formë përfundimtare", neni 444 rrezikon të jetë praktikisht i pa-kuptimit.*

Në rrethana të tilla, siç sugjeron në fakt praktika, palët ndërgjyqëse zenë "mekanikisht" afat pér rekurs në Gjykatë të Lartë, pa u njohur më parë, domosdoshmërisht, me argumentat e renditura në arsyetimin e vendimit. Një sjellje/qasje e tillë kompromenton funksionimin e mekanizmit të kontrollit të vendimeve gjyqësore nga shkallët e gjykimit, duke e kthyer praktikisht Gjykatën e Lartë në një gjykatë e cila apriori administron rekurse, pavarësisht cilësisë së vendimarjes në apel. Në finale, e gjithë kjo "harresë" në Kod kompromenton procesin e rregullt gjyqësor dhe influencon të drejtën pér ankim të palëve. Rregullimi i këtyre çështjeve në Kodin e Procedurës Civile është një domosdoshmëri¹².

Pér **çështjet penale** vendimi në Apel merret menjëherë pas mbylljes së shqyrimit gjyqësor (*neni 379, KPrP*). Pas marrjes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues (*neni 382, KPrP*).

Vendimi përmban a) *gjykatën që e ka dhënë; b) gjeneralitetet e të pandehurit; c) akuzën; ç) parashtrimin e përbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet pér të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërtat; d) dispositivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit; dh) datën dhe nënshkrimin anëtarëve të trupit gjykues* (*neni 383*). Vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit. Shpallja vlen edhe si njoftim pér palët që janë ose që duhet të konsiderohen të pranishme në seancë (*neni 384*). Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes. Nëpunësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit (*neni 386*).

Rekursi duhet të paraqitet me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë. Ai duhet të përbajë tregimin e saktë të shkaqeve të paligjshmërisë së vendimit (*neni 435*).

Bazuar në këto përcaktime, pér vendimet te dhëna në Apel nuk parashikohet një ndarje në kohë, respektivisht pér shpalljen e dispositivit dhe arsyetimin e

¹² Në analizën e punës së Gjykatës së Apelit pér vitin 2013, kreu i kësaj gjykate, Alaudin Malaj propozoi gjithashu ndërmarrjen enjë nismë ligjore pér ndërrhyrje në Kodin e Procedurës Civile në seksionin e Gjykimit në Apel, duke vendosur afatë të përcaktuara qartë pér dorëzimin e vendimeve të arsyetuara nga gjyqtari i Apelit. Madje mosdorëzimi i vendimit të arsyetuar brenda këtij afati të konsiderohet shkelje në detyrë. Gjithashu në këtë ndryshim ligjor të parashikohet afati i ankimit të vendimit duke filluar ky afat nga momenti i dorëzimit të vendimit të arsyetuar dhe jo nga shpallja e tij, sic është aktualisht"

vendimit. Ato janë pjesë integrale të të njëjtët vendim që duhet të shpallet me të gjithë elementët e tij (neni 383) me anë të leximit në sencën që cakton edhe mbylljen e shqyrtimit gjyqësor. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes. Nëpunësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimt (*neni 386/1*). Lajmërimi për depozitimin dhe kopja e vendimit i njoftohen të pandehurit që është deklaruar në mungesë (*neni 386/2*).

Neni 112 i KPrP përcakton se vendimi duhet të arsyetohet, ndryshe ai është i pavlefshëm¹³. Origjinalet e akteve të gjykatës (ku përfshihen edhe vendimet) depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërrja e tyre (neni 113).

Edhe në rastin e Apelit, “uniteti” i shpalljes së arsyetuar të vendimit penal në seance dhe depozitimi i tij menjëherë në sekretari në formën e tij përfundimtare, me të gjithë elementët që parashikon Kodi i Pr. Penale, vihet në diskutim nga neni 113 i po të njëjtë Kod, sipas të cilës “*Origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërrja e tyre. Për aktet e ankueshme njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim*”.

3. GJYKATA E LARTE E REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Në Republikën e Shqipërisë, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj (neni 135 i Kushtetutës). Kushtetuta përcakton në mënyrë të posaçme se GJL duhet të botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës (neni 142/2).

Përcaktimet kushtetuese janë transpozuar me kujdes në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar. Në nenin 19 të këtij ligji parashikohet shprehimisht se: “*Vendimet e Gjykatës së Lartë shpallen të arsyetuara jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor. Vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, së bashku me mendimet e pakicës, bôtohen në Buletinin Periodik të Gjykatës së Lartë. Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore bôtohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare*”.

Ndryshe nga *ligji 8588/2000*, i ndryshuar, Kodet e procedurës penale dhe civile e trajtojnë zbehtë çështjen e afateve të arsyetimit të vendimeve të Gjykatës së Lartë.

13 SEKSIONI II “AKTET E GJYKATËS”, Neni 112 “Format e disponimit të gjykatës”(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.8813,datë 13.6.2002)

1. Gjykata disponon me vendim dhe me urdhër.
2. Vendimi jepet në emër të Republikës.
3. Vendimi dhe urdhri arsyetohen, ndryshe janë të pavlefshëm.....

KPrP përcakton në nenin 439¹⁴ se: (1) *Vendimi merret menjëherë pas mbarimit të seancës, me përjashtim të rasteve kur për shkak të natyrës së ndërlikuar ose të rëndësisë së çështjes kryetari i kolegjit e çmon të domosdoshme ta shtyjë marrjen e vendimit për aq ditë sa është e nevojshme.*

Neni 441¹⁵ përmban dispozita që detajojnë dispozitivin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Neni 445¹⁶ parashikon rastet e ndreqjes së gabimeve në arsyetimin e vendimit. “*Gabimet ligjore në arsyetimin e vendimit ose tregimi i gabuar i tekstit të ligjit nuk sjellin prishjen e vendimit të ankumuar, në qoftë se nuk kanë patur ndikim vendimtar mbi dispozitivin. Por, gjykata specifikon në vendim gabimet dhe ndreqjet e duhura*”.

Të njëjtat përcakttime, këtë herë mbi marrjen e vendimeve civile nga Gjykata e Lartë bën edhe **KPrC**¹⁷. “*Gjykata pas diskutimit të çështjes tërhoqet në dhomën e këshillimit dhe merr vendimin përkatës. Në raste të veçanta, për shkak të natyrës së ndërlikuar apo rëndësisë së çështjes, marrja e vendimit mund të shtyhet për aq ditë sa është e nevojshme*”.

Tek Parimet e Përgjithshme (Pjesa e Parë), KPrC përcakton në nenin 126/2 se “*Vendimi përfundimtar, si dhe vendimet që i jasin fund procesit gjyqësor civil të parashikuara prej nenit 127 të këtij Kodi jepen në “Emër të Republikës” dhe përkatësisht duhet të përbajnjë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyra e zgjidhjes së saj.*”

Tek Pjesa e Parë e KPrC, parashikohet për rastet e kundërshtimit të juridiksionit dhe kompetencës¹⁸. Neni 63¹⁹ përcakton se *Gjykata e Lartë shqyrton ankimin në dhomë këshillimi, në kolegji, me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë dhe shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se tridhjetë ditë nga momenti i depozitimit të ankesës.*

14 Neni 439 “Marrja e vendimit”

15 Neni 441 “Dispozitivi i vendimit”(Shtuar shkronja “d” me ligj nr.8813, dt 13.6.2002), Seksioni III, Kreu III,

1. Pas shqyrtimit të çështjes Kolegji Penal ose kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin:

a) lënien në fuqi të vendimit ndaj të cilit është bërë rekurs;

b) ndryshimin e vendimit për cilësimin ligjor të veprës, për llojin dhe masën e dënimit, për pasojet civile të veprës penale;

c) prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim;

c) prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim;

d) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

16 Neni 445: Ndreqja e gabimeve

17 Neni 484 “Marrja e vendimit”, (Ndryshuar paragrafi II me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 93)

18 KREU III “Kompetencat” / D. Kundërshtimi i juridiksionit dhe i kompetencës, nenet 59-64

19 Neni 63 “Ankimi pezullon gjykimin”(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 122/2013, neni 2):

Me depozitim e ankesës, sipas nenit 62 të këtij Kodi, pezullohet gjykimi i çështjes dhe gjykata mund të kryejë vetëm veprime procedurale që nuk presin.

Gjykata e Lartë shqyrton ankimin në dhomë këshillimi, në kolegji, me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë dhe shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se tridhjetë ditë nga momenti i depozitimit të ankesës.



4. GJKATAT ADMINISTRATIVE

Për herë të parë, objekt vlerësimi në këtë studim bëhen dhe afatet ligjore të dorëzimit të vendimeve të gjykatave administrative. Ky vlerësim realizohet për herë të parë në absolut dhe synon të vendosë një gur themeli si në metodën e përdorur ashtu edhe në rezultatet e gjeneruara.

Sistemi i gjykatave administrative, njësoj si ai i gjykatave të zakonshme, organizohet në tre shkallë; gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjkata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjkatës së Lartë. Aktualisht në Shqipëri funksionojnë 6 gjykata administrative të shkallës së parë në: Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë dhe një Gjkatë Administrative e Apelit Tiranë.

Në ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjkatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, parashikohet qartësisht afatet e shpalljes së vendimit dhe afatet e dorëzimit të dosjes në sekretarinë gjyqësore.

Konkretnisht, në nenin 42 të ligjit nr.49/2012 parashikohet se gjykatat administrative të shkallës së parë shpallin detyrimisht të arsyetuar vendimin gjyqësor. Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore. Në rastet përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, e shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë.

Edhe për Gjkatën Administrative të Apelit aplikohen të njëjtat afate si në shkallën e parë. Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore (neni 55). Edhe këtu, në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, ajo e shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit gjyqësor deri në 5 ditë.

Kolegji Administrativ i Gjkatës së Lartë, i cili shqyrton rekursin e ankimit të paraqitur ndaj vendimeve të shpallura nga Gjkata Administrative e Apelit dhe Gjkata Administrative e Shkallës së Pare, në rastet përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, e shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 10 ditë. Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.

Për sa më lart, rezulton se ligji nr. 49/2012 i ka të përcaktuara qartësisht afatet e shpalljes së vendimit të gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative në të treja shkallët e gjykimit.

5. GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SE SHQIPERISE (jo objekt monitorimi)

Gjykata Kushtetuese nuk bën pjesë në sistemin gjyqësor të zakonshëm; ajo ka një juridikSION të veçantë për kontrollin e kushtetueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjerë normativë. Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.

Sa i takon vendimeve të GJK, ligji i saj organik përcakton se ato shpallen të arsyetuara dhe lexohen nga kryesuesi i seancës ose nga një gjyqtar i caktuar prej tij (*neni 72, para.6*). Vendimi nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm në shqyrtimin e çështjes. Për shpalljen e vendimit njoftohen pjesëmarrësit në proces. Mungesa e tyre nuk pengon shpalljen e tij (*neni 72/ para 4*).

Vendimet e GJK janë përfundimtare dhe hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e tij (*neni 26/1, ligji 8577*). Në fakt, neni 132 i Kushtetutës përcakton se *Vendimet e GJK hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare*. Pra hyrja në fuqi e një vendimi që me shpalljen e tij e tejkalon normën kushtetuese në këtë rast.

Për aq sa kjo mund të legjitimohet, duhet pohuar se mbrojtja e të drejtave kushtetuese të individit është në shumicën e rasteve *time-sensitive*, nganjëherë në masë të tillë sa çdo vonesë që lidhet me praktikën e përgatitjes dhe nxjerrjes për botim të një numri standard të fletorez zyrtare mund të thellonte objektivisht shkeljen e këtyre të drejtave. Pavarësisht qëllimit pozitiv të ligjit, harmonizimin e tij me normën kushtetuese për mënyrën e hyrjes në fuqi të vendimeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të individit është një domosdoshmëri.

Në thelb, “kapërcimi” i nenit 132 të *Kushtetutës nga dispozitat e nenit 26, të ligjit 8577/2000, implikon më së pari përcaktimin në ligj edhe të një afati “sa më të ngushtë të jetë e mundur” brenda të cilit GJK a) shqyrton çështjen; b) shpall vendimin kur bëhet fjalë për “për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit”.*

Aq më tepër, ështja e vendosjes së afateve kontrollin kushtetutues së akteve normative me fuqinë e ligjit të Këshillit të Ministrave dhe caktimi i një afat konkret, sa më të shkurtër, për hyrjes në fuqi të vendimit të GJK që shfuqizon një akt të tillë është një domosdoshmëri akute (*shih trajtim rasti nga G. Shella, fq.89, Vonesat në Arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve, 2013*).

6. GJYKATA EUROPIANE E TE DREJTAVE TE NJERIUT (jo objekt monitorimi)

Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të (neni 5 i Kushtetutës). Shqipëria është vend anëtar i Këshillit të Europës. Shteti shqiptar ka nënshkruar Konventën Europianetë të Drejtave të Njeriut në 13/07/1995 dhe e ka ratifikuar atë në 2/10/1996, duke e bërë pjesëtë sistemit të brendshëm ligor (neni 17/2 e Kushtetutës).

Sipas përcaktimit të nenit 1 të KEDNJ, Shtetet Palë të saj (pra edhe Shqipëria), marrin përsipër detyrimin që të respektojnë, ndaj cilidh që ndodhet nën juridikcionin tyre, të drejtat dhe liritë themelore të sanksionuara në Konventë dhe në protokollet shtesë të saj²⁰.

E drejta për një proces të rregullt ligor përbën një nga të drejtat e parashikuara si në Kushtetutën tonë dhe në Konventën Evropiane dhe lidhet me garancitë që u ofrohen palëve gjatë një gjykimi, në drejtim të respektimit të atyre parimeve esenciale që përbëjnë thelbin e procesit.

Parografi i parë i nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përcakton se: “*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet detyrimisht dhe publikisht, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhee paanëshme e krijuar ligjërisht, e cila vendllo qoftë për konfliktet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë përbazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij*”. Këto parime të rëndësishme nënvizojnë faktin se çdo qytetar që i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj, prandaj janë të lidhura me domosdoshmërinë e respektimit të një afati të arsyeshëm²¹.

Sipas jurispridencës së KEDNJ, për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e një gjyqi është apo jo e arsyeshme, duhet të merret parasysh e gjithë periudha nga momenti i depozitimit të kërkesë-padisë derisa vendimi merr formë të prerë. Kështu, një zgjatje e tepruar nga seanca e fundit deri në nxjerrjen e një vendimi të arsyetuar mund të cënojë të drejtën e gjykimit pa vonesa të panevojshme. Një vonesë e tepruar në shpalljen e vendimeve të arsyetuara mundet gjithashtu të pengojë mundësinë e një pale (qoftë kjo paditësi apo i padituri) për të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën kushtetuese të ankimit (neni 43 i Kushtetutës).

²⁰ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Komiteti i Ministrave të KiE kontrollojnë përbushjen nga Shtetet Palë, të detyrimeve të marra përsipër me ratifikimin e Konventës. Një nga këto detyrime është edhe ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ dhe zbatimi i jurisprudences të saj, proces i cili mbikyret nga Komiteti i Ministrave.

²¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 6/2006:



Pa një vendim plotësisht të arsyetuar, palët do të kenë mundësi të kufizuara për t'u njojur me vlerësimin e gjykatës nga pikëpamja e faktit dhe ligjit dhe për të ngritur argument me shkrim kundër tyre. E drejta e ankimit nuk përbën në vetvete një nga të drejtat e njeriut brenda kuadrit të gjykimeve civile por, kur legjislacioni vendas e parashikon të drejtën e ankimit, si GjEDNj-ja ashtu edhe KDNj-ja kanë përcaktuar se procedurat ankimore duhet të përmbushin standartet e një gjykimi të drejtë.

Në çështjen **Hadjianastassiou kundër Greqisë**, GjEDNj-ja doli në përfundimin se mosdhënia e një vendimi të arsyetuar për të akuzuarin në kohën e duhur në mënyrëqë ai të kishte mundësi të shtronte argumentet e tij për t'u ankuar në Gjykatën e Kasacionit nuk i la atij kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur ankimin e tij²². Gjykata doli në përfundimin se kjo cënoi të drejtën e z.Hadjianastassiou për një gjykim të drejtë.

Po kështu, KDNj-ja vlerëson se mosdhënia nga ana e gjykatës e vendimit të arsyetuar me shkrim brenda një kohe të arsyeshme solli si pasojë mos lejimin e të paditurit për të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën e tij sipas legjislacionit vendas për rishikimin e vendimit nga një gjykatë më e lartë²³.

Përveç mosdhënies së vendimit të arsyetuar, ekzistanca e afateve jashtëzakonisht të shkurtra për paraqitjen e ankimit mund të përbëjë pengesa për realizimin e së drejtës së ankimit²⁴. Ndonëse çështjet e diskutuara më sipër lidhen me gjykimin e çështjeve penale, të njëjtat parime zbatohen, për analogji, edhe për gjykimin e çështjeve civile, duke qenë se e drejta për ankim garantohet nga e drejta vendase (*shih më sipër*).

Në këtë kontekst specifik, Rekomandimi Nr.R(84) 5 i Komitetit të Këshillit të Evropës mbi Parimet e Procedurës Civile ka theksuar se duhet dhënë një vendim konciz “në fund të procesit ose sa më shpejt që të jetë e mundur pas tij²⁵”.

22 Hadjianastassiou kundër Greqisë, GjEDNj, 16 dijutor 1992. në këtë rast, Gjykata Ushtarake greke e Apelit e kishte dhënë gjykimin e saj me gojë në prani të të akuzuarit, por vetëm në mënyrë të përbledhur dhe pa u shprehur për një sere çështjesh që ishin marrë parasysh në marrjen e atij vendimi. Deri në kohën që i akuzuar mori vendimin e plotë të zbardhur të gjykatës, atij nuk iu dha mundësi që të parashtronë shkaqet e tij për t'u ankuar kundër atij vendimi në Gjykatën e Kasacionit.

23 Shih Raportin e Komitetit për të Drejtat e Njeriut në çështjen Currie kundër Xhamaiçës, 29 mars 1994 (Komunikimi Nr. 377/1989). Çështja lidhet me ankesën ndaj një vendimi të gjykatëssapelit. Ankime të tillë të nivelit të dytë nuk garantonohen nga PNDPC-ja, por kjo e drejtë parashikohej nga legjislacioni vendas. Shih gjithashtu çështjen Víctor Fran ciskundër Xhamaiçës, Komiteti për të Drejtat e Njeriut, 24 mars 1993 (Komunikimi Nr. 320/1988); Little kundër Xhamaiçës, Komiteti për të Drejtat e Njeriut, 1 nëntor 1991 (Komunikimi Nr. 283/1988).

24 Report On the Situation of Human Rights in Panama [Raport për Situatën e të Drejtave të Njeriut në Panama,] OEA/Ser. L/VII.44, doc. 38, rev.1, 1978. Shih edhe Hadjianastassiou kundër Greqisë, GjEDNj, 16 dijutor 1992.

25 Rekomandimi Nr. R (84) 5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Shtetet Anëtare lidhur me Parime te Procedurës Civile projektuar përmirësimin e Funksionimit të Drejtësisë, Parimi 6.

Në referim të vendimeve të GJEDNJ²⁶, por edhe praktikës së saj në përgjithësi “case law”, gjykatat vendase kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “*të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*”. Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, garanton mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në procesin gjyqësor ndaj “*vonesave të tepruara procedurale*”, që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës.

Një drejtësi jo efikase dhe e vonuar çon në dëmtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e shtetit. Drejtësia e vonuar është e njëjtë me drejtësinë e mohuar (Magna Carta). Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar.

Siq edhe është parashtuar më sipër në këtë vendim, në çështjet gjyqësore periudha e arsyeshme që merret në konsideratë për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi i arsyuar merr forme të prerë.

²⁶ PGV kundër Italisë, vendimi i GJEDNJ, datë 7.11.2000; Çështja X kundër Francës, 1998; Vocaturo kundër Italisë; Cappello kundër Italisë; Darvan kundër Turqisë, 2009; Zimmermann dhe Steinner kundër Zvicrës, datë 13.06.1983; Vendimi K.Klitshe de la Grande kundër Italisë, 27.10.1994; Poiss kundër Austrisë, datë 23.04.1097. Vendimi “Hadjianastassiou kundër Greqisë, 16.12.1992”



KAPITULLI II

GJYKATAT E ZAKONSHME
DHE
GJYKATA E LARTË



GJETJET E MONITORIMIT, 2014

GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata e Lartë e RSH është shkalla më e lartë e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Selia e saj është në Tiranë. Misioni kryesor i GJL është rishikimi, me kërkesën e palëve, i vendimeve të gjykatave të shkallëve më të ulta. Ajo merr në shqyrtim çështjet e zbatimit të ligjit pa gjykuar faktet duke garantuar me anë të jurisprudencës së saj zbatimin uniform të ligjeve. Për këtë arsy, ligji nr.8588 dt.15/03/2000 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë" i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe shpalljes dhe botimit të vendimeve të kësaj gjykatë. Neni 19 i ligjit në fjalë^a, përcakton shprehimisht se:

(1) Vendimet e Gjykatës së Lartë shallen të arsyetuarajo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor. (2) Vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, së bashku me mendimet e pakicës, botohen në Buletinini Periodik të Gjykatës së Lartë. (3) Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ (neni 10/1). Çështjet me karakter tregtar, civil dhe familjar gjykohen nga Kolegji Civil; çështjet penale gjykohen nga Kolegji Penal; çështjet me karakter administrativ dhe të punës gjykohen nga Kolegji Administrativ (neni 12).

Gjykata e Lartë gjykon në Kolegjet e Bashkuara: a) rastet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; c) kërkesat për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore; ç) raste të tjera, të parashikuara me ligj (neni 14).

INFOÇIP është i vetmi operator i specializuar i shoqërisë civile në Shqipëri që ka monitoruar modalitetet e vendimarrjes në këtë gjykatë. Që në vitin 2009, INFOÇIP, në kuadër të programit 5 vjeçar të monitorimit të botimeve zyrtare në RSH, ndërmori vlerësimet e para ndaj vonesave të zbardhjes dhe më pas botimit në Fletore Zyrtare të vendimeve unifikuese të GJL.

^a file:///C:/Documents%20and%20Settings/user/My%20Documents/Downloads/ligji_gjykates_se_larte%20(2).pdf

Në vitin 2011, INFOÇIP bëri publike përmes Raportit “Transparenca e Botimeve Zyrtare në RSH”, të dhëna të sintetizuara për botueshmërinë e vendimeve unifikuese të GJL për periudhën 2006-2011. Përveç vonesave relativisht të gjata, vlerësimi sistematik konstatatoi edhe “harresa” të plota nga GJL për t’i dërguar për botim në Fletore Zyrtare vendimet e saj unifikuese, një detyrim ky i shprehur qartësisht në ligjin e saj organik.

Në kuadër të programit të ri të monitorimit, nisur dy vjet më parë me mbështetjen ekskluzive të Fondacionit SOROS, INFOÇIP ndërmori vlerësimin sistematik të vonesave në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara². Objekt ishte dorëzimi i tyre në Sekretari konform përcaktive ligjore. Situata që u konstatua ishte sërisht shumë shqetësuese³. Po ashtu, INFOÇIP vlerësoi sërisht situatën e botimit në Fletore Zyrtare të vendimeve unifikuese, ku gjithashtu u konstatuan probleme.

Në këtë edicion të dytë, INFOÇIP ka vlerësuar sërisht situatën për vitin 2014 sa i takon afateve të arsyetimit dhe dorëzimit të vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara të GJL në sekretarinë e gjykatës. Objekt i posaçëm vlerësimi janë vendimet unifikuese të dhëna gjatë 2014-ës, të cilat monitorohen si në terma të afateve të dorëzimit në sekretarinë e kësaj gjykate, ashtu edhe në terma të botimit në Fletore Zyrtare. Edhe krahasimi i treguesve vjetorë eshtë gjithashtu pjesë e studimit të këtij viti.

PËRMBAJTJA			Faqë
Nr.i vendimit	Data	Çështje Civile	PALËT
1	19.02.2014	Romina Shkrelci <i>kundër</i> Nargis Lungu (Shkrelci).....	3
4	13.10.2014	Ankues: Albano Çepele Subjekti i Interesuar: Këshilli i Larte i Drejtësisë.....	18
5	27.10.2014	Suzana Frashëri <i>kundër</i> Ministria e Drejtësisë..... Tiranë në mungesë, Këshilli i Larte i Drejtësisë.....	31
Çështje Administrative			
2	10.03.2014	Hyrjet Havaraj <i>kundër</i> Isa Gjonzeneli, Zelika Xhani, Shadiqe Malaj, Bardha Gjonzeneli, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlore, Sos. Havarji; Dallëndyshe Çekrezi; Afrim Havarji; Ndriçim Havarji; Seksioni i Administrimit dhe i Mbrotjes se Tokes Vlore.....	42
3	28.04.2014	Marjana Pemuka <i>kundër</i> Gjok Shota, Komisioni Vendori Vlerësimit të Titujve të Pronësise pranë Prefektit të Qarkut Durës, Xhentil Kupe, Komuna Bubq, Zyrë Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme Krujë.....	51
Çështje Penale			
1	10.03.2014	Kërkues: Prokuroria e Rethit Gjyqësor Shkodër I pandehur: Ervis Nukaj.....	67
2	03.11.2014	I pandehur:	

Faksimile
e buletinit
të GJL për
vendimet e
Kolegjeve të
Bashkuara,
viti 2014

² Në këtë grup përfshihen edhe vendimet unifikuese të GJL.

³ “Vonesat ne Arsyetimin dhe Dorezimin e Vendimeve Gjyqësore”, edicioni i pare, 2013, Shtepia Botuese AlbPaper.



1. Rezultatate e monitorimit, 2014

Vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Gjatë vitit 2014, Kolegjet e Bashkuara të GJL dhanë gjithsej 7 vendime⁴: 3 civile, 2 administrative dhe 2 penale. Prej këtyre 7 vendimeve, 4 janë unifikuese. Nga monitorimi rezultoi se të gjitha këto vendime janë arsyetuar/dorëzuar në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh, me përjashtim të vendimit civil të KB nr 4, siç sugjeron tabela *më poshtë*.

Nr	Lloji	Palet ndergjyqëse	Dt. vendimit / mbyllja shqyrtimit	Vendimi / dosja dorezuar	Firmosur nga (shumica + pakica)	Dite -vonesa nga mbyllja e shqyrtimit gjyqësor	Dite-vonesa te afatit te shpalljes (-30 d)	Vonesat per kompletim me mendim pakice (deri 05.5.2015 minus 30 dite)
1	Civil	Romina Shkreli kundër Nargis Lungu (Shkreli)	19/02/2014	18.06.2014	shumica + pakica	120	90	
2	Admin. unifikues	Hyrjet Havaraj kundër Isa Gjonzeneli, Zelika Khani, Shadje Malaj, Bardhe Gjonzeneli, Agjencja e Kthimit dhe Kompenxit të Pronave	10/03/2014	16.04.2014	shumica + pakica	37	7	
3	Admin. unifikues	Marjana Përmuca kundër Gjok Shota, Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titivje të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Durës, Xhentil Kupe...	28/04/2014	17.06.2014	Pakica ende jo (në nga dy pakicat)	51	21	342 dhe vijon mritet
4	Civil	Ankues: Albano Çepele Subjekt i Interesuar: KLD	13/10/2014	26.10.2015	shumica + pakica	13	0	
5	Civil	Suzana Frashëri kundër Ministria e Drejtësisë	27/10/2014	03.02.2015	shumica + pakica	98	68	
1	Penal unifikues	Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, I Pandehur Nurkaj	10/03/2014	17.06.2014	shumica + pakica	97	67	
2	Penal unifikues	I pandehur Erjon Borakaj...	03/11/2014	29.01.2015	Pakica ende jo	85	55	155 dhe vijon mritet
TOTAL						501 dite	308 dite	497 dite

Krahasuar me vitin 2013, kemi një përmirësim të treguesve sa i takon dorëzimit të vendimit brenda afatit 30-ditor që cakton ligji për GJL, të paktën sa i takon arsyetimit/ dorëzimit të vendimit nga shumica. Mesatarja e vonesave për arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve të KB (nga shumica) tej afati ligjor rezulton të jetë 44 ditë, krahasuar me 104 ditë gjatë vitit 2013.

Këto të dhëna indikojnë për një përmirësim me 2.3 herë gjatë vitit 2014, krahasuar me vitin 2013

⁴ Burimi: Faqja Zyrtare e GJL; http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Viti_2014_1976_1.php

Për fat të keq, edhe për vitin 2014, problemi kryesor i konstatuar është kompletimi i vendimeve të KB me arsyetimet e pakicës⁵. Kjo neglizhencë e pafalshme ka prekur sidomos vendimet unifikuese, që janë edhe vendimet më të rëndësishme që nxjerr Gjykata e Lartë e RSH.

Deri në datë 5 maj 2015 që u mbyllën vlerësimet për GJL, *vendimi unifikues administrativ nr.2* dhe *vendimi unifikues penal nr.2* ishin akoma të pakompletuar me arsyetimet e pakicës. Edhe për vendimet e tjera të KB, pakica ka depozituar arsyetimet e saj përgithësisht pasi vendimi është marët dhe arsyetuar nga shumica.

Ky është një fenomen i dëmshëm, madje një sëmundje kronike e gjykatës më të rëndësishme në vend, që për fat të keq jo vetëm nuk po gjen zgjidhje, por tenton të keqësohet. Siç do ta konstatojmë edhe më poshtë, ky rezulton të jetë shkaku kryesor që vendimet unifikuese nuk botohen në Fletore Zyrtare, edhe shumë kohë pasi shumica e ka marrë vendimin (*shih më poshtë*).

Nëse si afat fundor mbi cilin do të duhej të përllogariteshin vonesat, do të zgjidhej pikërisht momenti kur vendimi merr formën e tij përfundimtare, pra kur kompletohet edhe me mendimin e pakicës, atëherë të dhënat do të merrnin vlera të tjera. Nga një përllogaritje e përafërt, vonesa mesatare në këtë rast do të ishte 120 deri 150 ditë nga data e zhvillimit të seancës së fundit nga Kolegjet e Bashkuara për çështjet gjyqësore të marra në analizë.

Vetëm për dy vendimet unifikuese që u përmendën më sipër, pakica me mosveprimet e saj ka shkaktuar një vonesë prej rrëth 500 ditësh (deri në dt.5 Maj ku u mbullën verifikimet për këtë monitorim). Vendimi unifikues nr. 3 ka kapur pothuajse vitin (342 ditë e në rritje) pa u kompletuar me mendimin e pakicës, duke shënuar një vonesë jashtë çdo limiti të arsyeshëm edhe sipas standardeve të konsoliduara tashmë nga vetë Gjykatës së Lartë përmes jurisprudencës së saj në gjykimin e rastit N. Tabaku (vendim nr 5, dt 12/12.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).

Në total, deri në datë 5 Maj 2015, përllogariten rrëth 805 ditë vonesa për dorëzimin e 7 vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjatë vitit 2014-ës, në formatin përfundimtar (arsyetimi i shumicës + pakicës+firmosje e vendimit).

⁵ Kjo anomali kritike nuk e ka penguar gjithsesi Sekretarinë e GJL që t'i shpërndajë palëve të interesuara kopje të vendimeve të pakompletuar me arsyetimin e pakicës, edhe pse vendimi formalisht dhe ligjërisht konsiderohet "i plototësuar".

2. Rezultatate e monitorimit 2014

Botimi në Fletore Zyrtare i vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë

Siq u tha më sipër, nga 7 vendime gjithsej të marra nga Kolegjet e Bashkuara gjatë 2014-ës, katër (4) prej tyre janë unifikuese. Për këto lloj vendimesh, neni i 19 i ligjit 8588/2000 përmban një detyrim të dyfishtë: *përveçse duhen shpallur të arsyetuar brenda 30 ditëve, ato duhen botuar në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.*

Arsyeja pse ligjvënësi ka përcaktuar që këto lloj vendimesh duhet të botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare, ka të bëjë me faktin se ato duhet të njihen sa më shpejt që të jetë e mundur nga trupa gjyqësore e gjykatave më të ulëta, me qëllim që praktika, tashmë e unifikuar përmes interpretimit ligor të Gjykatës së Lartë, të reflektohet në kohën më të parë të mundshme në çështje të ngjashme, që mund të jenë nën shqyrtim ose gati për vendimarrje. Përmes vendimeve unifikuese sigurohet uniformiteti në interpretimin e akteve në procesin gjyqësor prej të gjithë trupës së gjyqtarëve në RSH.

Mos-botimi i VUGJL në Fletore Zyrtare do të ishte së pari një shkelje nga vetë GJL e dispozitave të ligjit të saj organik (*fjalia 1 dhe 3, neni 19*).

Së dyti, kjo do të sillte potencialisht si pasojë mos-përbushjen e qëllimit të synuar nga ligjvënësi, por edhe misionit kushtetues dhe ligor të vetë GJL, sa i takon unifikimit të praktikës së shqyrtimit gjyqësor në RSH.

Së treti, kjo do të përbente edhe një shkelje direkte të vetë urdhëresave të vendimit unifikues, pasi si rregull, çdo vendim i tillë e përfshin detyrimin për botim në Fletore Zyrtare si pjesë të dispozitivit (*fjali më vete*).

Së katërti, këto vonesa që vijnë si rezultat i mosveprimit të trupës gjyqësore në ushtrimin e detyrës së saj, mund të sillnin pasoja që rëndëojnë direkt mbi liritë dhe të drejtat e palëve ndërgjyqëse, sidomos në rastin e vendimeve penale unifikuese. Dhe raste të tillë ka patur (*shih rasti P.Deliu, fq.35*)

Bazuar në parashtrimet e mësipërme, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, në kuadër të këtij monitorimi do të vlerësohen dyfish; si në terma të afateve të zbardhjes së tyre (30 ditë) ashtu edhe në terma të botimit të tyre në fletoren zyrtare. Meqenëse vendimet unifikuese mund të merren në çdo kohë të vitit kalendarik (në rastin konkret 2014), INFOÇIP ka mbyllur vlerësimin sa i takon botimit të tyre në Fletore Zyrtare në 5 Maj të vitit 2015. Sa kohë që një vendim unifikues mund të merret edhe në nëntor apo dhjetor, atëherë është llogjike që botimi i tij të bëhet në serinë e vitit pasardhës të Fletores Zyrtare (në rastin konkret, serinë e vitit 2015). Koha limit “e pristes” metodologjike për këtë lloj vlerësimi është si rregull 90 ditë nga mbyllja e vitit kalendarik. Për rigorozitet metodologjik, INFOÇIP e ka shtyrë këtë limit sivjet deri në 5 maj 2015, pra mbi 150 ditë nga mbyllja e vitit 2014, që është objekt monitorimi.



Nga vlerësimi i ndërmarrë, rezultoi se vetëm 2 nga 4 vendime unifikuese të dhëna nga GJL gjatë vitit 2014, janë të botuara në Fletore Zyrtare. Konkretisht, vendimi Unifikues Penal Nr.1, Datë 10.03.2014 gjendet i botuar në Fletore Zyrtare 220, fq. 12935, (FZ e datës 6 Mars 2015⁶). Kurse vendimi Unifikues Administrativ Nr 2, Datë 10.03.2014 është botuar në Fletore Zyrtare 150, fq. 7203 (FZ mban datën 2 tetor 2014).

Seria e botimit të fletorez zyrtare 2014 nuk përbën të botuar asnjë vendim tjetër unifikues të GJL. Deri në datë 5 maj 2015⁷, momenti i cili përkon me interesimin e fundit të bërë nga INFOÇIP pranë GJL për informacion të përditësuar lidhur me vendimet e KB, asnjë nga 2 VUGJL e tjera nuk ishte i botuar as në ndonjë fletore zyrtare të 2015-s.

Sic e pasqyron edhe tabela në fq.31, të dy vendimet unifikuese në fjalë janë të pa-kompletuar me mendimin e pakicës. Një vendim unifikues nuk mund të botohet në Fletore Zyrtare përvëçse në formën e tij të plotë, pra i arsyetuar dhe i kompletuar me mendimin e shumicës dhe të pakicës. Sipas të gjitha gjasave, shkak i mosbotimit në fletore zyrtare është mungesa e arsyetimit të pakicës në këto dy vendime unifikuese.

Në të katër vendimet unifikuese të referuara me detaje në tabelën më poshtë, në dispozitivin e tyre përcaktohet shprehimi i vendimi i botohet në Fletore Zyrtare.

Viti	Total	Atributet e Vendimit Unifikues te Gjl	Lloji	Fletorja zyrtare (fz) ku është botuar vugj	Vonesa Absolute	Vonesa e perllogaritur Per Botim Ne Fz (Deri 10/5/2015)
2014	1	Vendim unifikues nr.1, date 10.03.2014	Penal	Nr. 220, dt. 06.03.2015	360 dite	315 dite
	2	Vendim unifikues nr.2, date 10.03.2014	Admin.	Nr. 150, dt. 02.10.2014	170 dite	125 dite
	3	Vendim unifikues nr.3, date 28.04.2014	Admin.	ende nuk ka shkuar per botim (deri 10/3/2015)	mbi 312 dite dhe rritet....	327 e ne rritje
	4	Vendim unifikues nr.2, date 03.11.2014	Penal	ende nuk ka shkuar per botim (deri 10/3/2015)	mbi 130 dite dhe rritet....	140 e ne rritje

Mosbotimi ende në fletore zyrtare i këtyre dy vendimeve unifikuese të 2014-ës, në rradhë të parë ngarkon me përgjegjësi ata qyqtarë të GJL që kanë patur mendim ndryshe nga shumica për vendimet në fjalë (gjyqtarët e mendimit të pakicës). Neglizhenca e tyre në këtë rast është e egzagjeruar. Me mosveprimin e tyre, ata janë bërë shkak që ligji organik i GJL-të shkelet, trupa gjyqësore të mos infromohet mbi njehsimin e praktikës gjyqësore dhe potencialisht për dëme eventuale që mund t'u jenë shkaktuar palëve ndërgjyqëse (*shih rasti "P.Deliu"*)

⁶ Pavarësisht datës së saj, kjo fletore është e renditur në serinë e botimit për vitin 2014. Kjo është sigurisht një inkonsistencë e vetë QBZ.

⁷ Ky është momenti kur INFOÇIP mori kontaktin e fundit me sekretarinë e GJL për të marrë informacion për vendimet unifikuese dhe mosbotimin e tyre, pas konsumimit "të pritjes" që pason mylljen e vitit 2014.



Duke qenë se një vendim unifikues i GJL nuk i intereson thjesht palëve, por gjithë trupës gjyqësore në RSH, caktimi i momentit preciz se kur kjo trupë gjyqësore duhet të referojë këtë vendim, është me rëndësi të dorës së parë. Në përgjithësi për aktet e botueshme, këtë moment e cakton botimi në Fletore Zyrtare. Kjo është gjithashtu praktika që ndiqet për vendimet përfundimtare të Gjykatës Kushtetuese, të cilat hyjnë në fuqi pas botimit në FZ. Në gjykimin e autorëve të këtij studimi, i njëjtë irregull duhet të vlejë edhe për vendimet unifikuese të GJL. E thënë ndryshe, trupa gjyqësore nuk ka detyrim t'u referohet atyre nëse nuk realizohet botimi në Fletore Zyrtare. Sidoqoftë debati i caktimit të momentit nga i cili një vendim unifikues duhet të fillojë të prodhojë efektet e veta për njehsimin e paraktikës së shqyrimit gjyqësor, mund të thuhet qysh tanë se duke mos i botuar ato në kohë, GJL nuk përmbrush misionin e unifikimit të kësaj praktike.

Edhe në faqen zyrtare të GJL, në kategorinë “*Vendime Unifikuese*” gjenden të hedhura vetëm 3 vendime të tillë⁸ për vitin 2014 dhe jo 4, një tjetër inkonsistencë kjo, tashmë e vetë sistemit që GJL përdor për publikimin e vendimeve të saj.

The screenshot shows the homepage of the Gjykata e Lartë website. At the top, there is a navigation bar with links for 'Kontakto', 'Indeks', 'English', 'Kirko', and a search icon. Below the header, there is a banner with the text 'GJYKATA E LARTË' and 'E REPUBLIKËS SË SHQIPÉRISË'. Underneath the banner, there is a menu bar with links for 'Gjykata e Larte', 'Lista e Gjykimeve', 'Vendimet e Gjykates', 'Publikime', 'Njoftime', 'Ndihme për Publikun', 'Media Galeri', and 'Lidhje Ndihmëse'. The main content area has two columns. The left column is titled 'Kërkim për Vendime' and contains a list of judgments: 'Vendime të Çështjeve Gjykim Juridikcion Fillestar', 'Vendime Unifikuese', and 'Vendime 1999 - 2014'. The right column is titled 'Vendime Unifikuese' and lists four judgments: 'Vendim Unifikues Penal Nr.1, Datë 10.03.2014', 'Vendim Unifikues Administrativ Nr 03, Datë 28.04.2014', 'Vendim Unifikues Administrativ Nr 2, Datë 10.03.2014', and 'Vendim Unifikues Civil Nr.4, Datë 10.12.2013'.

Rasti P. Deliu

Rasti më flagrant i konstatuar nga INFOÇIP është ai i ish-të dënuarin P. D. i cili qëndroi padrejtësisht në burg 5 muaj më shumë për shkak të mos-zbardhjes të një Vendimi Unifikues⁹. Po në 2009-ën, e njëjta situatë absurde rëndoi edhe për të dënuarin Xh. Hoxha. Për të dy rastet, u hartua rekomandim nga Avokati i Popullit.

Në të dyja rastet kemi të bëjmë me mbajtje padrejtësisht në burg të personit, për shkak të mos-veprimit të gjyqtarëve të GJL. Edhe në këto raste të identifikuara nga INFOÇIP që në vitin 2009, ka qenë pikërisht mos-arsyetimi i mendimit të pakicës shkaku që vendimi të moszbardhej plotësisht, duke mos mundësuar as prokurorin e çështjes të merrte masat e nevojshme procedurale për të lirimin e personave që për shkak të urdhëresave të vendimit unifikues duhet të mos mbaheshin më në burg.

⁸ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Vendime_Unifikuese_39_1.php

⁹ Vendimit nr. 2, i dhënë në 06.02.2009, u botuar në F. Zyrtare 125, në dt. 24.08.2009.



3. Krahasimi 2013-2014, Vonesat për botim në FZ të vendimeve unifikuese

Gjatë vitit 2014, nga 4 vendime unifikuese gjithsej, vetëm dy janë dërguar për botim në Fletore Zyrtare. Duke caktuar si moment të mbylljes së vlerësimit datën 5 maj 2015, rezulton se vonesat në total janë **90¹⁰** ditë, ose mesatarisht rrëth **227 ditë (rrëth 7.5 muaj)**. Kjo është një shifer jo-definitive, duke patur parasysh që dy vendime unifikuese të 2014-ës akoma janë në pritje për t'u plotësuar me vendimin e pakicës dhe për t'u botuar mandej në Fletore Zyrtare. Gjithsesi, shifra është me tendencë irritëse, dhe jo e kundërtë.

Gjatë vitit 2013, GJL dha 5 vendime unifikuese. Vetëm njëri prej tyre u botua në serinë e fletoreve zyrtare 2013; të tjérët u botuan në serinë e vitit 2014. Vendimi unifikues penal nr. 2/2013 i shpallur në 18 Qershor 2013, ishte i fundit që u botua, me mbi një vit vonesë, në fletore zyrtare ekstra 96, e cila mban datën 29 qershor 2014¹¹. Marrë të gjitha së bashku, totali i vonesës për të botuar në Fletore Zyrtare të gjitha **vendimet unifikuese 2013** rezulton të ketë qenë 721 ditë. Mesatarisht kjo vonesë është **144 ditë (721/5), ose dicka më pak se 5 muaj**.

VITI	TOTAL	ATRIBUTETE E VENDIMIT UNIFIKUES TE GJL	LLOJI	FLETORJA ZYRTARE (FZ) KU ËSHTË BOTUAR VUGJL	VONESA ABSOLUTE	VONESA E PERLLOGARITUR PER BOTIM NE FZ (DERI 10/5/2015)
2014	1	Vendim unifikues nr.1, date 10.03.2014	Penal	Nr. 220, dt. 06.03.2015	360 dite	315 dite
	2	Vendim unifikues nr.2, date 10.03.2014	Admin.	Nr. 150, dt. 02.10.2014	170 dite	125 dite
	3	Vendim unifikues nr.3, date 28.04.2014	Admin.	ende nuk ka shkuar per botim (deri 10/3/2015)	mbi 312 dite dhe rritet....	327 e ne rritje
	4	Vendim unifikues nr.2, date 03.11.2014	Penal	ende nuk ka shkuar per botim (deri 10/3/2015)	mbi 130 dite dhe rritet....	140 e ne rritje
2013	1	Vendim unifikues nr.3, date 06.12.2013	Civil	Nr. 215, dt. 06.03.2014	90 dite	45 dite
	2	Vendim unifikues nr.4, date 10.12.2013	Civil	Nr. 216, dt. 07.03.2014	86 dite	41 dite
	3	Vendim unifikues nr.1, date 19.06.2013	Penal	Nr. 216, dt. 07.03.2014	260 dite	215 dite
	4	Vendim unifikues nr.2, date 18.06.2013	Penal	Ekstra 96 dt. 29.06.2014	385 dite	340 dite
	5	Vendim unifikues nr.3, date 08.07.2013	Penal	Nr. 163 dt. 11.11.2013	125 dite	80 dite

Vonesa mesatare për zbardhjen e plotë dhe dërgimin për botim në Fletore zyrtare të vendimeve unifikuese gjatë vitit 2014 ka pësuar një rritje mesatare me **83 ditë ose 2.7 muaj, krahasuar me vitin 2013**

¹⁰ Për dy vendimet unifikuese akoma të pa-kompletuara me vendimin e pakicës, është bërë kujdes që, sa i takon përllogaritjes së vonesës së botimit në FZ, të zbritet për secilin 15 ditë, kohë e cila nevojitet për dërgimin e aktit të plotësuar në QBZ (10 ditë) dhe më pas procesimin prej kësaj të fundit për botim në FZ (5 ditë).

¹¹ Në kohë që u mbyll vlerësimi për vitin 2013, pra në 5 mars 2014, ky vendim ishte akoma i pakompletuar, dhe nuk ishte dërguar rrjetësimisht për botim.

4. Rezultatare e monitorimit për botimin në Fletore Zyrtare të vendimeve unifikuese të GJL nga viti 2011 deri 2013

Krahasuar me volumin e vendimeve normale që GJL nxjerr çdo vit, vendimet unifikuese përfaqësojnë një numër shumë të vogël. Pavarësisht kësaj, këto lloj vendimesh përfaqësojnë jurisprudencën më të rëndësishme të GJL, pasi përmes tyre unifikohet (njehsohet) shqyrtimi gjyqësor në gjykatat e shkallëve më të ulëta. Këto vendime botohen në Fletore Zyrtare që trupa gjyqësore dhe aktorë të tjerë të procesit civil, penal, administrativ, etj, të marrin dijeni mbi normën e re që caktojnë këto vendimi dhe ta reflektojnë atë në kohë në vendimarrjen gjyqësore.

Neni 142 i Kushtetutës përcakton qartë se “*Gjykata e Lartë duhet t'i botej vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës*” (para.2). Botimi i VU tyre realizohet si përmes buletinit që harton vetë GJL, ashtu dhe përmes Fletores Zyrtare (neni 19/2 & 3, ligji 8588). Edhe në ligjin e ri për QBZ (nr. 78/2014), në listën e akteve të bo-tueshme përmenden në mënyrë ekplikite vendime unifikuese. Dërgimi i tyre për botim bëhet nga Kancelari i kësaj Gjykate (neni 9/2). Madje, në kuptimin e ligjit 78/2014, vetë titullari i institucionit është përgjegjës për dërgimin e aktit përfundimtar për botim në Fletoren Zyrtare” (neni 9/4). Por kjo përgjegjësi nuk mund t'i pretendohet gjithsesi në këtë formë kreut të një institucion kushtetues siç është GJL nga një institucion varësie siç është QBZ; edhe sikur vetëm për arsyen se ligji me të cilin organizohet QBZ është ligj i thjeshtë dhe jo organik, si ai i GJL, i cili miratohet me 3/5.

Vonesat në arsyetimin e VU bëhen shkas për vonesa në botimin e tyre në Fletore Zyrtare. Kjo është një lidhje e dukshme shkak-pasojë, pasi VU mund të proce-sohen për botim në FZ nga QBZ vetëm në formën e tyre përfundimtare, ku siguri-sht përfshihet arsyetimi i vendimit si nga shumica edhe nga pakica.

Me synimin për të gjeneruar një trend, INFOÇIP ka krahasuar vonesat në botimin e VU, 2011 -2014. Siç sugjeron tabela e kuqe në faqjen tjetër, gjatë këtyre 4 viteve të fundit, Kolegjet e Bashkuara të GJL kanë dhënë 25 vendime unifikuese. Rezulton se:



Mesatarja e vonesës absolute për këto 25 vendime të marra së bashku është 308 ditë. “Vonesa absolute” është koha nga data e vendimit deri në botimin e tij në Fletore Zyrtare.

Në total absolut, 25 vendimet unifikuese të katër viteve të fundit, të marra së bashku, kanë “pritur” rrëth 7703 ditë, ose 21 vjet nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor për të parë “dritën e botimit” në Fletore Zyrtare.

VITI	TOTAL	ATRIBUTETE E VENDIMIT UNIFIKUES TE GJL	LLOJI	FLETORJA ZYRTARE (FZ) KU ËSHTË BOTUAR VUGJL	VONESA ABSOLUTE	VONESA E PERLLOGARITUR PER BOTIM NE FZ (DERI 10/5/2015)
2014	1	Vendim unifikues nr.1, date 10.03.2014	Penal	Nr. 220, dt. 06.03.2015	360 dite	315 dite
	2	Vendim unifikues nr.2, date 10.03.2014	Admin.	Nr. 150, dt. 02.10.2014	170 dite	125 dite
	3	Vendim unifikues nr.3, date 28.04.2014	Admin.	ende nuk ka shkuar per botim (deri 10/3/2015)	mbi 312 dite dhe rritet....	327 e ne rritje
	4	Vendim unifikues nr.2, date 03.11.2014	Penal	ende nuk ka shkuar per botim (deri 10/3/2015)	mbi 130 dite dhe rritet....	140 e ne rritje
2013	5	Vendim unifikues nr.3, date 06.12.2013	Civil	Nr. 215, dt. 06.03.2014	90 dite	45 dite
	6	Vendim unifikues nr.4, date 10.12.2013	Civil	Nr. 216, dt. 07.03.2014	86 dite	41 dite
	7	Vendim unifikues nr.1, date 19.06.2013	Penal	Nr. 216, dt. 07.03.2014	260 dite	215 dite
	8	Vendim unifikues nr.2, date 18.06.2013	Penal	Ekstra 96 dt. 29.06.2014	385 dite	340 dite
2012	9	Vendim unifikues nr.3, date 08.07.2013	Penal	Nr. 163 dt. 11.11.2013	125 dite	80 dite
	10	Vendim unifikues nr.2, date 27.03.2012	Civil	Nr. 106, dt. 22.08.2012	145 dite	100 dite
	11	Vendim unifikues nr.3, date 29.06.2012	Civil	Nr. 179, dt. 11.11.2013	500 dite	465 dite
	12	Vendim unifikues nr.5, date 30.10.2012	Civil	Nr. 190, Dhjetor 2012 dalë nga shtypi me dt. 07.03.2013	127 dite	82 dite
2011	13	Vendim unifikues nr. 1, datë 17.1.2011	Civil	FZ Ekstra nr 88 pas 06.11.2012 (FZ nuk ka datë)	660 dite	615 dite
	14	Vendim unifikues nr.2, datë 21.01.2011	Civil	Nr. 114, dt. 17.09.2011	240 dite	195 dite
	15	Vendim unifikues nr.4, date 30.05.2011	Civil	Nr. 142, dt. 21.10.2011	142 dite	98 dite
	16	Vendim unifikues nr.5, date 31.05.2011	Civil	Nr. 184, dt. Dhjetor 2011 (ka dalë nga shtypi në 22.02.2012)	236 dite	191 dite
	17	Vendim unifikues nr. 6, datë 1.6.2011	Civil	Nr. 171 dt. 29.10.2013	880 dite	835 dite
	18	Vendim unifikues nr. 7, datë 1.6.2011	Civil	FZ Ekstra nr 88 pas 06.11.2012 (FZ nuk ka datë)	523 dite	478 dite
	19	Vendim unifikues nr.8, date 10.06.2011	Civil	Nr. 140, dt 14.10.2011	126 dite	81 dite
	20	Vendim unifikues nr. 1, datë 20.1.2011	penal	FZ Ekstra nr 84 dt 06.11.2012	657 dite	612 dite
	21	Vendim unifikues nr.2, date 24.01.2011	Penal	Nr. 140, dt. 14.10.2011	265 dite	220 dite
	22	Vendim unifikues nr.3, date 24.01.2011	Penal	Nr. 166, dt 27.12.2011	330 dite	285 dite
	23	Vendim unifikues nr. 4, datë 15.4 2011	penal	FZ Ekstra nr 84 dt 06.11.2012	570 dite	525 dite
	24	Vendim unifikues nr. 6, datë 30.9.2011	penal	FZ Ekstra nr 84 dt 06.11.2012	401 dite	356 dite
	25	Vendim unifikues nr.7 date 14.10.2011	Penal	Nr. 179, dhjetor 2011 (ka dalë nga shtypi në 22.01.2012)	98 dite	53 dite
TOTAL					7703DITE (21.1VJET)	6704 (18.8VJET)

Një tjetër koncept vlerësues, që INFOÇIP prezanton në këtë studim është “**matja e vonesës relative**” për botimin e VU në Fletore Zyrtare. Vonesa relative “skonton” paraprakisht nga përllogaritjet e vonesave, kohën prej 30 ditësh që ligji vendos në dispozicion të gjyqtarëve të GJL për të përfunduar arsyetimin e vendimit, nga momenti i mbylljes së shqyrtimit gjyqësor (neni 19/1). Po ashtu, kësaj kohe i “zbriten” edhe 15 ditë të tjera, që janë afatet brenda të cilave administrata e GJL ndërvepron me Qendrën e Botimeve Zyrtare për botimin e vendimit unifikues (5 ditë për institucionin dërgues dhe 10 ditë për QBZ, sipas nenin 8 dhe 10 të ligjit 78/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qëndrës së Botimeve Zyrtare”).

Mesatarja e vonesave relative për këto 25 vendime unifikuese rezulton të jetë **268 ditë deri në botimin e secilës në F. Zyrtare**

Në total, koha që ka kaluar deri sa këto 25 vendime unifikuese të batoresheshin të gjitha në fletore zyrtare (pas skadimit të kohës për shpalljen e arsyetuar + kohën e dërgimit për botim), **është 6704 ditë, ose 18.8 vjet.**

Me “rregull treshi”, po kaq kohë, pra 18.8 vjet kanë pritur edhe palët, gjyqtarët e shkallëve më të ulëta, avokatët, praktikantët e së drejtës, juristët, studjuesit e jurisprudencës së GJL, etj, për të marrë përmes Fletore Zyrtare, 21 vendimet unifikuese të GJL të 4 viteve të fundit, në formën e tyre përfundimtare (pra edhe me arsyetimet e pakicës)

Vonesa më e madhe e konstatuar mbetet ajo e botimit në FZ të Vendimit Unifikues nr.6, dt. 1/6/2011. Ky vendim rezulton të jetë botuar në fletoren zyrtare rreth 880 ditë (vonesë absolute) pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor ose 835 ditë përtej skadimit të afateve ligjore për botimin e tij

Viti 2014 shënoi sërisht një përkeqësim në drejtim të afateve të botimit në fletore zyrtare të vendimeve unifikuese, ndryshe nga viti 2013, ku u vu re një prirje drejt normalizimit të gjendjes; psh. VU civil nr. 4, dt. 10/12/2013 u botua me një vonesë realative prej vetëm 41 ditësh në FZ 216.



GJETJET E MONITORIMIT, 2014

GJYKATA E APELIT, TIRANË

Gjykata e Apelit Tiranë është gjykata më e madhe e shkallës së dytë në RSH. Ajo gjykon çdo vit një numër gjithnjë e në rritje çështjes civile dhe penale që ankimohen nga palët. Vendimet e Apelit i hapin rrugë procesit të ekzekutimit gjyqësor. Afatet e shpalljes dhe zbardhjes së këtyre vendimeve janë rrjedhimisht dyfish të rëndësishme: së pari këto afate janë të lidhura më procesin e ekzekutimit të vendimit dhe së dyti me afatet për ushtrimin e rekursit në Gjykatën e Lartë.

Për herë të parë, vlerësimi i afateve të arsyetimit dhe dorëzimit të vendimeve në Apel u ndërmor nga INFOCIP në vitin 2013¹. Qasje ishte unike dhe shënoi një risi absolute në këtë drejtim. Për këtë lloj vlerësimi u përzgjodh Gjykata e Apelit, Tiranë, si gjykata më e madhe në vend në llojin e saj.

Vlerësimi i të dhënave për vitin 2014 është bazuar mbi të njëjtën metodologji. Duke patur të dhënat e një viti të dytë, krijohen mundësi për analiza krahasimore, përllogaritjen e trendit, qoftë ky përmirësues apo përkeqësues, duke referuar një *baseline* edhe për vlerësimet të mëtejshme. Këto analiza janë risi në kuadër të këtij vlerësimi tematik dhe prezantohen për herë të parë në këtë botim.

Sic është bërë e qartë në botimin e vitit të kaluar, KPrC nuk ka të parashikuar një afat eksplicit brenda të cilit gjyqtarët e Apelit arsyetojnë dhe më pas dorëzojnë vendimet e marra/shpallura prej tyre. Praktika sugjeron se gjyqtarët e Apelit përllogarisin me analogji afatin brenda të cilit vendimet duhet të dorëzohen në Sekretarinë Gjyqësore. **Ky afat, sipas tyre, është 20 ditë** për çështjet civile.

Për vendimet penale në Apel, KPrP nuk parashikon ndarje në kohë për shpalljen e dispozitivit dhe arsyetimin e vendimit. Ato janë pjesë integrale e të njëjit vendim që duhet të shpallet me të gjithë elementët e tij (neni 383) me anë të leximit në seancën që cakton edhe mbylljen e shqyrimit gjyqësor. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes (neni 386/1). Lajmërimi për depozitim dha

kopja e vendimit i njoftohen të pandehurit që është dekluaruar në mungesë (*neni 386/2*). Graf. 5 “fotografon” situatën e **menjëhershmërisë** së dorëzimit të vendimeve penale (*afati: brenda 24 orësh*).

Neni 112 i KPrP përcakton se vendimi duhet të arsyetohet, ndryshe ai është i pavlefshëm. Origjinalitet e akteve të gjykatës (ku përfshihen edhe vendimet) depozitohen në sekretari brenda 5 ditëve nga bërja e tyre (neni 113). Përcaktimet që përmbajnë këto dy nene mund të interpretohen lidhur me afatin e dorëzimit në sekretari të vendimit penal përfundimtar edhe në Apel, i cili në këtë rast do të ishte jo më shumë se 5 ditë. Grafiku 7 (fq. 34) ofron një paraqitje të situatës së dorëzimit të vendimeve penale, vlerësuar mbi këtë afat 5-ditor.

Për arsyen që diktohen nga dy paragrafët më sipër, INFOÇIP i kontraston gjetjet për Gjykatën e Apelit, Tiranë me të dyja përcaktimet ligjore të mësipërme.

Në këtë raund të dytë, INFOÇIP ndërmerr për herë të parë një analizë krahasuese mes gjetjeve të 2013-ës dhe 2014-ës, duke synuar përvijimin e një trendi, qoftë ky përmirësues apo përkeqësues. Sa i takon matjeve dhe të dhënave për 2014-ën, vlerësimi aplikohet një për një ndaj çdo vendimi të dhënë nga GJA. Tiranë gjatë periudhës 6-mujore Janar-Korrik 2014. Në vitin 2013, meqë ishte hera e parë që aplikohet metodologjia e INFOÇIP, vlerësimi u aplikua mbi një vit të plotë kalendarik (Janar-Dhjetor). Në fakt, do të mjaftonte vetëm vlerësimi i një 6-mujori² për të arritur në konkluzione të qëndrueshme³ për të gjithë ecurinë vjetore, siç e provojnë dy tabelat më poshtë:

Rezultati Janar - Dhjetor 2013 (12 muaj)


NR	Intervali kohor	Nr i vendimeve
1	0- 20 DITE	1,859
2	mbi 20 dite	690
	TOTAL	2,549

Shprehur në %



Rezultati Janar - Korrik 2013 (6 muaj)

NR	Intervali kohor	Nr i vendimeve
1	0- 20 DITE	1,217
2	mbi 20 dite	461
	TOTAL	1,678



² Për gjykatat e shkallës së parë periudha më e ulët e mundshmë është madje 4 muaj, për shkak të numrit shumë të madh të çështjeve që merren ën shqyrtim. Parimi metodoligji është: “sa më i vogël numri i çështjeve, aq më e madhe periudha mbi të cilën aplikohet analiza”.

³ Ky aplikim në shkallë të plotë i metodës vlerësuese u bë, ndër të tjera për të testuar në praktikë diferençat teorike dhe marxinat e tolerancës misid periudhës së vlerësimit (1 vit) dhe kampionit të vlerësimit (4-6 muaj). Nga kontrastimi i të dhenave, diferenca mes tyre është vertet e pandjeshme.




1. Rezultatat e monitorimit, 2014
Vendimet civile, Gjykata e Apelit, Tiranë

Për vitin 2014, INFOÇIP analozoi 3023 vendime civile të dhëna nga Gjykata e Apelit, Tiranë. Vendimet i takojnë periudhës Janar – Korrik 2014 dhe përfaqësojnë rrith gjysmën e totalit për vitin 2014. Të gjitha janë analizuar një për një, për të ballafaquar datën e secilit vendim gjyësor me datën e dorëzimit të tij në sekretarinë e Gjykatës së Apelit, Tiranë.

Tabela dhe Graf. 1 më poshtë indikojnë se vetëm 8% e këtyre vendime janë dorëzuar brenda 24 orëve të para. Kjo e dhënë sugjeron se vetëm 8% e vendimeve janë shpallur të arsyetuara në seancën e fundit. Numri më i madh i vendimeve të analizuara, rrith 63%, janë dorëzuar 2-10 ditë pas shpalljes.

NR	EMERTIMI	NR I VENDIMEVE	SHPREHUR NE %
1	Nga 0 deri 1 dite	252	8.34
2	Nga 2 deri 10 dite	1,911	63.22
3	Nga 11 deri 20 dite	590	19.52
4	Nga 21 deri 30 dite	165	5.46
5	Mbi 30 dite	105	3.47
	TOTAL	3,023	100




Grafiku 1 indikon gjithashtu se 5.5% e vendimeve civile në Apelin e Tiranës për vitin 2014 janë arsyetur/dorëzuar 21-30 ditë pas dhënies së vendimit. Përtej 30 ditëve rezultojnë se janë dorëzuar 3.5% e totalit të vendimeve të analizuara.

Afati 20 ditor është një afat limit për dorëzimin e një vendimi civil në Apel. Ky nuk është një përcaktim eksplisit në K.Pr. C, por një "zakon i deduktuar".

Gjyqtarët e Apelit, i referohen me analogji afateve që K.Pr.C cakton për Gjykatat e Shkallës së Parë, ku gjyqtari ka 10 ditë kohë në dispozicion për të arsyetuar dhe dorëzuar vendimin në Sekretari pasi ka shpallur vetëm dispozitivin në seancë. Në këtë rast, ky afat (10 ditë) përfaqëson në vetvete $\frac{2}{3}$ e afatit që K.Pr.C ka caktuar për paraqitjen e ankimit në Apeli (15 ditë). Mbi bazën e këtij proporcioni, $\frac{2}{3}$ e afatit 30-ditor, që ligji ka caktuar për rekursin në GJL kundër vendimeve të Apelit, rezulton të jetë 20 ditë. Kjo përfaqëson përgjyqtarët e Apelit edhe afatin limit për dorëzimin e vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore.

Siq sugjeron qartësisht grafiku 2 (*poshtë*), vetëm 9% e totalit të analizuar përvitin 2014 janë vendime të dorëzuara në Sekretarinë e Gjykatës jashtë afatit 20 ditor. Kjo e dhënë, siç do ta shohim më poshtë, flet për një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me vitin 2013.

Nr	EMERTIMI	NR I VENDIMEVE	SHPREHUR NE %
1	Nga 0 deri 20 dite	2,753	91.07
2	Mbi 20 dite	270	8.93
	TOTAL	3,023	100



Si përfundim:



Nga 3023 vendime civile të dhëna nga GJA. Tiranë gjatë 2014-ës, 91% e tyre janë dorëzuar në sekretarinë e gjykatës brenda afatit 20-ditor dhe vetëm 9% jashtë këtij afati që vetë gjyqtarët e Apelit e përllogarisin si prag limit.

2. Rezultatet e kahasimit mes vitit 2014 dhe 2013 - Vendimet civile, Gjykata e Apelit, Tiranë dhe Treguesi DAV


Treguesi DAV (*Dorëzimi në Afat i Vendimeve*) është një indikator i posaçëm i konceptuar nga ekperti i INFOÇIP posaçërisht për këtë lloj vlerësimi tematik. DAV pasqyrohet në pikë përqindje. Ai është rezultat i diferençës midis vitit aktual dhe vitit paraardhës për vlerat që kanë të bëjnë më dorëzimin brenda afatit ligjor të vendimit të arsyetuar në Sekretari.

DAV përdoret për të matur progresin vit pas viti, në kushtet kur krijohet një bazë fillestare me të dhëna të krahasueshme (*baseline*). Në këtë rast ai indeksohet si “DAV vertikal”, për ta dalluar atë nga “DAV horizontal”, i cili aplikohet për të indikuar diferençat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshe brenda të njëjtës së cilës (siç do ta shohim më poshtë në rastin e krahasimit të Gjykatës së Faktit Tiranë me Gj.F. Durrës.)

Në rastin e Gjykatës së Apelit, Tiranë, në analizë futen treguesit e dorëzimit brenda aftit 20 ditor të vendimeve civile (pjesa e blertë e grafikut) gjatë vitin 2013 dhe vitin 2014.



Sikurse sugjeron edhe graf. 5 më poshtë, gjatë vitit 2014 Gjykata e Apelit Tiranë e ka përmirësuar dorëzimin e vendimeve brenda afatit 20-ditor me 18.5 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2013. Ky është një progres i dukshëm. Ai është mjaft bindës po të mbahet parasysh fakti se ngarkesa e gjyqtarëve në 2014-ën ka ardhur duke u shtuar krahasuar me 2013-ën; në 6-mujorin e parë 2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka dhënë 2549 vendime, krahasuar me 3023 vendime për të njëjtën periudhë të vitit 2014.




Si përfundim:

Në rastin e Gjykatës Apelit Tiranë, sa i takon vendimeve civile gjatë vitit 2014, treguesi DAV shënoi një rritje prej 18 %.

3. Rezultatet e monitorimit, 2014


Vendimet penale, Gjykata e Apelit, Tiranë

Për të bërë vlerësimin e vonesave për vitin 2014 u analizuan 762 vendime penale të Gjykatës së Apelit, Tiranë. Ato i takojnë periudhës Janar – Korrik 2014 dhe përfaqësojnë rrith gjysmën e totalit për vitin 2014. Nga analiza vlerësuese rezulton se vetëm 18, ose 2.36% e totalit janë dorëzuar në sekretarinë e kësaj Gjykate brenda 24 orëve të para. (Graf. 6)




Grafiku 7 ofron një vizualizim të detajuar të dorëzimit të vendimeve penale në Sekretarinë e Gjykatës së Apelit, Tiranë, të grupuara në më shumë intervale kohore. Është e rëndësishme të nënvízohet se, ndryshe nga viti 2013, gjatë vitit 2014 nuk ka vendime penale të dorëzuara në Sekretari pas më shumë se 30 ditëve, që përfaqëson një tjetër tregues pozitiv krahasuar me 2013-ën (2.9% e vendimeve për 2013 ishin dorëzuar tej afatit 30-ditor, që përfaqëson një limit kritik përsë i takon ushtrimit të të drejtës për rekurs në GJL).

Sic e përcakton qartë edhe neni 435 i KPrP, *rekursi duhet të paraqitet me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë. Ai duhet të përmbarë tregimin e saktë të shkaqeve të paligshmërisë së vendimit. Pra, njojja me arsyetimin e vendimit duhet konsideruar si një kusht logjik (a-priori) që palët të mund të paraqesin shkaqet e paligshmërisë së vendimit të Apelit në GJL.*




Neni 113 i KPrP përcakton se “*Origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre. Për aktet e ankueshme njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim*”. -Vendimet e Apelit janë në këtë kuptim akte të gjykatës, madje të ankueshme. Nëse do zgjidhnim t'i referoheshim këtij afati 5-ditor si limit brenda të cilit duhen dorëzuar vendimet penale në Sekretari, **Graf. 8** vizualizon një situatë tjeter:

NR	EMERTIMI	NR I VENDIMEVE
1	BRENDA 5 DITEVE	276
2	MBI 5 DITE	486
	TOTAL	762




Në praktikën e përditshme, gjyqtarët e Apelit përllogarisin një afat “ndryshe” sa i takon dorëzimit të arsyetuar në sekretari të një vendimi penal. Sipas tyre, ky afat “limit” është 15 ditë. Ky “limit” derivohet me analogji bazuar me reportin **afat shpallje / afat ankimi** për vendimin penal në shkallë të parë (5/10). Ky është një raport 1 me 2; me analogji, nëse afati për rekurs ndaj një vendimi penal apelli është 30 ditë, me rregull treshi afati për dorëzimin e tij në Sekretari është 15 ditë. Bazuar në këtë aftat, graf. 9 sugjeron se 97% e vendimeve janë dorëzuar brenda 15 ditëve, ndërkohë që vetëm 26 prej tyre ose 3% e totalit janë lënë jashtë këtij afati. Tabela në faqen 49 jep një paraqitje të plotë të këtyre 26 vendimeve.




4. Rezultatet e krahasimit mes vitit 2014 dhe 2013 - Vendimet penale, Gjykata e Apelit, Tiranë dhe Treguesi DAV

Në rastin e Gjykatës Apelit, Tiranë, në analizë futen treguesit e dorëzimit brenda aftit 5 ditore të vendimeve penale, respektivisht për vitin 2013 (graf. 10) dhe për vitin 2014 (graf.11). Pjesa bojeqelli indikon vendimet e dorezuara brenda afatit 5-ditor.



Sikurse sugjeron qartësisht edhe graf. 12, gjatë vitit 2014 Gjykata e Apelit Tiranë ka përmirësuar treguesin DAV me 9 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2013. Ky është një progres i dukshëm në kuadër të këtij vlerësimi tematik dy-vjeçar. Ai është bindës po të mbahet parasysh dhe fakti se ngarkesa e gjyqtarëve në vitin 2014 ka ardhur duke u shtuar krahasuar me vitin 2013. Siç kuptohet qartësisht nga të dhënrat e paraqitura, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 Gjykata e Apelit Tiranë ka dhënë 505 vendime penale, krahasuar me 762 vendime për të njëjtën periudhë të vitit 2014.



Si përfundim:

Në rastin e gjykatës Apelit Tiranë, sa i takon vendimeve penale gjatë vitit 2014, treguesi DAV shënoi një rritje prej 9 %



NR VENDIMIT	DATA VENDIMIT	DATA DOREZIMIT	DIFERENCA GJITHSEJ NE DITE
16	16.01.2014	03.02.2014	18
43	22.01.2014	07.02.2014	16
67	29.01.2014	17.02.2014	19
228	05.03.2014	24.03.2014	19
250	10.03.2014	27.03.2014	17
262	17.03.2014	03.04.2014	17
271	19.03.2014	07.04.2014	19
277	19.03.2014	07.04.2014	19
287	20.03.2014	09.04.2014	20
288	20.03.2014	11.04.2014	22
299	24.03.2014	10.04.2014	17
322	31.03.2014	17.04.2014	17
349	07.04.2014	25.04.2014	18
350	07.04.2014	25.04.2014	18
361	09.04.2014	28.04.2014	19
377	11.04.2014	28.04.2014	17
415	23.04.2014	20.05.2014	27
440	30.04.2014	19.05.2014	19
461	05.05.2014	28.05.2014	23
467	07.05.2014	26.05.2014	19
470	07.05.2014	28.05.2014	21
471	07.05.2014	26.05.2014	19
522	19.05.2014	04.06.2014	16
616	13.06.2014	29.06.2014	16
625	16.06.2014	02.07.2014	16
628	16.06.2014	02.07.2014	16



GJETJET E MONITORIMIT, 2014

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË, TIRANË

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë realizon numrin më të madh të shqyrtimeve gjyqësore krahasuar me çdo gjykatë tjeter të shkallës së parë në RSH. Pjesa dërmuese e vendimeve që merr kjo Gjykatë janë për çështje civile. Trupa e kësaj gjykata është më e madhja në vend, me 76 gjyqtarë, të cilët në përdorim kanë vetëm 14 sala gjyqi.

Deri dy vjet më parë, fenomeni i vonesave në dorëzimin e vendimeve gjyqësore edhe në këtë gjykatë njihej dhe pranohej, por përmasat reale nuk ishin **"fotografuar"** asnjëherë. INFOÇIP ishte i parë operator i specializuar që, përmes një metode autentike, bëri matjen dhe vlerësimin e këtij fenomeni. INFOÇIP zgjodhi t'i largohej metodave me kampionim (që përzgjedhin 20-30 çështje për analizë) dhe të vlerësojë në bllok integral të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata brenda një periudhe jo më të vogël se 4-mujore. Vlerësimi në këtë rast aplikohet një për një ndaj çdo vendimi që ka dhënë gjykata brenda kësaj periudhe kohore.

Për vitin 2014, INFOÇIP mbloodi dhe analizoi **5401 vendimet civile⁴** të dhëna nga Gjykata e Faktit, Tiranë. Këto përfaqësojnë 1/3 e totalit të vendimeve vjetore. Rezultatet e gjeneruar nga analizimi i tyre konsiderohen si përgjithësuese për të gjithë vitin (*shih Metodologjia*).

Edhe për vitin 2014, njësoj si për vitin 2013 është përzgjedhur për analizë katër-mujori i parë i vinit, me qëllim krijimin e një baze krahasueshmërie jo vetëm sasiore, por edhe kalendarike. Me kompletimin e kësaj baze të dhënash, për herë të parë, INFOÇIP ka krahasuar treguesit e vonesave për vitin 2014 me vitin 2013.


Analiza e trendit realizohet për herë të parë përmes një treguesi të posaçëm, të quajtur DAV, të prodhuar nga ekspertët e INFOÇIP posaçarërisht për këtë lloj *research-i*. Krahasimi i rezultateve vjetore synon të indikojë progresin apo regresin eventual të shënuar, si dhe të ofrojë një perspektivë të re për të kuptuar më në thellësi shkaqet që qëndrojnë pas rasteve të përsëritura të vonesave në dorëzimin e vendimeve.

⁴ Burimi: Regjistri (Numratori) i Çështjeve Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 2014

Në Gjykatën e Faktit Tiranë depozitohen lloje të ndryshme padish për çështje civile. Në varësi të specifikës së çështjeve apo ecurisë së procesit të shqyrtimit gjyqësor, vendimet apo zgjidhjet që jep gjykata mund të jenë të llojeve të ndryshme. Tabela dhe Graf. 12 ofrojnë një paraqitje të detajuar të vendimeve civile të dhëna nga GJ.F. Tiranë, sipas llojit të tyre, gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2014.

NR	EMERTIM	NR. VENDIMI
1	Pranuar	1,426
2	Rrezuar	303
3	Pranuar pjeserisht	325
4	Pushuar	1,295
5	Kthim	149
6	Moskompetence	1,880
7	Marreveshje ose pajtuar	17
8	Rrefuzuar	2
9	Te tjera	4
	TOTAL	5,401


Graf.13



Për të lehtësuar analizën, metoda e përdorur nga INFOÇIP “filtroi” përpunim të mëtejshëm **2054** vendime (padi civile “**të pranuara**”, “**të pranuara pjesërisht**”, dhe “**të rrëzuara**”). Këto lloj vendimesh janë “klasike”, në kuptimin që shpallja e dispozitivit të tyre, arsyetimi që pason dhe dorëzimi në Sekretarinë e Gjykatës, mund të kontrastohen drejtëpërdrejt me afatet ligjore që caktojnë dispozitat e neni 308 të KPr.C.

NR	EMERTIM	VENDIME
1	Vendime ne analize	2,054
2	Vendime jashte analize	3,347
	TOTAL	5,401

SHPREHUR NË %



Graf.14

Sipas një arsyetimi interpretues të nenit 308 të KPrC, në procesin e dhënies së një vendimi gjyqësor përfundimtar, presupozohet se gjyqtari **duhet ta shpallë atë të arsyetuar, të nënshkruar, ta dorëzojë menjëherë në sekretari**. Në qoftë se çështja është e ndërlikuar, gjyqtari ka dy alternativa: 1- të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit dhe ta dorëzojë vendimin të arsyetuar brenda dhjetë ditëve ose, 2- ta shtyjë shpalljen e vendimit por, brenda pesë ditëve, ta shpallë atë të arsyetuar (*shih më gjërësisht interpretimet nga I. Panda, fq.55, edicioni I, botimi i vitit 2014*).

Për arsyet që lidhen me këto diferencime që bën nenit 308 i KPrC, është me interes të “fotografohet” shpérndarja sipas fashave kohore e dorëzimit të vendimeve civile në sekretatinë e Gjykatës së Faktit Tiranë. Një qasje e tillë ofron mundësi për të vlerësuar se ku janë grumbullimet më të mëdha të vendimeve civile në terma të kohës së arsyetimit dhe dorëzimit të tyre. Një panoramë të tillë e ofron grafiku 14 (faqja tjeter).

Nga **2054** vendime të analizuara për 2014-ën, vetëm 16 prej tyre janë dorëzuar në sekretari brenda 24 orëve⁵ nga momenti i marrjes së vendimit. Kjo përfaqëson vetëm 0.78% të totalit të vendimeve nën vlerësim prej kësaj analize.

Shumica e vendimeve, konkretisht **1039** vendime ose 63.79% e totalit që analizohet rezulton se janë dorëzuar të arsyetuara në Sekretari 10 ditë nga shpallja. Në një interpretim të drejtpërdrejtë të dispozitave që përmban nenit 308 i KPrC, këto vendime përkojnë me ato që konsiderohen “çështje të ndërlikuara”.

Nga analiza rezulton se **411** vendime, ose 20% e totalit, janë dorëzuar të arsyetuara në sekretari nga 11-15 ditë pas shpalljes.

Ndërkohë, përtëj limitit 15 ditor, i cili konsiderohet kritik si për shkak të përcaktimeve në K.Pr.C ashtu edhe për shkak të afateve të ankimit në Apel, rezulton se janë dorëzuar 316 vendime, ose 15.4% e totalit të analizuar (**graf. 14**)

Neni 308 (Ndryshuar paragrafi I me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, nenit 58)


Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin.

Në çështje të ndërlikuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se dhjetë ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në pesë ditë.


Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përvèç kur ai ia beson këtë njërit prej anëtarëve të trupit gjykues.

⁵ Intervali “24-orë” nuk përshkruan besnikërisht atë që në kuptimin e nenit 308 do të konsiderohet “dorëzim menjëherë në Sekretari”. Për të lehtësuar përllogaritjet, autorët e studimit ranë dakort për konvencion që 24-orëshi të konsiderohet një tautologji për “dorëzim të menjëherëshëm”.

Nr	Emertimi	Nr vendimesh	Shprehur ne %
1	Nga 0- 1 dite	16	0.78
2	Nga 2- 10 dite	1,309	63.79
3	Nga 11- 15 dite	411	20.03
4	Mbi 15 dite	316	15.40
	Total	2,052	100




Nëse do t'i përbaheshim interpretimit të afateve të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, sikurse përcakton neni 308 i KPrC, dhe t'i ndanim vendimet civile të marra në analizë vetëm në dy kategori: (a) *arsyetuar/ dorëzuar brenda 10 ditësh*, dhe (b) *arsyetuar/ dorëzuar përtej afatit 10 ditor*, atëherë do të kishin një vizualizim edhe më të thjeshtuar të situatës së vonesave në Gjykatën e Tiranës për vitin 2014 (grafiku 15).



2. Krahasimi me treguesit e vitit 2013 për dorëzimin në afat të vendimeve


Permiresimi i arritur nga Gjykata e Faktit, Tiranë gjatë vitit 2014 është rreth 7 % krahasuar me vitin 2013. Ky është gjithashtu një tregues suksesi në kuadër të këtij vlerësimi tematik. Duhet theksuar gjithsesi se ngarkesa e gjyqtarëve ka pësuar rënje në vitin 2014, krahasuar me një vit më parë. Kjo i atribuohet “përthihjes” në rritje të çështjeve gjyqësore që janë kompetencë e gjykatës administrative , të cilat deri në fillim të 2013-ës vijonin akoma të gjykheshin në Gjykaten e Faktit Tiranë.

Viti 2014




Graf.17

Viti 2013



Graf.18

Graf.19



dëshira e gjykatave administrative të analizuara në total. Pra vendimet për mos-kompetencë arrijnë pothuajse në 1/3 e totalit të analizuar për vitin 2014.

Treguesi DAV në këtë rast, përvçese mat një rritje me 7% në GJ.F. Tiranë, indikon edhe një marrdhënie shumë të rëndësishme shkakësore: **nëse ngarkesa e gjyqtarëve ulet, po ashtu ulen edhe vonesat në dorëzimin dhe arsyetimin e vendimeve**. Kjo ka qenë një ndër tezat e rëndësishme që ky studim mori përsipër të provojë që në edicionin e tij të parë. Teza është dyfish e provuar, po të mbajmë parasysh se treguesit e Gjykatave Administrative, siç edhe do ta shohim më poshtë, janë përkeqësuar në 2014, për shkak të rritjes së ngarkesës.

Totali absolut i vendimeve të dhëna nga GJ.F. Tiranë është rritur për vitin 2014, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013 (respektivisht 5401 për vitin 2014 dhe 4756 për vitin 2013). Nga ana tjetër vihet re se numri i vendimeve “për mos-kompetencë gjykimi”, gjithashtu ka pësuar rritje nga 2013 në 2014. Nga vetëm 49 vendime të tilla në një total prej 4756 vendimesh të analizuara në 2013, në 2014 ky raport arrin në 1880 ven-



Konkluzionet e monitorimit përvendimet civile në Gjykatën e Faktit, Tiranë, 2014

Nga vlerësimi rezulton se:

Nga 2054 vendime civile të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, të analizuara nga ku studim, vetëm 65 % e tyre janë arsyetur dhe/ose dorëzuar në Sekretarinë e Gjykatës brenda afatit 10 ditë që cakton KPrC.

I riformular ky konkluzion në termat të zbatueshmërisë së ligjit, do mund të pohoj se:

Dhoma Civile e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, ka mundur të zbatojë deri në masën 65% përcaktimet ligjore mbi afatin maksimal të lejuar nga neni 308 i KPRC përvendimt përfundimtar në sekretarinë e gjykatës (Janar-Prill 2014)

Automatisht mund të pohohet se:

Gjatë vitit 2014, Gjykata e Faktit Tiranë ka përmirësuar me 7% treguesin e dorëzimit në afat të vendimeve civile, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013. Ky përmirësim i atribuohet kryesisht uljes së ngarkesës së gjyqtarëve si rrjedhojë e mos-kompetencës në gjykimin e çështjeve administrative.

Vendimi civil me vonesën mbi 15 ditë:

Gjatë periudhës së monitoruar në 2014-ën, rreth 15% e totalit të vendimeve të Gjykatës së Faktit, Tiranë janë dorëzuar në sekretari përtej 15 ditësh nga shpallja e tyre. Ky është një tregues jo-pozitiv, edhe pse krahasuar me vitin 2013, ai ka shënuar përmirësim me 6 pikë përqindje.

Vonesat mbi 30 ditë:

Gjatë 4-mujorit të parë të 2014-ës, rezultojnë 28 vendime civile të Gjykatës së Faktit Tiranë të cilat janë dorëzuar në sekretari me mbi 30 ditë vonesë nga data e shpalljes. Ky është një afat kritik i parashikuar nga normat irregullatore të KLD

Vonesat "shumë problematike" në dorëzimin e vendimeve civile

Tabela më poshtë grupon të gjitha vendimet civile që rezultojnë të janë dorëzuar **30 ditë** pas shpalljes së tyre. Pragu 30 ditor konsiderohet "shumë problematik", sa i takon dorëzimit të vendimeve në shkallën e parë. Pa folur për tejkalinin tre-fish të normës procedurale, dorëzimi i një vendimi 30 ditë nga shpallja tejkalon me dy-fish edhe atë që konsiderohet si një afat limit "i arsyeshëm" për vonesa (15 ditë).

NR VENDIMIT	DATA VENDIMIT	DATA DOREZIMIT	DIFERENCA GJITHSEJ NE DITE	DISPOZITIVI
772	24.01.2014	03.03.2014	38	PRANUAR PJESERISHT
973	27.01.2014	03.03.2014	35	PRANUAR PJESERISHT
2284	18.02.2014	27.03.2014	37	PRANUAR
2590	24.02.2014	28.03.2014	32	PRANUAR PJESERISHT
2602	24.02.2014	31.03.2014	35	PRANUAR PJESERISHT
2927	03.03.2014	04.04.2014	32	PRANUAR
3832	24.03.2014	26.03.2014	33	PRANUAR
3872	24.03.2014	02.05.2014	39	PRANUAR
3873	24.03.2014	02.05.2014	39	PRANUAR PJESERISHT
3879	24.03.2014	29.04.2014	36	PRANUAR
3912	25.03.2014	02.05.2014	38	PRANUAR
3930	25.03.2014	02.05.2014	38	PRANUAR
3944	25.03.2014	29.04.2014	35	PRANUAR PJESERISHT
3964	26.03.2014	30.04.2014	35	PRANUAR
4030	27.03.2014	02.05.2014	39	PRANUAR
4057	28.03.2014	29.04.2014	32	PRANUAR
4088	28.03.2014	02.05.2014	35	PRANUAR
4418	07.04.2014	14.05.2014	37	PRANUAR PJESERISHT
4682	11.04.2014	30.06.2014	80	RREZUAR
5173	25.04.2014	02.06.2014	39	RREZUAR
5216	25.04.2014	26.05.2014	31	PRANUAR
5217	25.04.2014	26.05.2014	31	PRANUAR
5255	28.04.2014	09.06.2014	42	RREZUAR
5282	28.04.2014	02.06.2014	35	PRANUAR PJESERISHT
5354	30.04.2014	09.06.2014	39	PRANUAR PJESERISHT
5374	30.04.2014	09.06.2014	39	RREZUAR
5383	30.04.2014	02.06.2014	32	PRANUAR
5400	30.04.2014	09.06.2014	39	PRANUAR



Numratori i vendimeve civile në Gjykatat e Shkallës së Parë

Vendimi	Nr.	Datë	Data e paraqitjes	Regjistri		Numri i seancave	Afati i dorëzimit
				Nr.	Datë		
4681.	11.04.14	18.12.13	6792	14.02.13		(3)	20.04.14
4682	11.04.2014	17.10.12	1469	16.10.12		(17)	30.06.14
4683	11.04.2014	11.02.13	2238	08.02.13		(1)	18.04.14
4684	11.4.14	13.3.13	2616	13.03.13		(12)	15.04.14
4685	11.4.14	10.2.14	8313	10.2.14		(3)	15.04.14
4686	11.4.14	28.3.13	2766	28.3.13		(11)	15.04.14
4687	11.4.14	2.6.12	1030	7.6.12		(15)	21.04.14
4688	11/04/2014	12/03/2014	9086	11/03/2014	38	(1)	15.04.14
4689	11-04-2014	15-10-2011	486	12-10-2011		(16)	22.04.14
4690	11-04-2014	01-01-2014	8014	03-01-2014	10	(2)	25.04.14

Vonesa më e madhe e konstatuar në dorëzimin e një vendimi gjyqësor civil në Gjykatën e Faktit, Tiranë për periudhën e monitoruar **Janar-Prill 2014** është 81 ditë nga data e shpalljes. **Ky është vendimi nr. 4682, dt. 11.04.2014,** i cili rezulton të jetë dorëzuar më datë **30.06.2014** (shih faksimilen e N.C.)



GJETJET E MONITORIMIT, 2014

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË, DURRËS

Në këtë edicion të dytë të vlerësimit tematik mbi vonesat në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore, INFOÇIP ka përfshirë edhe Gjykatën Shkallës së Parë, Durrës. Kjo gjykata gjithashtu përballon një ngarkesë relativisht të madhe çështjesh për shkak edhe të popullatës relativisht të madhe që përfshihet në juridiksionin e saj.

Gjykata e Faktit Durrës ka një trupë prej 17 gjyqtarësh, të gjithë të vendosur në zyra të cilat i ndajnë me sekretaret gjyqësore. Gjykata ka në dispozicion vetëm katër salla, nga të cilat tre civile dhe një penale së cilës i mungon dhoma e izolimit. Për këtë arsy nji pjesë e mirë e proceseve gjyqësore zhvillohet në zyrat e gjyqtarëve. Gjykatës i mungon ambienti i marrëdhënieve me publikun. Komunikimi me këtë ambient, (kryesekretarinë), realizohet nga dritarja e kësaj të fundit. Gjykata ka një hyrje kryesore nga e cila futet si administrata dhe gjyqtarët, ashtu edhe publiku. Në tërësi godina ka problem mungesen e hapësirës së punës dhe funksionalitetin.

Është me vend të theksohet se pikënisja e INFOÇIP për të ndërmarrë një vlerësim të posaçëm për vonesat në dorëzimin e vendieve ka qenë pikërisht Gjykata e Durrësit, e cila në shtator të vitit 2012 u vu në epiqëndër të opinionit publik dhe të organeve të dresjtësise për shkak të rastit I.Xhakja dhe ngjarjeve që kulmuuan tragjikisht me vrasjen e komisarit të policisë, A. Tahiri. Hallkë e zinxhirit të pasojave tragjike ishte edhe vonesat e pajustifikuara në dorëzimin e vendimit nga gjyqtari N.T, ish anëtar i trupës së kësaj gjykte.


Edhe për gjykatën e faktit Durrës, njësoj si për Tiranën, u analizuan një për një të gjitha vendimet e dhëna gjatë një intervali të pandërprerë kohor prej katër muajsh. INFOÇIP mblodhi dhe analizoi **662 vendimet civile¹**, që përfaqësojnë rreth 1/3 e totalit të vendimeve të dhëna gjatë 2014-ës. Rezultatet e gjeneruar nga analizimi i tyre konsiderohën përgjithësuese për të gjithë vitin (*shih Metodologjia*).

1

Burimi: Regjstri (Numratori) i Çështjeve Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 2014


Në varësi të specifikës së çështjeve apo ecurisë së procesit të shqyrtimit gjyqësor, vendimet apo zgjidhjet që jep gjykata mund të janë të llojeve të ndryshme. Tabela më poshtë ofron një paraqitje të detajuar të vendimeve të marra nga GJ.F. Durrës gjatë katër-mujorit të parë të vitit 2014.

NR	EMERTIMI	NR I VENDIMEVE	SHPREHUR NE %
1	KTHIM	39	5.89
2	MOSKOMPETENCE	88	13.29
3	PRANIM	288	43.50
4	PRANIM I PJESSHEM	26	3.93
5	PUSHIM GJYKIMI	170	25.68
6	RREZIM GJYKIMI & PUSHIM	15	2.27
7	RREZIM KERKESE (RREFUZIM)	17	2.57
8	S' KA INFORMACION	19	2.87
	TOTAL	662	100



Për të lehtësuar analizën, metoda e përdorur nga INFOÇIP “filtroi” për përpunim të mëtejshëm 329 vendime (padi civile “të pranuara”, “të pranuara pjesërisht”, dhe “të rrëzuara”). Këto lloj vendimesh janë “klasike”, në kuptimin që shpallja e dispozitivit të tyre, arsyetimi që pason dhe dorëzimi në Sekretarinë e Gjykatës, mund të kontrastohen drejtpërdrejt me afatet ligjore që caktojnë dispozitat e nenit 308 të KPr.C.

NR	EMERTIM	NR. VENDIMI
1	VENDIME NE ANALIZE	329
2	VENDIME JASHTE ANALIZE	333
	TOTAL	662




Sipas interpretimeve të nenit 308 të KPrC, gjyqtari **duhet ta shpallë vendimin të arsyetuar, të nënshkruar, ta dorëzojë menjëherë në sekretari**. Në qoftë se çështja është e ndërlikuar, gjyqtari ka dy alternativa: 1- të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit dhe ta dorëzojë vendimin të arsyetuar brenda dhjetë ditëve ose, 2- ta shtyjë shpalljen e vendimit por, brenda pesë ditëve, ta shpallë atë të arsyetuar (*shih më gjërësisht interpretimet nga I. Panda, fq.55*).

Nga **329** vendimet e analizuara për 2014-ën, vetëm 7, ose 2 % e totalit rezultojnë të janë dorëzuar në sekretari brenda 24 orëve² të para. Shumica e vendimeve, konkretisht **237** vendime ose rrëth 72% e totalit që analizohet rezulton se janë dorëzuar në Sekretari 2-10 ditë nga shpallja. Në një interpretim të drejtpërdrejtë të dispozitave që përban neni 308 i KPrC, këto vendime përkijnë me ato që konsiderohen “çështje të ndërlikuara”.

Analiza sugjeron se 23% e vendimeve, janë dorëzuar në sekretari nga 11-15 ditë pas shpalljes. Ndërkohë, përtëj limitit 15 ditor, i cili konsiderohet kritik si për shkak të përcaktiveve në K. Pr. C., ashtu edhe për shkak të afateve të ankimit, rezultojnë se janë dorëzuar vetëm 9 vendime, ose 2.7% e totalit të analizuar (*shih: graf. 22*)


NR	EMERTIMI	NR I VENDIMEVE	SHPREHUR NE %
1	Nga 0 deri 1 dite	7	2.13
2	Nga 2 deri 10 dite	237	72.04
3	Nga 11 deri 15 dite	76	23.10
4	Mbi 15 dite	9	2.74
	TOTAL	329	100



² Intervali “24-orë” nuk përvkruan besnikërisht atë që në kuptimin e nenit 308 do të konsiderohet “dorëzim menjëherë në Sekretari”. Për të lehtësuar përllogaritjet, autorët e studimit ranë dakort për konvencion që 24-orëshi të konsiderohet një tautologji për “dorëzim të menjhershëm”.

Nëse do t'i përbaheshim interpretimit të afateve të dorëzimit të vendimit të arsyetuar sikurse përcakton neni 308 i KPrC dhe t'i ndanim vendimet civile të marra në analizë vetëm në dy kategori: (a) dorëzuar/ arsyetuar brenda afatit 10 ditor, dhe (b) dorëzuar/arsyetuar përtej afatit 10 ditor, atëherë do të kishin një vizualizim edhe më të thjeshtuar të situatës së vonesave në Gjykatën e Tiranës (*grafiku nr.....*)

VENDIME CIVILE - GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR DURRES JANAR - PRILL 2014			
NR	VENDIME GJITHSEJ	TE MBYLLURA 0 - 10 DITE	TE MBYLLURA MBI 10 DITE
1	329	244	85



Graf.23

Konkluzionet e monitorimit për vendimet civile në Gjykatën e Faktit, Tiranë

Nga vlerësimi rezulton se:

Nga 329 vendime civile të Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, të analizuara nga ku studim, 74.17% janë arsyetuar dhe/ose dorëzuar në Sekretarinë e Gjykatës brenda afatit 10 ditor që cakton KPrC.

Nëse do ta riformuloni këtë konklusion në terma të zbatueshmërisë së ligjit, do të rezultonte se:




Dhoma Civile e Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, ka mundur të zbatojë deri në masën 74.17% përcaktimet ligjore mbi afatin maksimal të lejuar nga neni 308 i KPRC për dorëzimin e arsyetuar të vendimit përfundimtar në sekretarinë e gjykatës (Janar-Prill 2014)

Krahasimi me treguesit e Tiranës. Treguesi DAV horizontal

Pjesë e rëndësishme e këtij studimi është edhe krahasimi i treguesve mes dy gjykatave të të njëjtë lloj. Ky lloj vlerësimi realizohet për herë të parë dhe synon të ofrojë të pamje të re për kuptuar më mirë dinamikat që favorizojnë (ose jo) dorëzimin në afat të vendimeve. Sikurse është analizuar edhe në botimin e vitit të kaluar, shkaqet që mund të ndikojnë në vonesat e dorëzimit të vendimeve janë ngarkesat e gjyqtarëve, nganjeherë paaftësia dhe në raste me të tjera edhe korrupsi.

Objekt krahasimi për këtë ushtrim të posaçëm janë Gjykata e Faktit Tiranë dhe Gjykata e Faktit Durrës. Në një rast të tillë, treguesi DAV aplikohet për një vlerësim të tipit horizontal dhe jo vertikal, sikurse është ai që indikon progresin nga viti në viti në të njëjtën gjykatë.


Periudhat që do të kontrastohen mes dy gjykatave janë të njëta, praktikisht Janar – Prill, 2014. Llojet e vendimeve civile të analizuara janë gjithashtu të njëjta: “pranuar”, “pranuar pjesërisht” dhe “rrezuar”. Afati limit mbi të cilin vlerësohet dorëzimi i një vendimi të arsyetur në sekretarinë e gjykatës është 10 ditë. Gjykata e Tiranës ka dorëzuar 65% në këtë afat (graf...), kurse e Durrësit 74.17 % (graf.)



Treguesi DAV (graf....) indikon një epërsi prej 9 pikë përqindje të gjykatës së Faktit Durrës krahasuar me analogën e saj në Tiranë. E thënë më fjalë të tjera, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka tregues më të mirë sa i takon dorëzimit në afat të vendimeve civile (brenda 10 ditësh), krahasuar me gjykatën e Faktit Tiranë.më e madhja në vend.

Edhe nëse ky krahasim mes Durrësit dhe Tiranës do të bëhej mbi një afati 15 ditor dorëzimi, rezultati do të ishte sërish i njëjtë. Treguesin DAV do ta rendiste 9% më mirë Gjykatën e Faktit, Durrës krahasuar me atë të Tiranës, siç ilustron qartësisht grafiku më poshtë.

Kjo koherencë në të dyja fashat kohore të marra në analizë, është provë e pakundërshtueshmë e avantazhit të Gjykatës së Faktit Durrësi krahasuar me atë të të Faktit Tiranë sa i takon dorëzimit në afat të vendimeve. Gjithashtu rezultati i përfthuar nga treguesi DAV është një provë direkte e saktësisë në matëse të këtij mjeti/instrumenti metodologjik të krijuar nga ekspertët e INFOÇIP.



Si përfundim, mund të thuhet se për vitin 2014, Gjykata e Shkallës së Parë, Durrës, ka performuar më mirë se Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë sa i takon dorëzimit në afat të vendimeve civile në sekretarinë e gjykatës

Vlen të theksohet se treguesi DAV është një indikator absolut. Ai nuk relativizion, apo ponderon rezultatin bazuar në diferençat që mund të këtë në ngarkesën e gjyqtarëve, vështirësinë e çështjeve që vijnë për shqyrtim, apo përgatitijes së trupës gjyqësore, apo edhe cilësisë së arsyetimit të vendimeve.

NE VEND TE REKOMANDIMEVE...

Nga monitorimi që Fondacioni Soros i ka bërë Strategjisë Ndërsektoriale të Sistemit të Drejtësisë, ka rezultuar se, është veçanërisht aktual dhe prioritar, zbatimi i masave për modernizmin e aspekteve funksionale të zhvillimit të veprimitarës gjyqësore, për infrastrukturën e përshtatshme, për kushtet e punës, për sigurinë, aksesin e publikut në gjykata etj. Në raport evidentohet se përmembushja e objektivave strategjikë për infrastrukturën në gjyqësor kompromentohet nga niveli i alokimeve buxhetore dhe problemet teknike që kanë të bëjnë kryesish me gjetjen e trojeve të ndërtimit, vonesa në parashikimet buxhetore dhe në zbatimin e projekteve (gati gjysma e masave të planifikuarë për t'u ndërmarrë janë në tejkalim të afateve të vendosura apo të pazbatuara).

Lidhur me Gjykatën e Faktit Durrës, problematika e infrastrukturës është shumë e imprehtë. Kjo gjykatë ka në stafin e saj 17 gjyqtarë. Të gjithë gjyqtarët janë vendlodur në zyra të cilat i ndajnë me sekretaret gjyqësore. Gjykata ka në dispozicion vetëm katër salla, nga të cilat tre civile dhe një penale. Kësaj të fundit së i mungon dhoma e izolimit. Për këtë arsy që pjesë e mirë e proceseve gjyqësore zhvillohet në zyrat e gjyqtarëve.

Gjykatës i mungon ambienti i marrëdhënieve me publikun. Komunikimi me këtë ambient, (kryesekretarinë), realizohet nga dritarja e kësaj të fundit, e cila sheh nga ana e pasme e gjykatës. INFOÇIP pati mundësi të konstatonte nga afër kushtet shumë të vështira të punës dhe ngarkesën shumë e madhe që përballohej nga personat që punojnë në këtë sektor. Megjithatë, personeli i Kryesekretari të është shumë i dedikuar, punon me orë të zgjatura, madje edhe te djelave për të administruar dosjet gjyqësore të dorëzuara. Hapësira fizike është e pamjaftueshme edhe për sistemimin normal të dosjeve, duke u kthyer në një problem që kërkon zgjidhje imediate.

Edhe sistemi elektronik manifeston probleme serioze sa i takon funksionimit dhe efikasitetit. Mund të thuhet se ai është krejt i padobishem për të përpunuar sikur edhe të dhënët më të thjeshta.

Gjykata ka një hyrje kryesore nga e cila futet si administrata dhe gjyqtarët, ashtu edhe publiku. Hyrja e të pandehurve bëhet nga oborri në pjesën e pasme të godinës.

Në tërësi godina e gjykatës paraqet probleme të mungesës së sipërfaqes së punës dhe mungesë të skemës funksionale. Mungesa e këtyre dy elementeve kryesore sjell për pasojë mungesën apo deficiencën e elementeve të sigurisë. Godina e gjykatës ka pësuar ndryshime gjatë viteve duke realizuar shtesa kati etj., për rritjen e sipërfaqes së punës, por pa zgjidhur tërësisht nevojat e saj.

Pozicionimi aktual i Gjykatës së Faktit Durrës nuk jep mundësi për zgjerime të tjera prandaj ndërtimi i një godine të re do të mund të plotësojë nevojat për salla dhe ambiente të tjera, për të cilat kjo gjykatë ka nevojë. Nga ana tjetër, godina e re do të mundësojë aplikimin e një skeme funksionale sipas standardeve të kërkua të dha do të rrisë elementet e sigurisë.



KAPITULLI III

GJYKATAT ADMINISTRATIVE

SHKURT MBI GJYKATAT ADMINISTRATIVE

Sistemi i drejtësisë administrative, si një degë e pavarur e gjyqësorit, ekziston vetëm prej tre vjetësh në Shqipëri. Ai zë fill me miratimin e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Sistemi i gjykatave administrative, njësoj si për gjykatat e zakonshme, organizohet në tre shkallë; gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Aktualisht në Shqipëri funksionojnë 6 gjykatat administrative të shkallës së parë në: Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë dhe një Gjykatë Administrative Apeli, me seli në Tiranë. Kjo e fundit ka 7 gjyqtarë, ndërsa gjykatat e shkallës së parë kanë të gjitha së bashku 36 gjyqtarë. Ky është një numër i ulët krahasuar me ngarkesën gjithnjë në rritje të çështjeve që iniciohen apo përcillen për gjykim në këto gjykatat.

Një ndër tiparet kryesore të gjykit të administrativ është shpejtësia me të cilën ai duhet të realizohet. Ligji 49/2012 nuk parashikon afate për gjykimin e mosmarrëveshjeve në gjykatat e shkallës së parë, por ka përcaktuar afatin 30 ditor për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Apelit Administrativ (neni 48) dhe afatin 90 ditor për shqyrtimin e çështjes në Kolegin Administrativ të Gjykatës së Lartë (neni 60).

Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor, njësoj si edhe për gjykatat e tjera të zakonshme, përllogaritet nga momenti i depozitimit të padisë deri në momentin e dorëzimit në sekretari të vendimit gjyqësor.

Vendimi, pavarësisht formës së gjykit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar. Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykatat shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë. Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore. Ky përcaktim ligjor është i identitik i njëjtë si për gjykimin në shkallë të parë (neni 42) ashtu edhe për atë në shkallë të dytë (neni 55). Sa i takon rekurseve në Gjykatën e Lartë, ligji lejon shtyrje deri në 10 ditë për shpalljen e arsyetuar të vendimit. Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore (Neni 64).



GJETJET E MONITORIMIT, 2014

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Gjykata Administrative e Apelit është e vendosur në Tiranë. Ajo është e vetmja gjykatë e nivelistët në sistemin e gjykatave administrative në RSH.

Gjykata Administrative e Apelit gjatë vitit 2014 përballoj një volum të lartë pune me 4745 çështje administrative të gjikuara. Gjithsej u rregjistruan 11240 çështje gjatë vitit 2014. Prurja e jashtëzakonshme gjatë vitit 2014 erdhë nga dhomat civile të gjykatave të zakonshme, të cilat shpallën mos-kompetencën e tyre të gjykimit. Rreth 4698 çështje erdhën nga gjykatat civile të apeleve ndërsa 6543 çështje u sollien nga gjykatat administrative të shkallës së parë.

Ky volum çështjesh u transferua në Gjykatën Administrative të Apelit në një periudhë tepër të shkurtër kohore, nga muaji Shkurt deri në muajin Korrik 2014. Një volum i tillë çështjesh, krijoi vështirësi serioze për administratën gjyqësore në procesin e kryerjes së veprimeve administrative, si dhe një pamundësi objektive për trupën gjyqësore që t'i shqyrtonë ato si brenda afatit 30 ditor.

Gjykimi 4745 çështjeve u bë nga trupa gjyqësore e kësaj gjykate, prej 7 gjyqtarësh, kurse 750 çështje të tjera u shqyrtau nga gjyqtarët e deleguar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në dy raunde. Mosvazhdimi i delegimit të gjyqtarëve e bëri të pamundur evadimin e të gjitha çështjeve gjatë vitit 2014 nga Gjykata Administrative e Apelit, duke shkaktuar një volum pune të mbartur nga viti 2014 në vitin 2015, prej 7000 dosjesh.

Sa i takon vlerësimit tematik për afatet e dorëzimit të vendimeve, Gjykata Administrative e Apelit monitorohet për herë të parë. INFOÇIP analizoi për këtë qëllim 1952 vendime të dhëna nga kjo gjykatë në 6-mujorin e dytë të vitit 2014.


Neni 55 i ligjit 49/2012, përcakton se vendimi në Apelin Administrativ duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar dhe brenda 7 ditëve nga shpallja, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore. Ky është një afat ligjor eksplisit, nga i cili buron edhe legjitimiteti i monitorimit të ndërmarrë nga INFOÇIP për këtë gjykatë.

Nga vlerësimi rezolton se, brenda afatit ligjor prej 7 ditësh janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës rrreth 57% e totalit prej 3018 vendimesh (graf. 30) Pjesa tjetër prej 1310 vendime ose 43% e totalit në analizë dalin jashtë këtij afati ligjor

Kjo do të thotë që, për vitin 2014, dispozitat e nenit 42 të ligjit 49/2012 kanë gjetur zbatim vetëm në masën 57% në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

NR	KOHE-ZGJATJA	NR. I VENDIMEVE
1	Nga 0 deri 7 dite	894
4	Mbi 7 dite	1,058
	TOTAL	1,952

Graf.28




Për vitin 2014, dispozitat e nenit 55 të ligjit 49/2012 kanë gjetur zbatim vetëm në masën 46% në Gjykatën Administrative të Apelit.

Tabela më poshtë dhe graf. 31 ofron një paraqitje të afateve të dorëzimit të vendimeve sipas fashave kohore, ku më e larta është “mbi 100 dite”.

PERIUDHA KORRIK - DHJETOR 2014			
NR	EMERTIMI	NR I VENDIMEVE	SHPREHUR NE %
1	Nga 0 deri 7 dite	894	45.80
2	Nga 8 deri 10 dite	109	5.58
3	Nga 11 deri 20 dite	299	15.32
4	Nga 21 deri 30 dite	159	8.15
5	Nga 31 deri 40 dite	78	4.00
6	Nga 41 deri 50 dite	73	3.74
7	Nga 51 deri 100 dite	268	13.73
8	Mbi 100 dite	72	3.69
	TOTAL	1,952	100

Graf.29



Vonesat më ekstreme në dorëzimin e vendimeve

Gjykimi administrativ duhet të jetë i shpejtë. Ligji 49/2012 ka përcaktuar afatin 30 ditor për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Apelit Administrativ (neni 48). Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore. Afati 7-ditor i dorëzimit të vendimit është i njëjtë si për gjykimin në shkallë të parë (neni 42) ashtu edhe për shkallën e dytë (neni 55).

Siq u bë e qartë më parë, viti 2014 e ka përballur trupën gjyqësore të Apelit Administrativ me një ngarkesë të jashtëzakonshme. INFOÇIP priret të besojë se vonesat që konstatohen në dorëzimin tej afatit 7-ditor të 54% të vendimeve të totalit të vendimeve të analizuara për 2014-ën kanë përbazë shkaqe objektive. Vlet të theksohet se një pjesë e konsiderueshme vendimesh janë dorëzuar në afate tepër të ekstreme, që shkojnë deri edhe 193 ditë pas marrjes së vendimit. Tabela më poshtë paraqet të grupuaara të gjitha vendimet e dorëzuar me mbi 100 ditë vonesë në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit.

Nr vendimit	Data vendimit	Data dorezimit	Ditë nga shpallja deri në dorëzim	Menyra e zgjidhjes
2648	01.07.2014	23.10.2014	114	LENIE NE FUQI
2649	01.07.2014	18.11.2014	140	LENIE NE FUQI
2652	01.07.2014	10.11.2014	132	LENIE NE FUQI
2653	01.07.2014	18.11.2014	140	PRISHJE V
2660	02.07.2014	24.11.2014	145	LENIE NE FUQI
2661	02.07.2014	24.11.2014	145	LENIE NE FUQI
2725	02.07.2014	29.10.2014	119	NDRYSHIM V
2731	02.07.2014	24.11.2014	145	LENIE NE FUQI
2733	02.07.2014	12.12.2014	163	LENIE NE FUQI
2742	02.07.2014	24.11.2014	145	NDRYSHIM V
2747	02.07.2014	21.10.2014	111	NDRYSHIM V
2766	03.07.2014	03.11.2014	123	LENIE NE FUQI
2767	03.07.2014	03.11.2014	123	LENIE NE FUQI
2781	03.07.2014	19.11.2014	139	LENIE NE FUQI
2786	03.07.2014	18.11.2014	138	NDRYSHIM V
2820	04.07.2014	29.10.2014	117	LENIE NE FUQI
2822	04.07.2014	29.10.2014	117	NDRYSHIM V
2823	04.07.2014	29.10.2014	117	NDRYSHIM V
2824	04.07.2014	29.10.2014	117	LENIE NE FUQI
2825	04.07.2014	17.10.2014	105	PRISHJE V



Nr vendimit	Data vendimit	Data dorezimit	Dite nga shpalja ne dorezim	Menyra e zgjidhjes
2826	04.07.2014	21.10.2014	109	NDRYSHIM V
2827	04.07.2014	29.10.2014	117	LENIE NE FUQI
2830	04.07.2014	29.10.2014	117	LENIE NE FUQI
2831	04.07.2014	17.10.2014	105	NDRYSHIM V
2856	08.07.2014	29.10.2014	113	NDRYSHIM V
2864	08.07.2014	21.10.2014	105	LENIE NE FUQI
2865	08.07.2014	29.10.2014	114	NDRYSHIM V
2866	08.07.2014	29.10.2014	114	NDRYSHIM V
2868	08.07.2014	21.10.2014	106	LENIE NE FUQI
2915	10.07.2014	29.10.2014	111	NDRYSHIM V
2917	10.07.2014	29.10.2014	111	LENIE NE FUQI
2923	10.07.2014	29.10.2014	111	NDRYSHIM V
2928	10.07.2014	29.10.2014	111	LENIE NE FUQI
3002	11.07.2014	18.11.2014	130	LENIE NE FUQI
3004	11.07.2014	18.11.2014	130	LENIE NE FUQI
3007	11.07.2014	21.10.2014	102	LENIE NE FUQI
3059	15.07.2014	29.10.2014	106	LENIE NE FUQI
3060	15.07.2014	29.10.2014	106	LENIE NE FUQI
3061	15.07.2014	29.10.2014	106	PRISHJE V
3062	15.07.2014	29.10.2014	107	NDRYSHIM V
3063	15.07.2014	29.10.2014	107	NDRYSHIM V
3065	15.07.2014	29.10.2014	106	NDRYSHIM V
3066	15.07.2014	29.10.2014	106	LENIE NE FUQI
3133	17.07.2014	24.11.2014	130	LENIE NE FUQI
3134	17.07.2014	27.01.2015	193	LENIE NE FUQI
3135	17.07.2014	18.11.2014	124	LENIE NE FUQI
3137	17.07.2014	27.10.2014	102	LENIE NE FUQI
3139	17.07.2014	27.10.2014	102	LENIE NE FUQI
3172	18.07.2014	10.12.2014	145	LENIE NE FUQI
3173	18.07.2014	24.11.2014	129	LENIE NE FUQI
3174	18.07.2014	24.11.2014	129	PRISHJE V
3176	18.07.2014	24.11.2014	129	LENIE NE FUQI
3178	18.07.2014	05.12.2014	140	LENIE NE FUQI
3183	18.07.2014	24.11.2014	129	MOSPRANIM



GJETJET E MONITORIMIT, 2014

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS
SË PARË, RRETHI GJYQËSOR, TIRANË

Gjykatës Administrative, Shkalla e Parë, Tiranë nisi funzionimin e saj më datë 4 Nëntor 2013. Ajo ka kompetencë tokësore në rrithet: Bulqizë, Dibër, Krujë, Laç, Mat dhe Tiranë. Selia e saj është në Tiranë. Kjo është gjykata me ngarkesën më të madhe të çështjeve krahasuar me çdo gjykatë tjetër administrative të shkallës së parë (18417 çështe të regjistruara në 2014-ën). Trupa e saj gjyqësore përbëhet nga.....

Që në fillim trupa gjyqësore e kësaj gjykate u përball më një fluks të jashtëzakonshmë çështjesh gjyqësore të ardhura nga gjykatat e zakonshme të shkallës së parë, për shkak të shpalljes së mos-kompetencës në shqyrtimin gjyqësor. Fluksi më i madh përkon me muajt e parë të vitit 2014. Sikurse faktohet edhe nga të dhënat e analizuara për Gjykatën e Faktit Tiranë, vetëm në 4-mujorin e parë të vitit 2014, nga kjo e fundit u dërguan për mos-kompetencë gjykimi rreth 1880 çështje gjyqësore në Gjykatën Administrative të Rrethit Tiranë.

Neni 42 i ligjit 49/2012, përcakton se vendimi (në shkallë të parë) **duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar** dhe brenda 7 ditëve nga shpallja, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore. Ky është një afat ligjor eksplisit, nga i cili buron dhe legjimititeti i monitorimit të ndërmarrë nga INFOÇIP.

Në analizë për vitin 2014 u morën 3018 vendime të dhëna nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë. Vendimet e analizuara i përkasin 6-mujorit të dytë të vitit 2014. Siç është theksuar tashmë, analizimi i gjysmës së totalit të vendimeve gjyqësore të një viti, jep pothuajse të njëjtin rezultat sikur në analizë të ishin të gjitha vendimet e vitit të plotë kalendarik. Afatet e dorëzimit të vendimeve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë bëhen për herë të parë objekt monitorim. Ky vlerësim është i pari në absolut jo vetëm për këtë gjykatë, por për gjithë sistemin e gjykatave administrative të rretheve. INFOÇIP vendos kështu një gur themeli në vlerësimet tematike të drejtësisë administrative në Shqipëri.

Nga vlerësimi që u bë rezoltoj se, brenda afatit ligjor prej 7 ditësh janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës 57% e totalit prej 3018 vendimesh të analizuara (graf...) Pjesa tjeter prej 1310 vendime ose 43% e totalit në analizë janë doëzuar jashtë afatit ligjor. Kjo do të thotë që, për vitin 2014, dispozitat e nenit 42 të ligjit 49/2012 kanë gjetur zbatim vetëm në masën 57% në Gjykatën Administrative të Tiranës.


NR	EMERTIMI	NR I VENDIMEVE
1	Nga 0 deri 7 dite	1,708
4	Mbi 7 dite	1,310
	TOTAL	3,018



Për vitin 2014, dispozitat e nenit 42 të ligjit 49/2012 janë zbatuar vetëm në masën 57% në Gjykaën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë

Tabela më poshtë ofron një paraqitje të detajuar të afateve të dorëzimit të vendimeve sipas fashave kohore, ku me e larta është "mbi 100 ditë".

NR	EMERTIMI	NR I VENDIMEVE	SHPREHUR NE %
1	Nga 0 deri 7 dite	1,708	56.61
2	Nga 8 deri 10 dite	527	17.47
3	Nga 11 deri 20 dite	500	16.57
4	Nga 21 deri 30 dite	100	3.31
5	Nga 31 deri 40 dite	48	1.59
6	Nga 41 deri 50 dite	71	2.35
7	Nga 51 deri 100 dite	52	1.72
8	Mbi 100 dite	11	0.36
	TOTAL	3,018	100



Vonesat më ekstreme në dorëzimin e vendimeve

Ligji 49/2012 nuk ka parashikuar afate për gjykimin e mosmarrëveshjeve në gjykatat e shkallës së parë, në ndryshim nga nenii 327 i K.Pr.Civile, i shfuqizuar, që përcaktonte se shqyrtimi i mosmarrëveshjes duhet të përfundonte brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit në gjykatë.

Ligji cakton gjithsesi qartësisht afatin 7-ditor për dorëzimin e vendimit në sekretarinë e gjykatatës (neni 44). Nga vlerësimi që ndërmori INFOÇIP rezultoi se një grup vendimesh janë dorëzuar pas më shumë se 50 ditë nga shpallja e tyre. Kjo e kapërcen me mbi 7 herë afatin 7-ditor që ligji cakton për dorëzimin e vendimeve të arsyetuara në Sekretarinë e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, siç e faktion edhe tabela me poshtë. INFOÇIP konsideron se shkak për këto vonesa mund të jetë bërë ngarkesa e madhe e çështjeve, të cilat u dërguan këtu për mos-kompetencë gjykimi nga gjykatat e sistemit të zakonshëm.

NR VENDIMIT	DATA VENDIMIT	DATA DOREZIMIT	DITE NGA SHPALLJA NE DOREZIM
3974	10.07.2014	04.09.2014	56
3999	11.07.2014	04.09.2014	55
4009	11.07.2014	01.09.2014	52
4010	11.07.2014	04.09.2014	55
4027	11.07.2014	11.09.2014	62
4028	11.07.2014	12.09.2014	63
4029	11.07.2014	04.09.2014	55
4030	11.07.2014	16.09.2014	67
4031	11.07.2014	02.09.2014	53
4036	14.07.2014	03.10.2014	81
4047	14.07.2014	04.09.2014	52
4115	15.07.2014	13.10.2014	90
4117	15.07.2014		i
4145	15.07.2014	04.09.2014	51
4247	18.07.2014	13.10.2014	87
4262	18.07.2014	15.09.2014	59
4314	21.07.2014	12.09.2014	53
4393	23.07.2014	15.09.2014	54
4475	25.07.2014	15.09.2014	52
4498	29.07.2014	23.09.2014	56
4499	29.07.2014	23.09.2014	56
4527	31.07.2014	02.12.2014	125
4702	11.09.2014	05.11.2014	55
4703	11.09.2014		i



NR VENDIMIT	DATA VENDIMIT	DATA DOREZIMIT	DITE NGA SHPALLJA NE DOREZIM
4704	11.09.2014	22.12.2014	102
4733	12.09.2014	26.11.2014	65
4735	12.09.2014	13.11.2014	52
4774	15.09.2014		i
4775	15.09.2014	06.11.2014	52
4776	15.09.2014	05.11.2014	51
4778	15.09.2014	05.11.2014	51
4779	15.09.2014	18.12.2014	94
4807	16.09.2014	13.11.2014	58
4810	16.09.2014		i
4839	17.09.2014	23.12.2014	97
4995	22.09.2014	19.12.2014	88
5033	23.09.2014		i
5036	23.09.2014	27.11.2014	65
5058	24.09.2014	19.12.2014	86
5059	24.09.2014	19.12.2014	86
5087	24.09.2014	12.12.2014	79
5163	29.09.2014	24.12.2014	86
5201	29.09.2014	12.12.2014	74
5237	30.09.2014	19.12.2014	80
5255	30.09.2014	12.12.2014	73
5426	06.10.2014	05.12.2014	60
5431	06.10.2014	17.12.2014	72
5444	07.10.2014	16.12.2014	70
5449	07.10.2014	16.12.2014	70
5574	13.10.2014	22.12.2014	70
5659	14.10.2014	24.12.2014	71
5715	15.10.2014	22.12.2014	68
6020	27.10.2014	23.12.2014	57
6029	28.10.2014	22.12.2014	55
6070	29.10.2014	22.12.2014	54
6187	03.11.2014	09.01.2015	67
6191	03.11.2014	09.01.2015	67
6192	03.11.2014	09.01.2015	67
6313	06.11.2014	09.01.2015	64
6361	07.11.2014		i
6491	12.11.2014		i
6540	14.11.2014		i
6825	25.11.2014		i

SHKURT MBI METODOLOGJINE

Metodologjia e hartuar nga INFOÇIP konsiston në mbledhjen sistematike të të dhënave mbi datat e dorëzimit në sekretarinë gjyqësore të vendimeve përfundimtare (dosjes gjyqësore pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor) dhe më pas vlerësimin e vonesave eventuale duke kontrastuar datën e vendimit me datën e dorëzimit të tij. Një metode e tillë analizon të gjitha vendimet një për një të regjistruara në varg indeksues të rregullt në numratorët e çështjeve gjyqësore që administrohen nga sekretaritë e gjykatave. Pra, medoda nuk proceson një numër të reduktuar çështjes (30-40) të zgjedhura me kampionim, por të gjitha vendimet gjyqësore të dorëzuar në një kohë të dhënë.

Intervali minimal kohor mbi të cilën zbatohet analiza është 4 muaj (për gjykatat e faktit), kurse më i larti është një vit i plotë kalendarik (vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të GJL). Parimi metodologjik është “Sa më i madhe që është numri i vendimeve që nxjerr një gjykatë në një njësi të dhënë kohë, aq më e vogël është si rregull fasha kohore që përzgjidhet pér analizim”.

Për gjykatat e Apelit, fasha që analizohet është si rregull 6 muaj. Në faqen 42 të këtij botimi jepet ilustrohet me një shembull konkret se si matjet e aplikuara mbi një periudhë 12 mujore janë në fakt të njëta me ato të realizuar mbi një periudhë 6-mujore. Kjo çon në pohimin se vlerësimi 6-mujor është në fakt një vlerësim përgjithësues pér të gjithë vitin kalendarik, në rastin e Gjykatës së Apelit, Tiranë.

Po ashtu, 6 muaj ështe intervali i analizuar pér gjykatat administrative të Faktit dhe të Apelit pér vitin 2014, meqënëse ky vlerësim aplikohet pér herë të parë ndaj tyre dhe caktimi i një “strong baseline” u konsiderua i domosdoshëm nga grupei monitorues i INFOÇIP.

Për të realizuar këtë vlerësim, që në vitin 2013 u bë identifikimi i saktë i dispozitave në korpusin e brendshëm ligjor (kode dhe ligje) të cilat përcaktojnë afatet e arsyetimit/ dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Veçimi i tyre dhe vlerësimi apo adresimi korrekt i mangësive të hasura ishte një objektiv parësor i botimit të parë. Në këtë botim të dytë, compendium-i ligjor nuk është përfshirë pér efekt hapësire fizike; nenet që caktojnë legjitimitetin e çdo matjeje referohen në secilin rast.

Treguesi DAV (*Dorëzimi në Afat i Vendimeve*) është një indikator i posaçëm i konceptuar nga INFOÇIP posaçërisht pér këtë lloj vlerësimi tematik. DAV pasqyrohet në pikë përqindje. Ai është rezultat i diferençës midis viti aktual dhe viti paraardhës pér vlerat që kanë të bëjnë më dorëzimin brenda afatit ligjor të vendimit të arsyetuar në Sekretari. DAV përdoret pér të matur progresin vit pas viti, në kushtet kur krijohet një bazë fillestare me të dhëna të krahasueshme (*baseline*). Në këtë rast ai indeksohet si “DAV vertikal”, pér ta dalluar atë nga “DAV horizontal”, i cili aplikohet pér të indikuar diferençat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshe brenda të njëjtës viti, (siç në rastin e krahasimit të Gjykatës së Faktit Tiranë me Gj.F. Durrës pë vitin 2014). DAV është një indikator absolut. Ai nuk relativizion apo ponderon rezultatin bazuar në ngarkesën e gjyqtarëve, vështirësinë e çështjeve, apo shkaqe të tjera subjektive.

KAPITULLI IV

COMPENDIUM

VENDIME TE
KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

DY FJALË PËR KAPITULLIN “COMPENDIUM”

Pas shpalljes nga INFOÇIP në 12 Prill 2014 të rezultateve të vlerësimit të parë tematik mbi vonesat në dorëzimin e vendimeve gjyqësore, Ministria e Drejtësisë u vu seriozisht në lëvizje për të adresuar përmes mekanizmave të saj fenomenin tashmë të ekspozuar, madje në gjykatat më të rëndësishme të vendit.

Interesimi i posaçëm që ministri i drejtësisë, Nasip Naço dhe nënkyetari i KLD Elvis Cefa treguan ndaj gjetjeve të vlerësimit tematik të ndërmarrë nga INFOÇIP u demonstrua edhe në daljet publike të tyre në media, ku problematika e konstatuar dhe a artikuluar nga përfaqësuesit e INFOÇIP u pranua plotësisht dhe publikisht (media kombëtare i dha një rëndësi shumë të madhe gjetjeve të këtij monitorimi).

Gjatë vitit 2014, përmes inspektorëve të saj, MD ndërmori një seri verifikimesh ndaj gjyqtarëve për të cilët ishin raportuar/konstatuar shkelje procedurale, me theks të posaçëm vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

Në rastet e konstatimit të këtyre shkeljeve, ministri i drejtësisë, konform dispozitave ligjore në fuqi, paraqiti përvendimarrje në KLD një numër relativisht të lartë kërkesash për procedime disiplinore. Gjatë vitit 2014, KLD dha disa vendime të rëndësishme që adresonin këtë problematikë. Masat e marra ishin në shumicë **pro’** procedimit disiplinor të gjyqtarëve të cilët rezultonin me vonesa të shprehura dhe të përsëritura në dorëzimin e vendimeve.

Në këtë kapitull të posaçëm përbledhen disa prej këtyre vendimeve të KLD gjatë vitit 2014 si dhe një vendim i vitit 2015. Ato janë një reflektim serioz mbi shqetësimet e ngritura nga INFOÇIP dhe padashim edhe një tregues i drejpërdrejtë i suksesit të kësaj iniciative që në vitin e parë të saj. Vendimet e KLD të përbledhura në këtë kapitull janë një tregues edhe se kultura e pandëshkueshmërisë brenda rradhëve të gjyqësorit mund të sfidohet realisht, nesë ka vullnet dhe bashkërendim të përpjekjeve mes aktorëve institucionalë, politikë dhe atyre të shoqërisë civile.

Ky kapitull është i tipit **Compendium** dhe shërben për të vënë në dispozicion te të gjithë të interesuarve, atë që mund të konsiderohet tashmë si një praktikë vendimarrëse edhe e MD dhe KLD mbi cështjet që ka ekpozuar që nga vitit 2013 INFOÇIP në vlerësimet që ka kryer.

Compendium është termi që përdoret në rastet kur materiali që përzgjidhet për botim i nënshtrohet një procesi të kujdeshshëm “filtrimi”, i cili ka për qëllim të “veçojë” vetëm pjesët relevante. **“Compendium”**, nga latinishtja do të perkthehet: **“ajo e cila peshohet së bashku”**.



Vendim Nr. 44, datë 15.04.2014**PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE “DËRGIMIN PËR 2 VJET NË NJË GJYKATË TË TË NJËJTIT NIVEL JASHTË RRETHIT GJYQËSOR KU GJYQTARI KA EMËRIMIN E TIJ” GJYQTARES E.GJ**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë i mbledhur më datë 15.04.2014, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, të shprehur në seancën plenare i cili mbështetur dhe në vendimin nr.29, datë 24.02.2014 “Për shqyrtimin e kërkesës për procedim disiplinor ndaj gjyqtares E.Gj”, kërkoi një masë tjetër disiplinore më të lehtë, krahasuar me masën disiplinore “Shkarkim nga detyra”, ndaj gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, E.Gj, atë të “Dërgimit për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij” si dhe duke mbajtur parasysh dokumentacionin përkatës që shoqëron këtë procedim (pjesë e këtij vendimi është dhe vendimi nr. nr.29 datë 24.02.2014 “Për shqyrtimin e kërkesës për procedim disiplinor ndaj gjyqtares E.Gj”),

VËREN SE :

1. Me shkresën nr.302 prot., datë 15.01.2014, Ministri i Drejtësisë, ka depozituar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, E.Gj. Për fillimin e këtij procedimi është marrë shkas nga shkeljet që Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka konstatuar në veprimtarinë gjyqësore të saj, pas verifikimit të katër ankesave si dhe pas një inspektimi të kryer nga Ministria e Drejtësisë.

2. Ministri i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 31, pika 3 të Ligjit Nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, në materialet e procedimit për këtë gjyqtare, i propozoi Këshillit të Lartë të Drejtësisë marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”. Në kërkesën për procedim, bazuar në Ligjin Nr.9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nen 32, argumentohej se kjo gjyqtare ka kryer shkelje shumë të rënda të disiplinës në punë, të parashikuara në pikën 2, të kësaj dispozite.

3. Konform Rregullores “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve”, nenit 6, të cilës parashikohet se: “Gjyqtari ndaj të cilët zhvillohet procedimi disiplinor duhet të njoftohet për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën dyzetetë

orë përparrë fillimit të saj”, Zj. E.Gj është njoftuar për zhvillimin e mbledhjes të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, brenda këtij afati, konkretisht, me shkresën Nr.156/3 Prot, datë 18.02.2014. Gjithashtu, në nenin 5 të Rregullores, parashikohet se: “Mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në të cilën do të shqyrtohet procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari duhet të caktohet jo më shpejt se dhjetë ditë nga data që gjyqtarit i janë vënë në dispozicion materialet e plota të procedimit”. Gjyqtarja e proceduar E.Gj ishte njohur për kërkesën e Ministrit të Drejtësisë dhe materialet shoqëruesse duke i garantuar të drejtat procedurale të parashikuara nga ligji dhe nga rregullorja.

4. Në mbledhjen e datës 24.02.2014, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dëgjoi parashtrimet e Ministrit të Drejtësisë, të gjyqtares së proceduar disiplinarisht si dhe avokatin e saj. Në parashtrimet e tij Ministri i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 31, pika 3, të Ligjit Nr.8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, procedimin disiplinor dhe marrje mase disiplinore atë të “Shkarkimit nga detyra” ndaj gjyqtares E.Gj. Në kërkesën për procedim, të bazuar në Ligjin Nr.9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nen 32, argumentohet se kjo gjyqtare ka kryer shkelje shumë të rëndë të disiplinës në punë, të parashikuara në pikën 2, të kësaj dispozite, si më poshtë:

a) Relacioni i parë është inspektim i Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë bazuar në urdhërin e inspektimit nr.115, datë 27.03.2013 “Për ushtrimin e inspektimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor xxx”. Objekti i inspektimit ka qënë verifikimin i zbatimit të dispozitave procedurale civile dhe administrative, lidhur me dorëzimin e vendimeve gjyqësore të arsyetuara, në kryesekretarinë e gjykatës”. Inspektimi është kryer në datat 28.03.2013 dhe 29.03.2013. Nga ky inspektim është konkluduar se:

i) Gjyqtarja E.Gj, ka dorëzuar me vonesë 39 dosje civile, duke shkelur nenin 308, paragrafi i dytë të K.Pr.Civile për depozitimin e vendimit të arsyetur në sekretarinë gjyqësore brenda afatit 10 ditor. Mosdorëzimi i vendimeve gjyqësore brenda këtij afati është bërë në mënyrë të përsëritur dhe të pajustifikuar. Për periudhën e inspektimit ka përfunduar në total 208 çështje civile për vitin 2012, 84 çështje dhe 124 çështje për vitin 2013.

- Për vitin 2012, 21 çështje civile ku për 12 çështje është disponuar me vendim përfundimtar dhe 9 çështje është disponuar me vendim pushimi. Afati minimal i dorëzimit të vendimit të tyre në Kryesekretari, fillon nga 3 ditë deri në 2 muaj e 25 ditë).

-Përvitin 2013, 18 çështje civile, kupër 8 çështje është disponuar me vendim përfundimtar.



fundimtar dhe për 9 çështje është disponuar me vendim pushim dhe kthim aktesh. Afati minimal i mosdorëzimit të vendimit të tyre në Kryesekretari, fillon nga 3 ditë deri në 1 muaj e 17 ditë.

b) Në çështjen civile, që i përket ankueses M.P, gjyqtarja E.Gj ka zvarritur procesin gjyqësor për një periudhë prej dy vjet e njëzet ditë me pasoja për të drejtën kushtetuese të palëve në atë proces civil, për realizimin e gjykimit brenë një afati të arsyeshëm kohor.

c) Në çështjen civile me palë ndërgjyqëse: Paditës: T.P (H) i paditur: M.H etj, objekti: Kërkim pasurie trashëgimore, është i pajustifikuar fakti se gjyqtarja E.Gj a ka mbajtur për gjykim për tre vjet rreshth këtë çështje, duke mos realizuar asnë seancë.

d) Në çështjen civile, që i përket ankuesit S.T, gjyqtarja E.Gj ka zvarritur procesin gjyqësor për një periudhë prej rreth 1 vit e 9 muaj me pasoja për të drejtën kushtetuese të palëve në atë proces civil, për realizimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor.

e) Në çështjen civile, që i përket ankueses E.M, gjyqtarja E.Gj ka zvarritur procesin gjyqësor për një periudhë prej 1 vit, 4 muaj e 23 ditë me pasoja për të drejtën kushtetuese të palëve në atë proces civil, për realizimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor si dhe ka shkelur nenin 308, paragrafi i dytë të K.Pr.Civile për depozitimin e vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit 10 ditor.

5. Këshilli konstatoi se gjatë veprimtarisë gjyqësore në mënyrë të përsëritur, gjyqtare E.Gj, ka shkelur disa dispozita të detyrueshme për zbatim të legisionit procedural në fuqi në Republikën e Shqipërisë:

- Kodin e Procedurës Civile, nenin 1, ku parashikon se rregullat e tij janë të detyrueshme për t'u zbatuar. Neni 4 i këtij kodi, i vë detyrë gjyqtarit të realizojë një proces të rregullt ligjor, duke marrë masat e nevojshme për zhvillimin e tij, deri në finalizimin, me arsyetimin e vendimit dhe dorëzimin e tij sipas afateve ligjore, "Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme".
- Me veprimet e saj, gjyqtare E.Gj, ka shkelur edhe parashikimit e bëra në nenin 308 të K.Pr.Civile. Kjo dispozitë urdhëron gjyqtarin e çështjes që të depozitojë vendimin e arsyetuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit dhjetë ditor nga shpaljja e vendimit përfundimtar për konfliktin civil të zgjidhur prej tij. Mosdorëzimi i vendimeve gjyqësore brenda këtij afati është bërë në mënyrë të pajustifikuar.
- Lidhur me vendimet e pushimit të shpallura nga Gjykata dhe të dorëzuara më vonesë, rezulton se afati i dorëzimit të tyre është në shkelje edhe të nenit 301 të K.Pr.C. sipas të cilit: "Kundër vendimit me të cilin vendoset pezullimi,

pushimi ose refuzimi i rifillimit të gjykimit, mund t'ë bëhet ankim i veçantë në gjykatën e Apelit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj". Neni 443/4 i K. Pr. Civile parashikon se : "... Afati i ankimeve te vecanta eshte 5 dite".

6. Pasi dëgjoi, parashtrimet e Ministrat të Drejtësisë, gjyqtaren e proceduar disiplinarisht si dhe avokatin e saj, në përfundim, me Vendimin Nr.29, datë 24.02.2014, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendosi të rrëzojë kërkesën e Ministrat të Drejtësisë për masën disiplinore "Shkarkim nga detyra" ndaj gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, E.Gj si dhe t'i akordojë një afat Ministrat të Drejtësisë, që në mbledhjen e ardhshme të propozojë një masë tjetër disiplinore ndaj gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, E.Gj (Shih Vendimin Nr.29, datë 24.02.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili është pjesë përbërëse e këtij procedimi disiplinor).

7. Ministri i Drejtësisë, në vijim të mbledhjes së mëparshme, datë 15.04.2014, mbështetur vendimin nr.29, datë 24.02.2014 "Për shqyrtimin e kërkesës për procedim disiplinor ndaj gjyqtares E.Gj", kërkoi një masë tjetër disiplinore më të lehtë, ndaj gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, E.Gj, referuar ne-nit 33/ç të Ligjit Nr.9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", "ç) dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtë nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij" dhe konkretisht "Dërgimin për 2 vjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor xxx" për të ushtruar detyrën e gjyqtarit.

8. Këshilli i Lartë i Drejtësisë nga faktet e parashtruara konstaton se lidhur me çështjet e gjykuara dhe të padorëzuara apo dorëzuara me vonesë nga gjyqtare E.Gj, përbën shkelje të rëndë të ligjit me pasojë cënimin e lirive dhe të drejtave themore të njeriut. Në këtë kontekst, neni 15, pika 2 e Kushtetutës parashikon "Organet e pushtetit publik, në përm bushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre". Ky parashikim kushtetues shihet i lidhur me detyrime të tjera që, akti themelor i shtetit i ngarkon në mënyrë të posaçme pushtetit gjyqësor. Konkretisht, neni 43 i Kushtetutës, i njeh kujdo të drejtën për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor, në një gjykatë më të lartë, të drejta këto të parealizuara për palët pjesëmarrëse në proceset e cituara më lart, të gjykuara prej tij.

9. Shkaku kryesor për masën disiplinore është mosrespektimi i dispozitive procedurale në gjykimin e çështjeve dhe konkretisht "moskryerja në kohë dhe në mënyrë të përsëritur të detyrës nga ana e gjyqtarit, lidhur me arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përfundimtare", të cilat janë kryer në mënyrë të përsëritur dhe të pajustifikuar duke sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim si dhe për dhëni e drejtësisë. Sa më sipër këto shkelje disiplinore

janë konsideruar nga ligjvënësi si akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtares, në kuptim të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008.

10. Shkeljet e konstatuara rezultojnë dhe dalin qartë në të gjitha aktet shkresore të marra në shqyrtim në vendimmarrjen e Këshillit, siç janë relationet e inspektorëve të IKLD dhe shkresat përkatëse, relacioni i Inspektoratit pranë Ministrisë së Drejtësisë, procesverbalet e verifikimeve të kryera nga të dy inspektoratet apo dhe vetë kërkesa e Ministrit drejtuar KLD.

11. Shkeljet e konstatuara në vonesat në dorëzimin e vendimeve dhe për rrjedhojë dhe të dosjeve gjyqësore kanë sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim si dhe për dhënien e drejtësisë. Këto shkelje kanë diskredituar rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit.

12. KLD vlerëson se respektimi i dispozitave procedurale të cilat lidhen me dorëzimin e vendimeve brenda një afati te arsyeshëm, në mënyrë që të mos cënohen të drejtat kushtetuese të palëve në proces dhe të mos pengohet dhënia e drejtësisë, është e lidhur drejtpërsëdrejti me respektimin e parimit të zhvilimit dhe përfundimit të një procesi brenda një afati të arsyeshëm. Me afat të arsyeshëm ligjor kuptohet jo vetëm koha që merr shqyrtimi i çështjes deri në shpalljen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës, por edhe koha që i nevojitet gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar. Gjithashtu, Këshilli është i vetëdijshme se respektimi i afatit të arsyeshëm ligjor varet nga shumë faktorë të procesit të gjykimit të cilët janë të lidhur dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e këtij procesi, siç mund të jenë: sjelljet e palëve në proces, kompleksiteti i çështjes, përkushtimi dhe aftësia e gjykatës dhe administratës gjyqësore për përfundimin në kohë të procesit dhe ushtrimin e detyrës në përputhje me ligjin, etj.

13. Këshilli thekson se afatet brenda të cilit duhet të dorëzohen vendimet e arsyetuara janë përcaktuar në dispozitat procedurale si nen 308 i K.Pr.Civile, dhe se nuk është konstatuar se nga gjyqtaria është marrë ndonjë masë që ato të dorëzohen brenda një afati të arsyeshëm në mënyrë që në çdo rast, dorëzimi i vendimeve të mos marrë më shumë kohë se sa ka marrë vetë procesi gjyqësor, apo ato të mbahen pafundësisht të bllokuara dhe të padorëzuara. Eficencia në drejtësi është një kriter i rëndësishëm për zhvillimin dhe konsolidimin e një procesi të rregullt ligjor si dhe për rivendosjen e të drejtave të palëve të pretenduara të shkelura. Prandaj këto vonesa ndikojnë dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë tek palët në proces pasi u cënohen këtyre të fundit të drejtat e tyre kushtetuese dhe përfundimisht procesi gjyqësor degradon në një proces joefektiv.

14. Në sjelljen e gjyqtares E.Gj, KLD konstaton një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tillë që kalojnë "kufirin e të arsyeshmes", dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, sjellje e cila çon në cënimin e prestigjit

të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.

15. Nisur nga analiza e mësipërme, vlerësohet se vonesat e gjyqtares në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore konsiderohen si shkelje disiplinore në kuptim te nenit 32 të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 dhe e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore pasi:

- i) këto vonesa janë të vazhdueshme, të përsëritura dhe të pajustifikuara;
- ii) këto vonesa kanë sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë;
- iii) këto vonesa janë jashtë afatit të arsyeshëm;
- iv) këto vonesa kanë cenuar imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut të drejtësia

16. Këshilli i Lartë i Drejtësisë konkludon se:

i) Shkeljet e konstatuara në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtares E.Gj vlerësohen se kanë ka shkaktuar shqetësim në një masë të madhe të njerëzve të interesuar, duke dëmtuar besimin e publikut tek dhënia e administrimi i drejtësisë, duke ulur imazhin e sisteminit gjyqësor, duke prekur interesat e palëve.
ii) Sjellja e gjyqtares ka diskredituar pozitën dhe figurën e saj, duke dëmtuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

17. Këshilli konsideron si rrethanë lehtësuese faktin e parashtruar edhe nga vetë gjyqtarja dhe avokati i saj, se në periudhën që i përket shkeljeve të konstatuara nga Inspektorati, zj. E.Gj në ushtrim të veprimtarisë së saj si gjyqtare ka pasur një ngarkesë relativisht të madhe me cështje për gjykim. Kjo ka të bëjë me faktin se gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx, është gjykata me numrin më të madh të cështjeve për gjykim.

18. Këto veprime, përbëjnë shkelje disiplinore dhe parashikohen si shkelje të disiplinës, nga neni 32 i Ligjit Nr.9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Në faktet që i atribuohen gjyqtares E.Gj plotësohen kushtet e këtij parashikimi ligjor:

- i. shkelja e pajustifikuar të dispozitave urdhëruese procedurale;
- ii. shkelja e përsëritur të dispozitave urdhëruese procedurale dhe
- iii. ardhja ose mundësia e ardhjes së pasojave për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 147 pika 6 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 33/2/ç të Ligjit Nr.9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në

Republikën e Shqipërisë", si dhe në Vendimin nr.137, datë 21.02.2003 Rregullore "Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve" i ndryshuar, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke qënë i mendimit se, propozimi i Ministrit të Drejtësisë për masën disiplinore "Dërgimin për 2 vjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë" për të ushtruar detyrën e gjyqtares është i drejtë,

V E N D O S I

1. Pranimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor xxx, E.Gj duke i dhënë masën disiplinore "Dërgimin për 2 vjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë" për të ushtruar detyrën e gjyqtares.
2. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet rregullisht gjyqtarit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brënda 15 ditëve nga njoftimi i tij

U shpall sot, më datë 15.04.2014.

ZËVENDËSKRYETARI

ELVIS ÇEFA



Vendim Nr. 45, datë 15.04.2014

**PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE “SHKARKIM NGA
DETÝRA” NDAJ GJYQTARIT A.Ç**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë i mbledhur më datë 15.04.2014, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, nr.3993/2, datë 09.01.2014 me dokumentacionin përkatës në procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, A.Ç, dhe marrjen ndaj tij të masës disiplinore “shkarkim nga detyra”,

VËREN SE:

1. Me shkresën nr.3993/2 prot., datë 09.01.2014, Ministri i Drejtësisë, ka depozituar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, A.Ç. Për fillimin e këtij procedimi është marrë shkas nga shkeljet që Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka konstatuar në veprimtarinë e tij gjyqësore, pasqyruar në shkresat drejtar Ministrisë së Drejtësisë dhe konkretisht: shkresa nr.845 prot., datë 20.03.2013(shkelje të pajustifikuar dhe përsëritur të dispozitave urdhëruese procedural); tek shkresa nr.2342 prot., datë 13.08.2013 (me ankues S.J. për zvarritje të veprimeve procedural) dhe tek shkresa nr.2427/2 prot., datë 22.10.2013 (me ankues M.M. dhe E.Z. shkelje të pajustifikuara të dispozitave urdhëruese procedurale që kanë sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në proces).

2. Ministri i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 31, pika 3 të Ligjit Nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit A.Ç. Në kërkesën për procedim, bazuar në Ligjin Nr.9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 32, argumentohet se ky gjyqtar ka kryer shkelje shumë të rënda të parashikuara në pikën 2, të kësaj dispozite.

3. Nga vlerësimi që i është bërë kërkesës së Ministrit të Drejtësisë, dokumentacionit shkresor të administruar, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, këshilli vlerëson se:

i) shqyrtimi i kërkesës së paraqitur në këtë procedurë, nga pikëpamja formale dhe ajo proceduriale është në kompetencën ligjore të KLD-së, në bazë të pikës “ç” të nenit 2 dhe neneve 31 e vijues të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

ii) në referim të akteve shkresore, Ministri i Drejtësisë legitimohet si



nga pikëpamja procedurale, ashtu edhe nga pikëpamja materiale, bazuar në pikën 3 dhe 4 të nenit 31 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, si dhe në nenin 34 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. iii) kërkesa e depozituar në KLD nga Ministri i Drejtësisë, është brënda afatit të parashikuar në nenin 34 të ligjit nr.9877 datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Konkretnisht nga data e kryerjes së shkeljes kanë kaluar më pak se 5 vjet dhe nga data e vënieve në dijeni me shkeljen të Ministrat të Drejtësisë, në cilësinë e organit që ka të drejtën e nisjes së procedimit disiplinor, ka kaluar më pak se 1(një) vit. iv) shyrtimi i kërkesës ka qënë pjesë e rendit të ditës në mbledhjen e Këshillit, datë 24.02.2014 në të cilën gjyqtari nuk është paraqitur por është përfaqësuar nga avokati Mark Marku (nëpërmjet prokurës nr.217 rep, nr.251 kol, dt 23.01.2014 të noteres I.H). Pas kërkesës së këtij avokati për të patur kohën e domosdoshme për t'u përgatitur dhe për të shtyrë shqyrtimin e kësaj çëshjeje, në përfundim, me Vendimin Nr.28, datë 24.02.2014, KLD vendosi të shtyjë shqyrtimin e procedimit disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, A.Ç deri në mbledhjen e ardhëshme.(Shih Vendimin Nr.28, datë 24.02.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pjesë përbërëse e këtij procedimi disiplinor).

4. Shqyrtimi i kërkesës për procedim ka qënë pjesë e rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit datë 15 prill 2014. Gjyqtari është vënë në dijeni më datë 11.04.2014 (për seancën e mbledhjes së KLD).

5. Konform Rregullores “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve” e ndryshuar, në nenin 6 në të cilin parashikohet se “Gjyqtari ndaj të cilit zhvillohet procedimi disiplinor duhet të njoftohet për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën 48 orë para fillimit të saj”, është njofuar gjyqtari A.Ç për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, brenda këtij afati, njoftime të cilat u cituan më sipër, specifikoohen sërisht më poshtë:

i) shkresën nr. 92/3, datë 18.02.2014 (për seancën e mbledhjes së KLD, datë 24.02.2014);

ii) shkresën nr.1205 prot., datë 07.04.2014 (për seancën e mbledhjes së KLD datë 11.04.2014, në të cilën vazhdimi i shqyrtimit të kësaj çëshjeje nuk u zhvillua) dhe,

iii) shkresën datë 11.04.2014 (për seancën e mbledhjes së KLD, datë 15.04.2014).

6. Gjithashtu, KLD konstaton se mbështetur në nenin 5 të Rregullores “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve” e ndryshuar, ku parashikohet se: “Mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në të cilën do të shqyrtohet procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari duhet të caktohet jo më shpejt se dhjetë ditë nga data që gjyqtarit i janë vënë në dispozicion materialet e plota të procedimit”, gjyqtari i proceduar A.Ç është njojur për kërkesën e Ministrat të Drejtësisë dhe dokumentacionin përkatës

(shoqërues) nëpërmjet shkresës nr.92/1, datë 14.01.2014, duke i vënë në dispozicion:

- i) Kërkesën e Ministri i Drejtësisë për procedimin disiplinor me Nr.3993/2 prot., datë 09.01.2014,
- ii) Praktikën e materialeve të procedimit (dokumentacionin shoqërues të kërkesës së sipërcituar).

7. Nga sa u parashtrua, rezulton se gjyqtarit A.Ç i janë garantuar të drejtat procedurale të parashikuara nga ligji dhe rregullorja, duke u zhvilluar në këtë mënyrë një proces i rregullt ligjor, në pikëpamjen procedurale.

I. Fakte dhe Rrethana.

8. Në mbledhjen e datës 24.02.2014, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dëgjoi para-shtrimet e Ministrit të Drejtësisë që relatoi kërkesat/relacionet e dërguara nga Inspektorati i Këshillit në drejtim të tij për iniciimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit A.Ç. Relacioni i parë i është dërguar Ministrit të Drejtësisë me shkresën nr. 845, datë 20.03.2013. Nga verifikimi që ka bërë Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka rezultuar se gjyqtari A.Ç, ka gjykuar 34 çështje me problematikë në afatin e dorëzimit të vendimeve të arsyetuara dhe konkretisht:

a) Ka shpallur dhe ka depozituar me vonesë në sekretarinë gjyqësore 25 dosje, të cilat duke parë nga objekti i kërkesëpadisë del se:

i) 10 çështje janë me objekt: "Lëshim urdhër ekzekutimi". Afati minimal i dorëzimit të vendimit të tyre në Kryesekretari, fillon nga 10 ditë deri në 3 muaj e 22 ditë.

ii) 15 çështje janë me objekt: "Lëshim dëshmie trashëgimnie" ose "Vërtetim fakti juridik të vjetërsisë në punë" dhe 1 (një) kërkesë administrative penale. Afati minimal i dorëzimit të vendimit të tyre në Kryesekretari, fillon pas 15 ditësh nga shpal-lja e vendimit deri në 3 muaj e 22 ditë.

b) Ka shpallur dhe nuk ka depozituar në sekretarinë gjyqësore deri në ditën e verifikimit datë 31.10.2012, 9 dosje civile të cilat kanë si objekti: "Përbushje dety-rimi kontraktual" dhe një prej tyre me objekt: "kompesim për burgim të pa drejtë". Koha e mosdorëzimit të vendimeve ishte 1 muaj e 18 ditë deri në 1 muaj e 19 ditë, e llogaritur nga data e shpalljes së vendimit.

9. Në përfundim, nga ana e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për relacionin e parë, është arritur në konkluzionin se në veprimtarinë e gjyqtarit A.Ç, provohet të ketë shkelje të ligjit që përbëjnë shkelje të disiplinës në kuptim të nenit 32 të ligjit 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në bazë të nenit 35 të ligjit 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të nenit 31 të ligjit 8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Larë të Drejtësisë", i ndryshuar, gjyqtari A.Ç është njoftuar për shkeljet

e konstatuara në relacionet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke i vënë në dukje edhe të drejtën e paraqitjes së pretendimeve dhe provave mbi të, i cili ka paraqitur edhe observacionet përkatëse, të cilat janë pjesë e dosjes.

10. Relacioni i dytë i IKLD ka të bëjë me ankesën e shtetasit Selami Jenisheri, dërguar me shkresën nr.2342 prot., date 13.08.2013, pranë Ministrisë së Drejtësisë, ankesë e cila ka të veprimtarinë e gjyqtarit A.Ç, në gjykimin e çështjes civile me objekt “Marrje mase sigurim padie” me të paditurit V.P. Nga të dhënët e verifikuara në lidhje me këtë çështje, rezulton se nga ana e gjyqtarit A.Ç nuk ishte kryer asnjë veprim procedural për kalimin e çështjes në seancë, në shkelje të dispozitive urdhëruese procedurale të nenit 202 të K.Pr.Civile, i cili parashikon se, me kërkesën e paditësit, gjykata brënda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsyë të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

11. Nga vleresimi i këtij fakti, në relacionin e dytë, qmohet se gjyqtari A.Ç duhet t'i nënshtronhet përgjegjësisë disiplinore në përputhje me nenet 31 e vijues të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskretojnë pozitën dhe figurën e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 32 të këtij ligji.

12. Relacioni i Tretë - KLD ka dërguar në drejtim të Ministrit të Drejtësisë shkresën nr.2427/2 prot., datë 22.10.2013 për procedim disiplinor ndaj gjyqtarit A.Ç pas verifikimit të ankesës së shtetasit M. M., për “dhënie vendimi të kundraligjshëm” (në kundërshtim me nenin 3 të Aktit Normativ nr.3 datë 01.08.2012 “Per lirimin e banesave pronareve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara”. Kësaj ankesë i shtë bashkëngjitur edhe ankesa nr.2192, datë 23.07.2013 e shtetasës E. Z, ku pretendohet përsëri e njëjta shkelje, ndaj gjyqtarit A.Ç.

a) Ankimi i shtetasit M.M ka të bëjë lidhur me zgjidhjen e çështjes me kërkues: P.S, B.TdheGj.Kdhepersonitretë: Enti Kombëtar i Banesave, me objekt: Vendosja emasës së sigurimit së njëprone me adresë: Rr.: “Lin Delija”, Shkodër, dhe pezullimin e veprimeve përmbarimore me nr.regj.119, datë 30.08.2013 të përmbaruesit gjyqësor G.B. i) Kërkesa është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor XXX më datë 02.09.2013 dhe me shortin e po kësaj date, çështja i ka kaluar për gjykim gjyqtarit A.Ç. Seanca është zhvilluar me datë 04.09.2013, në prani të kërkuesit dhe në rëmungesë të personit të tretë Enti Kombëtar të Banesave, i cili nuk rezulton të jetë njoftuar për shkak se sipas gjyqtarit, çështja ka karakter të ngutshëm. Në përfundim të kësaj seance, gjyqtari A.Ç, me vendimin nr. 47/51-5013-3451, datë 04.09.2013, ka vendosur:

1. Pranimin e kërkuesës së kërkuesve P.S, B.T dhe Gj.K.
2. Vendosjen e mosës së sigurisë



3. Pezullimin e veprimeve përbartimore me nr. regjistri 119, datë 30.08.2013 të përbartuesit gjyqësor, derisa vendimi mbi shqyrtimin e kërkesë padisë të marrë formë të prerë.

ii) Kundër këtij vendimi, është ushtruar ankim nga personi i tretë Enti Kombëtar i Banesave dhe nga shtetasit M.M dhe përbartuesi gjyqësor G.B. Në Gjykatën e Apelit xxx, rezulton se kjo gjykatë me vendimin nr.86, date 17.10.2013, ka vodosur: "Ndryshimin e vendimit nr.47, datë 04.09.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx dhe rrëzimin e kërkesës"

iii) Ndërkohë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor xxx rezulton se, pranë kësaj gjykate është regjistruar padia e themelit përpëra kërkesës së mësipërme për sigurimin e padisë, konkretisht çështja ll.31 003-02619-51-2013, datë 23.08.2013, që i përket paditsave B.T, Gj.K, P.S, të paditur: M.M, AKKP Tiranë, përbartues G.B dhe personi i tretë ZVRPP Shkodër, Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Shkodër, me objekt: Kundërshtim akti administrativ. Pavlefshmiëria absolute e tij. Kundërshtim i veprimeve përbartimore. Sigurim padie". Kjo çështje është në proçes gjykimi

b) Ankesa e shtetasës E.Z, i përket çështjes civile, me palë kërkues: T.X, me objekt: Sigurim padie, duke marrë masë provizore pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv nr.19/1, datë 23.03.2013.

i) Kërkesa është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor xxx me datë 02.07.2013 dhe po në këtë datë, çështja i ka kaluar per shqyrtim gjyqtarit xxx, Seanca gjyqësore është zhvilluar më datë 05.07.2013, në prani të palës kërkuese. Në përfundim të kësaj seance, gjyqtari A.Ç, me vendimin nr.37 (51-2013-2901), date 05.07.2013, ka vodosur:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Sigurimin e padisë, duke marrë masë provizore pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv nr.19/1, datë 23.03.2013.

ii) Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim përbartuesi gjyqësor dhe shtetasja E.M (Z) dhe dosja është dërguar për shqyrtim në Gjykatën e Apelit xxx me datë 23.07.2013 e cila e ka shqyrtuar ankirnin e mësipërm dhe me vendimin nr.72, datë 26.09.2013, ka vodosur: "Ndryshimin e vendimit nr.37, date 05.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx dhe rrëzimin e kërkesës".

iii) Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor xxx rezulton se ndaj këtij vendimi është paraqitur rekurs jo i plotë nga ana e kërkuesit T.Xh, në Gjykatën e Lartë, e cila e ka kthyer rekursin për plotësim. Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx i është kërkuar kërkuesit, më datë 13.11.2013, plotësimi i rekursit brenda 10 ditëve, pasi në të kundërt do t'i kthehet konform nenit 476 te K.Pr.Civile.
iv) Gjithashtu rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor xxx është regjistruar padia e themelit, konkretisht çështja nr.31007-02347-51-2013, datë 12.07.2013, që i

përket paditësave T.Xh., P.R., të paditur: Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Shkodër, përmbarues G.B, E.M, me objekt: "Pavlefshmëri i titullit ekzekutiv. Detyrimin për të privatizuar ambientet. Kjo çështje është në proces gjykimi.

13. Në të dyja këto raste (ankesat e shtetasit M.M dhe shtetasë E.Z), gjykata ka disponuar brënda afatit 5 ditor të parashikuar nga neni 202 i K.Pr.Civile dhe vendimi është marrë në seancë gjyqësore, në prani vetëm të kërkuesve dhe në mungesë të Entit Kombëtar të Banesave ku ka qënë në cilësinë e personit të tretë në gjykim, por nuk është njoftuar nga gjykata.

14. Në rastin e vendimit gjyqësor nr.37 (51-2013-2901), datë 05.07.2013, kërkesa për sigurim padie është paraqitur 7 ditë para ngritjes së padisë së themelit, konkretisht më datë 12.07. 2013. Në vendimin e mësipërm, nga ana e gjyqtarit A.Ç, nuk është zbatuar detyrimi i përcaktuar nga neni 204 të K.Pr.Civile, sipas të cilit, sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia. Në këtë rast gjykata cakton një afat jo më shumë se pesëmbëdhjetë dite, brënda të cilit duhet të paraqitet padia në gjykatë. Kjo pasi, referuar nenit 211 të K.Pr.Civile, mosparaqitura e padisë brënda afatit të përcaktuar nga gjykata e lidh me rastin e rënies nga fuqia të masës së sigurimit të padisë të caktuar në rastin konkret. Pavarësisht faktit të mësipërrn, padia e themelit për çështjen nr.37(51-2013-2901), datë 05.07.2013, është ngritur, pas 7 ditësh nga shpallja e vendimit të sigurimit të padisë, dhe pikerisht më datë 12.07.2013. Ndërsa në rastin e vendimit nr.47/51-5013-34S1, date 04.09.2013, padia e themelit ishte hapur 10 ditë përpara kërkësës për sigurimin e padisë, konkretisht më datë 23.08.2013.

15. Veprimitaria gjyqësore e gjyqtarit A.Ç, në të dy rastet, ankesat e relacionit të tretë është në kundërshtim me ligjin dhe konkretisht me nenin 3 të Aktit Normativ nr.3, datë 01.08.2012 "Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara", sipas të cilit, pronari i pronës ose një përfaqësues i ngarkuar prej tij me autorizim të posaçëm ka të drejtë t'i drejtohet shërbimit përmbarimor gjyqësor, pas lëshimit të urdhërit të ekzekutimit nga gjykata, që të bëjë lirimin e banesës. Gjykata e Shkallës së Parë nuk mund të kryejnë pezullimin e këtij urdhëri ekzekutimi.

16. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.1, datë 06.02.2013 ka trajtuar edhe përcaktimin e paragrafit të fundit të Aktit Normativ, citojmë: "D. Në lidhje me pretendimet e tjera

52. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se akti objekt kundershtimi cënon parimin e ndarjes dhe balancimit midis pushteteve. Këshilli i Ministrave ka ushtruar kompetenca ligjvënëse, duke nxjerrë aktin normativ, si dhe duke parashikuar kategoritë reja të titujve ekzekutive, përtej atyre që parashikon KPC-ja. Nga ana tjetër, para-



shikimi i detyrimit të gjykatave të shkallëve të para për mospezullimin e titujve ekzektivë cënon pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe të drejtën themelore për një process të rregullt ligjor, sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. 53. Referuar natyrës së pretendimeve të kërkuar, Gjykata rithekson qëndrimet e mbajtura në vendimarrjet e saj të mëparshme se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme apo ligjeve dhe kodeve. Në juridikacionin kushtetues hyjnë papajtueshmëria e ligjeve apo kodeve me Kushtetutën, kurse mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera, nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese (shih vendimin nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese). 54. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se, përderisa nuk vëren cënim të parimeve kushtetuese, si: siguria juridike, parimi i mosdiskriminimit dhe parimi i proporcionalitetit, siç pretendon kërkuari, ky i fundit nuk legjitimohet për të kérkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së aktit (ligjit) në vështrim të neneve 7 dhe 116 të Kushtetutës (shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese)."

17. Rezulton se lidhur me ankesat e shtetasit M.M dhe shtetasë E.Z gjyqtari A.Ç ka shkelur në mënyrë të përsëritur dhe të pajustifikuar dispozita urdhëruese procedurale, duke marrë 2 vendime haptazi të paligjshme. Këtë fakt, e përforcojnë edhe vendimet e Gjykatës së Apelit xxx, ku në të dyja rastet, është vendosur ndryshimi i vendimeve për vendosjen e masës së sigurimit dhe rrëzimi i kërkesës së kérkuarve, duke arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në kundërshtim të hapur me parashikimet e nenit 3 të Ligjit nr.82, datë 13.09.2012 "Për miratimin e Aktit normativ nr.3, datë 01.03.2012".

18. Nga ana e gjyqtarit A.Ç, nuk është zbatuar neni 16 i K.Pr.Civile, i cili parashikon se, gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Nga shkelja e pajustifikuar dhe e përsëritur e dispozitave urdhëruese procedurale, kanë ardhur pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim. Neni 41/1 dhe 43/1 të Kushtetutës së R.Sh. garantonjë të drejtën e pronës private dhe mbrojtjen e saj nga cënimini nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor.

19. Veprimet e kryera nga gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, A.Ç, janë shkelje shumë të rënda të disiplinës, të parashikuara nga neni 32, pika 2, shkronja "c" e ligjit 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", në të cilin parashikohet se : "Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë: c) shkelja e pajustifikuar dhe e përsëritur e dispozitave urdhëruese procedurale, kur këto shkelje kanë passjellë ose mund të sillnin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim ose për dhëni e drejtësisë".

20. Për të tre relacionet e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë konkludon se shkeljet e gjyqtarit A.Ç, parashikohen nga neni 32, pika 2, shkronja "c" të ligjit 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si raste të përgjegjësisë disiplinore në kategorinë e shkeljeve shumë të rënda dhe i propozon Këshillit të Lartë të Drejtësisë, procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, A.Ç, dhe marrjen e masës disiplinore "shkarkim nga detyra" ndaj tij.

21. Avokati Mark Marku, që përfaqësonte gjyqtarin e proceduar disiplinarisht (prokurë nr.217 rep, nr.251 kol, dt 23.01.2014 të noteres I.H), preten doi se shkeljet e konstatuara nuk janë thelbësore por shkelje materiale dhe nuk jemi dakort me masën ekstreme "shkarkim nga detyra". Ai i justifikoi shkeljet:

- i) Me ngarkesën jashtëzakonisht të madhe të volumit të punës së përballuar nga ky gjyqtar ".....dhe vetëm 34/35 vendime janë vonuar". Gjithashtu, avokati për sa i përket çështjes së shtetasit S.J. Kjo çështja ka kaluar në tre gjyqtarë rresht njëri pas tjeterit, janë hedhur në short dhe i fundit ka kaluar i gatshëm tek gjyqtari A.Ç. Fakti është se ditën që ka shkuar çështja, gjyqtari nuk ka qenë në punë, ka qenë me raport. Kjo është e vërtetuar në dosjen që ka patur, që është dorëzuar pranë sekretarisë të gjykatës së bashku me reportin.
- ii) Për çështjen e qytetarit M.M. "...Gjyqtari në këtë rast ka bërë pushimin e gjykimit, pasi kjo çështje është gjykuar nga një gjyqtar tjeter në Gjykatën e Shkallës së Parë xxx;
- iii) Gjithashtu për sa i përket qytetarit E.Z., "...Nuk qëndron, gjyqtari e ka dhënë vendimin, dispozitivin e tij, dhe shtetasi kishte të drejtën e ankimit.
- iv) Sëmundja nga e cila gjyqtari vuani, e cila është një sëmundje kardiake, sklerozë multiple, e konstatuar gjatë punës.

II. Vlerësime të Këshillit

22. Këshilli i Lartë i Drejtësisë nga faktet e parashtruara konstaton se lidhur me çështjet e gjykuara dhe të padorëzuara apo dorëzuara me vonesë nga gjyqtari A.Ç, përbën shkelje shumë të rëndë të ligjit me pasojë cënimin e lirive dhe të drejtave themore të njeriut. Në këtë kontekst, neni 15, pika 2 e Kushtetutës parashikon "Organet e pushtetit publik, në përbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre". Ky parashikim kushtetues shihet i lidhur me detyrime të tjera që, akti themelor i shtetit i ngarkon në mënyrë të posaçme pushtetit gjyqësor. Konkretisht, neni 43 i Kushtetutës, i njeh kujtdo të drejtën për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor, në një gjykatë më të lartë, të drejta këto të parealizuara për palët pjesëmarrëse në proceset e cituara më lart, të gjykuara prej tij.

23. Gjatë veprimtarisë gjyqësore në mënyrë të përsëritur, gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, A.Ç, ka shkelur disa dispozita të detyrueshme për zbatim të legjislacionit procedural në fuqi në Republikën e Shqipërisë:

i) Kodin e Proçedurës Civile, nenin 1, ku parashikon se rregullat e tij janë të detyrueshme për t'u zbatuar. Neni 4 i këtij kodi, i vë detyrë gjyqtarit të realizojë një proces të rregullt ligjor, duke marrë masat e nevojshme për zhvillimin e tij, deri në finalizimin, me arsyetimin e vendimit dhe dorëzimin e tij sipas afateve ligjore, "Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vンドos për afatet dhe urdhëron marjen e masave të nevojshme".
ii) Me veprimet e tij, gjyqtari A.Ç, ka shkelur edhe parashikimit e bëra në nenin 308 të K.Pr.Civile. Kjo dispozitë urdhëron gjyqtarin e çështjes që të depozitojë vendimin e arsyetuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit dhjetë ditor nga shpaljja e vendimit përfundimtar për konfliktin civil të zgjidhur prej tij. Mosdorëzimi i vendimeve gjyqësore brenda këtij afati është bërë në mënyrë të pajustifikuar.
iii) Konstatohen shkelje edhe të dispozitave procedurale penale konkretisht nen 2 i K.Pr.Penale, përcakton detyrueshmërinë e zbatimit të rregullave të parashikuara në të, nga organet shtetërore, ku natyrisht një rol të rëndësishëm luan gjykata. Duke mos arsyetuar vendimet për masat e sigurimit personal dhe kërkuesat administrative penale, gjyqtari ka shkelur disponimet urdhëruese të nenit 386 të K.Pr. Penale duke mos respektuar afatin e parashikuar në të, për depozimin e vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore. Njëkohësisht ai ka shkelur nenin 113 të K.Pr. Penale, duke mos depozituar fashikullin në Sekretarinë Gjyqësore brenda afatit 5 ditor: "Origjinalitet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brënda pesë ditëve nga bërrja e tyre. Për aktet e ankueshme njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim". Referuar këtij parashikimi të fundit ligjor, konsiderohet si afat përfundimtar brënda të cilit, gjyqtari duhet të depozitojë vendimin e arsyetuar në sekretari bashkë me dosjen përkatëse, afati pesë ditor nga data e shpalljes. Në asnjë dispozitë tjeter të K.Pr.Penale nuk ekziston ndonjë përashtim nga ky rregull, pra nga ky afat.

24. Shkaku kryesor për masën disiplinore "shkarkim nga detyra", është kryesisht mosrespektimi nga ana e gjyqtarit të dispozitave procedurale në gjykimin e çështjeve dhe konkretisht "moskryerja në kohë dhe në mënyrë të përsëritur të detyrës nga ana e gjyqtarit, lidhur me arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përfundimtare". Këto veprime të tij janë kryer në mënyrë të përsëritur dhe të pajustifikuar duke sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim si dhe përdhënien e drejtësisë. Sa më sipër këto shkelje disiplinore janë konsideruar nga ligjvënësi si akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, në kuptim të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008.

25. Shkeljet e konstatuara rezultojnë dhe dalin qartë në të gjitha aktet shkresore të marra në shqyrtim në këtë vendimmarrje të Këshillit, siç janë relacionet e inspektorëve të IKLD dhe shkresat përkatëse, procesverbalet e verifikimit të kryera prej

tyre apo dhe vetë kërkesa e Ministrit drejtuar KLD.

26. Shkeljet e konstatuara vonesat në dorëzimin e 34 vendimeve dhe për rrjedhøjë dhe të dosjeve gjyqësore (shih përshkrimin në pikën 8 të këtij vendimi), të cilat variojnë nga 10 ditë deri në 3 muaj e 22 ditë; nga 1 muaj e 18 ditë deri në 1 muaj e 19 ditë, kanë konsistuar në mosrespektimin në mënyrë të vazhdueshme, të përsëritur dhe të pajustifikuar të dispozitave procedurale (civile dhe penale), duke sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim si dhe për dhëni e drejtësisë. Këto shkelje kanë diskredituar rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit.

27. KLD vlerëson se respektimi i dispozitave procedurale të cilat lidhen me dorëzimin e vendimeve brenda një afati te arsyeshëm, në mënyrë që të mos cënohen të drejtat kushtetuese të palëve në proces dhe të mos pengohet dhënia e drejtësisë, është e lidhur drejtpërsëdrejti me respektimin e parimit të zhvillimit dhe përfundimit të një procesi brenda një afati të arsyeshëm. Me afat të arsyeshëm ligjor kuptohet jo vetëm koha që merr shqyrtimi i çështjes deri në shpalljen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës, por edhe koha që i nevojitet gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar. Gjithashtu, Këshilli është i vetëdijshme se respektimi i afatit të arsyeshëm ligjor varet nga shumë faktorë të procesit të gjykimit të cilët janë të lidhur dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e këtij procesi, siç mund të jenë: sjelljet e palëve në proces, kompleksiteti i çështjes, përkushtimi dhe aftësia e gjykatës dhe administratës gjyqësore për përfundimin në kohë të procesit dhe ushtrimin e detyrës në përputhje me ligjin, etj. Afati i arsyeshëm që merret në konsideratë për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi merr formë të prerë. (Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut neni 6 “1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht,...”).

28. Këshilli thekson se afatet brenda të cilit duhet të dorëzohen vendimet e arsyetuar janë përcaktuar në dispozitat procedurale si neni 308 i K.Pr.Civile, neni 113, 179, 386 i K.Pr.Penale dhe se nuk është konstatuar se nga gjyqtari është marrë ndonjë masë për të eliminuar çdo lloj shkaku objektiv, nëse ka ekzistuar, që ato të dorëzohen brenda një afati të arsyeshëm në mënyrë që në çdo rast, dorëzimi i vendimeve të mos marrë më shumë kohë se sa ka marrë vetë procesi gjyqësor, apo ato të mbahen pafundësisht të bllokuara dhe të padorëzuara. Eficiencia në drejtësi është një kriter i rëndësishëm për zhvillimin dhe konsolidimin e një procesi të rregullt ligjor si dhe për rivendosjen e të drejtave të palëve të pretenduara të shkelura. Prandaj këto vonesa ndikojnë dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë tek palët në proces pasi u cënohen këtyre të fundit të drejtat e tyre kushtetuese dhe përfundimisht procesi gjyqësor degradon në një proces joefektiv.

Të njëjtin qëndrim Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka mbajtur së fundmi edhe në dy raste të tjera, në shkarkimin nga detyra të ish gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, N.T (vendim i KLD nr.301/2 datë 07.12.2012) dhe të ish gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, Xh.K. (vendim i KLD nr.306 datë 08.03.2013).

29. Në sjelljen e gjyqtarit Çepele, KLD konstaton një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tillë që kalojnë “kufirin e të arsyeshmes”, dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, sjellje e cila çon në cënimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.

30. Nisur nga analiza e mësipërme, vlerësohet se vonesat e gjyqtarit në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore konsiderohen si shkelje disiplinore në kuptim te nenit 32/1/a si dhe nenit 32/2/c të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 dhe e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore pasi:) këto vonesa janë të vazhdueshme, të përsëritura dhe të pajustifikuara;

i) këto vonesa kanë sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë;

ii) këto vonesa janë jashtë çdo afati të arsyeshëm logjik dhe objektiv;

iii) këto vonesa kanë cenuar imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut të drejtësia

31. Gjithashtu, Këshilli konstaton se gjyqtari A.Ç është në pamundësi efektive për të ushtruar normalisht detyrën. Sëmundja i shkakton gjyqtarit paaftësi fizike e cila domosdoshmërisht reflektohet në punën e tij, sëmundje e cila ka premisa të qarta që do të jetë e vazhdueshme duke ndikuar në vijimësi të punës së tij.

32. Këshilli i Lartë i Drejtësisë konklidon se:

i) shkeljet e konstatuara në veprintarinë gjyqësore të gjyqtarit A.Ç vlerësohen se kanë ka shkaktuar shqetësim në një masë të madhe të njerëzve të interesuar, duke dëmtuar besimin e publikut tek dhënia e administrimi i drejtësisë, duke ulur imazhin e sisteminit gjyqësor, duke prekur interesat e një mase të madhe njerëzish (vendime të zbardhura me vonesë përtëj afateve të parashikuara në ligj, por edhe përtëj afateve të arësyeshme. Këto kanë shkaktuar dëme për palët, kanë cënuar të drejtat e tyre kushtetuese).

ii) shkeljet e konstatuara në veprintarinë gjyqësore janë haptazi në kundërshtim me ligjin (pezullimi i titullit ekzekutiv)

iii) Sjellja e gjyqtarit ka diskredituar rëndë pozitën dhe figurën e tij, dhe ka treguar paaftësinë e tij për të përballuar punën e tij të përditshme.

33. Këto veprime të gjyqtarit A.Ç, përbëjnë shkelje disiplinore dhe parashikohen nga neni 147 pika 6 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet: “Gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale.....”.



34. Njëkohësisht, këto veprime janë parashikuar si shkelje të disiplinës, edhe nga neni 32 pika 2 gërmë "c" të Ligjit Nr.9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Në faktet që i atribuohen gjyqtarit A.Ç plotësohen të gjitha kushtet e këtij parashikimi ligjor:

- i. shkelja e pajustifikuar të dispozitave urdhëruuese procedurale;
- ii. shkelja e përsëritur të dispozitave urdhëruuese procedurale dhe;
- iii. ardhja ose mundësia e ardhjes së pasojave për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 147 pika 6 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, në Ligjin Nr.9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Vendimin nr.137, datë 21.02.2003 Rregullore "Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve" i ndryshuar, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është i mendimit se, propozimi i Ministrit të Drejtësisë për masën disiplinore "Shkarkim nga Detyra" është i drejtë dhe duhet pranuar.

V E N D O S I :

1. Pranimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, A.Ç.
2. Dhënien e masës disiplinore "Shkarkim nga Detyra" ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, A.Ç.
3. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet rregullisht gjyqtarit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Lartë, brënda 15 ditëve nga njoftimi i tij

U shpall sot, më datë 15.04.2014.

ZËVENDËSKRYETARI

ELVIS ÇEFA

Vendim Nr. 62, datë 28.05.2014

**PËR DHËNIE TË MASËS DISIPLINORE “VËREJTJE” NDAJ
GJYQTARES L.H.**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjen e datës 28.05.2014, mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, për procedimin disiplinor të gjyqtar_ të Gjykatës së Apelit X, L.H. dhe marrjen ndaj saj të masës disiplinore “Vërejtje me paralamërim”. Kjo masë disiplinore, në bazë të nenit 11 të Rregullores “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve” miratuar me Vendimin e KLD-së Nr.137, datë 21.02.2002, i ndryshuar, u propozua nga Ministri i Drejtësisë përpëra votimit në vend të masës “ulje e përkohshme për 1 deri në 2 vjet në detyrë në një gjykatë të një niveli më të ulët” propozuar me shkresën nr. 42 prot, datë 08.01.2013. Këshilli si dëgjoi pretendimet e gjyqtarit të proceduar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë,

VËRSE:

I. Mbi rrethanat e çështjes

1. Ministri i Drejtësisë me shkresën nr.42 prot., datë 08.01.2013, i ka dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkesën për procedimin disiplinor ndaj gjyqtar_ së Gjykatës së Apelit X, L.H.. Kërkesa për procedim, ka marrë shkas shkeljet që ka konstatuar Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, në veprimtarinë e saj gjyqësore, bazuar në inspektimin e kryer në zbatim të urdhrit nr. 379, datë 13.08.2012 «Për ushtrim inspektimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor X dhe Gjykatën e Apelit X», në datat 14.08.2012 dhe 15.08.2012, ku objekti i këtij inspektimi ishte verifikimi i procedurave gjyqësore të zbatuara gjatë gjykimit të tre çështjeve penale në ngarkim të dënuarit S.K.

2. Gjithashtu, në kërkesën e tij Ministri i propozon Këshillit të Lartë të Drejtësisë, bashkimin e kësaj kërkese për procedim disiplinor, me kërkesën për procedim disiplinor, dërguar KLD-së, me shkresën nr. 239/11, datë 30.10.2012, me anë të së cilës përsëri Ministri i Drejtësisë ka kërkuar procedimin disiplinor të kësaj gjyqtareje pasi ajo ka rezultuar me shkelje të ligjit gjatë inspektimit të ushtruar në zbatim të urdhrit nr. 239, datë 05.06.2012 «Për ushtrimin e kontrollit në Prokuroritë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Fier, Vlorë e Shkodër, si dhe në Gjykatat e Apelit Vlorë e Shkodër». Në përfundim të këtij inspektimi, Ministri i Drejtësisë i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me aktin nr. 239/11, datë 30.10.2012 procedimin disiplinor të gjyqtar_ së Gjykatës së Apelit X, L.H., si dhe caktimin e masës «ulje e përkohshme për 1 deri në 2 vjet në detyrë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor X» ndaj saj.

3. Kjo kërkësë e Minisrit për procedim disiplinor bërë me shkresën nr. 239/11, datë 30.10.2012, është trajtuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në mbledhjen e datës 18 janar 2013 dhe me vendimin nr.303/15 Këshilli pranoi kërkesën e Ministrit të Dre-



jtësisë gjatë seancës plenare, për të shtyrë në një mbledhje të ardhshme, shqyrtimin e kërkesës së tij pér këtë rast, për shkak se ndaj kë_ gjyqtar_ të Gjykatës së Apelit X, L.H., ka dhe një procedim tjetër disiplinor dhe do të kerkonte bashkimin e tyre në një të vetëm.

4. Mbi bazën e shkeljeve të konstauara, Ministri i Drejtësisë, ka kerkuar fillimisht që ndaj gjyqtares të lartpërmendur, të merret masa disiplinore «ulje e përkohshme pér 1 deri në 2 vjet në detyrë në një gjykatë të një niveli më të ulët», e parashikuar nga neni 33/1 shkronja «c», të Ligjit Nr.9877, datë 18.02.2008 «Pér organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë».

5. Nga vlerësimi që i është bërë kërkesës së Ministrit të Drejtësisë, dokumentacionit shkresor të administruar, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Këshilli vlerëson se:

i) shqyrtimi i kërkesës së paraqitur në këtë procedurë, nga pikëpamja formale dhe ajo proceduriale është në kompetencën ligjore të KLD-së, në bazë të pikës «ç» të nenit 2 dhe neneve 31 e vijues të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 «Pér organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë».

ii) në referim të akteve shkresore, Ministri i Drejtësisë legjitimohet si nga pikëpamja procedurale, ashtu edhe nga pikëpamja materiale, bazuar në pikën 3 dhe 4 të nenit 31 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 «Pér organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë», si dhe në nenin 34 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 «Pér organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë». iii) kërkesa e depozituar në KLD nga Ministri i Drejtësisë, është brënda afatit të parashikuar në nenin 34 të ligjit nr.9877 datë 18.02.2008 «Pér organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë». Konkretisht nga data e kryerjes së shkeljes kanë kaluar më pak se 5 vjet dhe nga data e vënies në dijeni me shkeljen të Ministrit të Drejtësisë, në cilësinë e organit që ka të drejtën e nisjes së procedimit disiplinor, ka kaluar më pak se 1(një) vit.

6. Shqyrtimi i kërkesës pér procedim ka qënë pjesë e rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit datë 18.01.2014 (me shkresën nr. 239/11, datë 30.10.2012) si dhe e datës 28.05.2014 (nr.42 prot., datë 08.01.2012). Gjyqtar_ është vënë në dijeni me shkresën nr. 1843, datë 23.05.2014 (pér seancën e mbledhjes së KLD).

7. Rregullorja «Pér procedimin disiplinor të gjyqtarëve» në nenin 5 të saj parashikon se: «Mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në të cilën do të shqyrtohet procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari duhet të caktohet jo më shpejt se dhjetë ditë nga data që gjyqtarit i janë vënë në dispozicion materialet e plota të procedimit”. Gjyqtar_ e proceduar L.H., është njohur me kërkesën e Ministrit të Drejtësisë dhe me materialet e tjera të procedimit në adresë të saj, me shkresën nr. 1843 datë 23.05.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, provohet se i janë vënë në dispozicion:

i) Kërkesa e Ministrit të Drejtësisë pér procedimin disiplinor;

ii) Praktika e materialeve të procedimit dhe mendimi i gjyqtar_, depozituar në Ministrinë e Drejtësisë.

8. Gjithashtu në nenin 6 po të Rregullores «Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve», parashikohet se: «Gjyqtari ndaj të cilët zhvillohet procedimi disiplinor duhet të njoftohet për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën dyzetetë orë përpara fillimit të saj». Gjyqtar_ L.H., është njoftuar për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, brenda këtij afati, dhe konkretisht, me shkresën nr. 1843 datë 23.05.2014, gjyqtarja është njoftuar për mbledhjen që do zhvillohej më datë 28.05.2014, në të cilën do të shqyrtohej kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj saj. Pra, më shumë se 48 orë para shqyrtimit të kërkesës është bërë njoftimi për mbledhjen e kësaj date.

9. Nga sa u parashtrua, rezulton se gjyqtar_ Lindita Hoxha i janë garantuar të gjitha të drejtat procedurale të parashikuara nga ligji dhe nga rregullorja, duke u zhvilluar në këtë mënyrë një proces i irregullt ligjor nga ana procedurale.

10. Inspektorati i Ministrit të Drejtësisë referuar inspektimit në zbatim të urdhrit nr. 239, datë 05.06.2012 «Për ushtrimin e kontrollit në Prokuroritë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Fier, Vlorë e Shkodër, si dhe në Gjykatat e Apelit Vlorë e Shkodër» ka konstatuar se Gjyqtar_ Lindita Hoxha, rezulton të ketë mangësi në lidhje me dorëzimin në afat të 2 vendimeve penale (masë sigurimi), përkatësisht vendimi nr. 137, datë 30.05.2011 dhe nr. 89, datë 06.04.2011 të Gjykatës së Apelit X dhe konkretisht:

(i) Gjyqtar_ ka dorëzuar dosjen në k/sekretari pas 6 muajve nga shpallja e vendimit, në kundërshtim me nenin 113 të K.Pr.Penale. Sekretarja gjyqësore S.B. ka dorëzuar dosjen në k/sekretari pas 1 muaj e 17 ditë nga shpallja e vendimit, në kundërshtim me nenin 113 të K.Pr.Penale. Pra dorëzimi i dosjes në k/sekretari është bërë përfundimisht pas 7 muaj e 17 ditëve nga shpallja e vendimit.

(ii) Gjyqtar_ ka dorëzuar dosjen në k/sekretari pas 8 muajve nga shpallja e vendimit, në kundërshtim me nenin 113 të K.Pr.Penale. Sekretarja gjyqësore S.B. ka dorëzuar dosjen në k/sekretari pas 1 muaj e 11 ditë nga shpallja e vendimit, në kundërshtim me nenin 113 të K.Pr.Penale. Pra dorëzimi i dosjes në k/sekretari është bërë përfundimisht pas 9 muaj e 11 ditëve nga shpallja e vendimit.

11. Këto shkelje të konstatuara dhe të referuara në pikën 9 të këtij vendimi, konsiderohen nga Ministri, referuar nenit 32, pika 3 të ligjit Nr.9877, datë 18.02.2008, «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë», si shkelje të rënda të disiplinës nga gjyqtar_ L.H.. Në pikën 3 parashikohet se: «Janë shkelje të rënda aktet dhe sjelljet që diskretitojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë: a) zvarritja e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit, kur zvarritja ka pasjellë ose mund të sillte pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë;

12. Me veprimet e __j, gjyqtar_ L.H., ka shkelur parashikimet e bëra në nenin 113 të K.Pr.Penale. Kjo dispozitë urdhëron gjyqtarin e çështjes që origjinallet e akteve të gjykatës t-i depozitojë në sekretari brenda 5 ditëve. Po në të njëjtën mënyrë ajo gjyqtare ka shkelur disponimet urdhëruese të nenit 386 të K.Pr.Penale duke mos respektuar afatin e parashikuar në të pér depozitim e vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore. Edhe në Kodin e Procedurës Penale, konkretisht në nenin 2 të tij, është sanksionuar detyrueshmëria e respektimit të rregullave të parashikuara në të, pér mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe të gjykimit të veprave penale.

13. Shkelja e këtyre dispozitave urdhëruuese procedurale është bërë në mënyrë të përsëritur, duke qënë se janë verifikuar 2 raste me objekt caktim mase sigurimi.

14. Gjithashtu, gjyqtar_ L.H. ka marrë pjesë në cilësinë e anëtares së kolegjit penal të Gjykatës së Apelit X në gjykimin dhe marjen e vendimit nr.58, datë 09.04.2012, pér caktimin e masës së sigurimit personal tështetasit S.K., sipas të cilit është vendsur miratimi i vendimit nr. 130 datë 12.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X. Me këtë vendim është caktuar masa e sigurimit, ndaj shtetasit, S.K., «arrest në shtëpi». Ndaj vendimit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 00-2012-910 (199), datë 04.07.2012, bazuar në nenin 249 pika «8», të K.Pr.Penale, ka ndryshuar vendimin nr. 58 datë 09.04.2012, të Gjykatës së Apelit X, duke i caktuar personit nën hetim S.K. masën e sigurimit atë të «arrestit në burg», parashikuar nga neni 238 i K.Pr. Penale.».

15. Gjykata e Lartë (Kolegji Penal) ka konkluduar se vendimi nr. 130 datë 12.03.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, i lënë në fuqi me vendimin nr. 58 datë 09.04.2012, të Gjykatës së Apelit X, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe pér këtë shkak duhet të ndryshohet, pasi masa e sigurimit «arrest në shtëpi», është caktuar në shkelje të ligjit procedural penal, me mungesën e arsyetimit të duhur të vendimit pér caktim mase sigurimi, mosmbajtjen në konsideratë të kritereve të përgjithshme dhe të posaçme pér caktimin e masave të sigurimit dhe mosvlerësimin siç duhet të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të autorit të dyshuar. Gjykata e Lartë në vendimin e saj, vlerëson se ka patur dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova se S.K. ka mbajtur armë luftarakë pa leje e llojit pistoletë, në ambiente të hapura, në orë të vona të mbrëmjes, rrethanë kjo që tregon pér një rrezikshmëri shoqërore më të madhe të faktit dhe të vetë autorit, pasi ajo mund të shërbejë si mjet potencial pér kryerjen e veprave të tjera edhe më të rënda. Masa e sigurimit «arrest në shtëpi» nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit dhe rrezikshmërisë shoqërore të autorit, dhe ka patur vend që ndaj personit nën hetim S.K të caktohej masa e sigurimit «arrest në burg» e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit S.K., gjyqtar_ L.H., në cilësinë e anëtares, ka anashkaluar kriteret e përgjithshme (neni 229/1/2 të K.Pr. Penale), ashtu dhe kriteret e veçanta (neni 230/1 i K.Pr. Penale), pa bërë analizë konkrete të rrethanave të faktit mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale.

16. Nga vlerësimi në tërësi i fakteve, Ministri i Drejtësisë çmon se veprimet e gjyqtar L.H. përbëjnë shkelje disiplinore, të parashikuara nga nen 32, të ligjit nr. 9877/2008, «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar. Veprimet e gjyqtares, përbëjnë shkelje të përsëritura të dispozitave urdhëruuese procedurale, që kanë kanë sjellë pasoja të pariparueshme për administrimin e drejtësisë, sepse ka dhënë vendim haptazi të padrejtë dhe në kundërshtim me fryshtësinë e ndjekjes së parimit të ligjshmërisë së caktimit të masave të sigurimit, parashikuar nga nen 2, 228 paragrafi 3, 230 i K.Pr Penale, që disiplinojnë mbarëvajtjen e procedimit penal dhe përshtatshmërisë së masave me shkallën e nevojave të sigurimit personal. Bazuar në nenin 382 të K.Pr. Penale, pas marijes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar në provat dhe ligjin penal. Në nenin 383 të K.Pr. Penale përcaktohet se vendimi përmban gjithashtu dhe parashtrimin e përbledhur të rrëthanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi.

17. Gjithashtu, Ministri i Drejtësisë vlerëson se veprimet e gjyqtares bien ndesh edhe me parimet e deontologjisë gjyqësore. Në bazë të rregullit 1 të Kodit të Etikës Gjyqësore është parashikuar se gjyqtari duhet të respektojë dhe zbatojë Kushtetutën e ligjet dhe duhet të veprojë gjithmonë në mënyrë që të rrisë besueshmërinë e publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor, ai duhet të përbushë detyrat e tij duke treguar kujdesin maksimal në respektimin e ligeve dhe në rritjen e nivelit të eksperiencës profesionale. Sipas rregullit 6 të Kodit të Etikës Gjyqësore, gjyqtarët duhet t'u japid zgjidhjen e duhur, me eficencë dhe me drejtësi të të gjitha çështjeve gjyqësore, duke respektuar me korrekësni Kushtetutën dhe ligjet. Të dy këto elemente mungojnë në rastin objekt inspektimi. Po në të njëjtën mënyrë, gjyqtar L.H. ka konsumuar akte të pajustifikuara, në kundërshtim me legjislacionin procedural, nenin 11 dhe 12 të K.Pr. Penale.

18. Gjyqtar L.H. në bazë të nenit 35 të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 «Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë», i janë ofruar të gjitha të drejtat për një procedim disiplinor. ushtroi të drejtën për t'u dëgjuar prej Këshillit dhe paraqiti pretendimet e _j si më poshtë:

Pretendimi i parë lidhej me ngarkesën e saj sasiore që ka ndikuar në vonesën në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Gjykata e Apelit X mbalon 6 gjykata të irretheve, ka pasur një numër shumë të madh çështjesh për gjykim. Nga ana tjetër, ajo është komanduar për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjithashtu, ajo ka patur edhe probleme shëndetësore.

Pretendimi i dytë lidhej me natyrën e shkeljes së pretenduar nga Ministri i Drejtësisë. Sipas saj, dhënia e vendimit nr.58, datë 09.04.2012, për caktimin e masës së sigurimit personal të shtetasit S.K., duke vendosur miratimin e vendimit nr. 130, datë 12.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, nuk mund të konsiderohet shkelje e rëndë. Vlerësimi material i çështjes mbi bazën e bindjes së brendshme që gjyqtari

krijohet gjatë shqyrtimit të faktave në seancë gjyqësore dhe në rastin konkret, sipas saj, pasojë nuk ka ardhur. Vonesa e dorëzimit të vonuar të këtij vendimi gjyqësor dhe i fashikullit gjyqësor nuk është kryer prej saj pasi ajo ka qënë anëtarë e trupit gjykues, nuk ka patur asnjëherë në dorëzim dosjen dhe vendimi i shumicës nuk është arsyetuar prej saj, por prej anëtarit tjetër të kolegit penal.

II. Vlerësimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

19. Këshilli i Lartë i Drejtësisë nga faktet e parashtruara konstaton se lidhur me çështjet e gjykuara dhe të dorëzuara me vonesë nga gjyqtar_ L.H., përbën shkelje të ligjit me pasojë cënimin e lirive dhe të drejtave themore të njeriut. Në këtë kontekst, neni 15, pika 2 e Kushtetutës parashikon «Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre». Ky parashikim kushtetues shihet i lidhur me detyrime të tjera që, akti themelor i shtetit i ngarkon në mënyrë të posaçme pushtetit gjyqësor. Konkretnisht, neni 43 i Kushtetutës, i njeh kujdo të drejtën për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor, në një gjykatë më të lartë, të drejta këto të parealizuara për palët pjesëmarrëse në proceset e cituara më lart, të gjykuara prej tij.

20. Gjyqtar_ ka mangësi në lidhje me mos dorëzimin në afat të 2 vendimeve penale (masë sigurimi), përkatësisht vendimi nr. 137, datë 30.05.2011 pas 1 muaj e 17 ditë nga shpallja e vendimit dhe nr. 89, datë 06.04.2011, pas 1 muaj e 11 ditë nga shpallja e vendimit, të Gjykatës së Apelit X, duke shkelur ninen 113 të K.Pr.Penale, që urdhëron gjyqtarin e çështjes që originalet e akteve të gjykatës t'i depozitojë në sekretari brenda 5 ditëve. Veprimet e gjyqtares janë në shkelje të disponimeve urdhëruese të nenit 386 të K.Pr.Penale duke mos respektuar afatin e parashikuar në të për depozitimin e vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore. Edhe në Kodin e Procedurës Penale, konkretnisht në nenen 2 të tij, është sankzionuar detyrueshmëria e respektimit të rregullave të parashikuara në të, për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe të gjykimit të veprave penale. Duhet theksuar këtu se këto vendime janë vendime të një Gjykate Apeli, e cila në nivel hierarkik është në nivelin e dytë të sistemit gjyqësor. Për pasojë, kujdesi i një gjyqtari për respektimin e afateve në Gjykatën e Apelit duhet të jetë më i lartë, jo vetëm sepse vendimi në shkallë të dytë lidhet me ekzekutimin e vendimeve, por edhe përfaktin se një gjyqtar i shkallës së dytë duhet të përbëjë model orientues për gjyqtarët e shkallës së parë. Në rastin konkret, duhet theksuar gjithashtu edhe natyra e vendimit të masës së sigurimit, që për nga thelbi janë me natyrë urgjente sepse lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me lirinë personale të qytetarit, e cila për shkak të rëndësisë garantohet edhe në nivel kushtetues. Nga ana tjetër, vendimi gjyqësor mbi masat e sigurimit synon të garantojë edhe një procedim të rregullt penal për prokurorinë, që ngrë dhe përfaqëson akuzën në gjykatë në emër të shtetit. Për pasojë, arsyetimi në kohë dhe me cilësi i vendimeve mbi masat e sigurimit është një detyrim i gjyqtarit, përmbushja e të cilit i tregon shoqërisë se liritë themelore të qytetarit respe-

ktohen dhe se administrimi i drejtësisë penale, që mbron shoqérinë nga kriminaliteti, funksionon në mënyrën e duhur. Kjo është një arsyeshëm, përfundimtari i gjykatës së Apelit duhet të jetë i një niveli të lartë.

21. KLD vlerëson se respektimi i dispozitave procedurale të cilat lidhen me dorëzimin e vendimeve brenda një afati te arsyeshëm, në mënyrë që të mos cënohen të drejtat kushtetuese të palëve në proces dhe të mos pengohet dhënia e drejtësisë, është e lidhur drejtpërsëdrejti me respektimin e parimit të zhvillimit dhe përfundimit të një procesi brenda një afati të arsyeshëm. Me afat të arsyeshëm ligjor kuptohet jo vetëm koha që merr shqyrtimi i çështjes deri në shpalljen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës, por edhe koha që i nevojitet gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar. Gjithashtu, Këshilli është i vetëdijshëm se respektimi i afatit të arsyeshëm ligjor varet nga shumë faktorë të procesit të gjykimit të cilët janë të lidhur dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e këtij procesi, siç mund të jenë: sjelljet e palëve në proces, kompleksiteti i çështjes, përkushtimi dhe aftësia e gjykatës dhe administratës gjyqësore përfundimin në kohë të procesit dhe ushtrimin e detyrës në përputhje me ligjin, etj.

22. Vendimi nr. 58, datë 09.04.2012, të Gjykatës së Apelit X, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal në dhënien e masës së sigurimit «arrest në shtëpi», parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, sic është deklaruar nga Gjykata e Lartë (Kolegji Penal) gjatë shqyrimit të rekursit të prokurorit, në të cilin parashtronhet se vendimi i Gjykatës së Apelit X është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe për këtë shkak duhet të ndryshohet, pasi masa e sigurimit «arrest në shtëpi», është caktuar në shkelje të ligjit procedural penal, me mungesën e arsyetimit të duhur të vendimit përcaktim mase sigurimi, mosmbajtjen në konsideratë të kritereve të përgjithshme dhe të posaçme përcaktimin e masave të sigurimit dhe mosvlerësimin siç duhet të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të autorit të dyshuar. Në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit S.K., gjyqtar_L.H., në cilësinë e anëtares, ka anashkaluar kriteret e përgjithshme (neni 229/1/2 të K.Pr. Penale), ashtu dhe kriteret e veçanta (neni 230/1 i K.Pr. Penale), pa bërë analizë konkrete të rrethanave të faktit mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale. Duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtar_ ka shkelur dispozitat urdhëruese procedurale, që synojnë jo vetëm të garantojnë një përcudim të rregullt penal, por edhe të dokumentojnë nëpërmjet një arsyetimi konsistent dhe bindës mirëadministrimin e drejtësisë penale në Republikën e Shqipërisë, si një kërkesë që imponon e gjithë shoqëria.

23. Këshilli vlerëson se me veprimet e _j gjyqtar_L.H. ka kryer shkelje të disiplinës së gjyqtarit, përfundimtari i gjykatës së Apelit X, ka kryer shkelje të disiplinore në raport të drejtë me shkeljen e kryer, siç urdhëron edhe neni 33 pikë 1 e ligjit nr. 9877/2008 «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh».

24. Numri i shkeljeve të kryera nga gjyqtar_ dhe natyra e tyre nuk janë në atë masë



që të përligjin kërkeshën e Ministrit për «Vërejtje me paralajmërim», duke marrë këtu në konsideratë edhe profesionalizmin e gjyqtares (ushtron profesionin për 19 vjet) dhe volumin e punës të pretenduar prej saj. Në këtë kontekst, Këshilli duke vlerësuar edhe argumentet e gjyqtares, konstaton se veprimet e kryera prej _j nuk përbëjnë «shkelje shumë të rëndë» apo «shkelje të rëndë» të disiplinës, sipas koncepteve të përdorura në nenin 32 dhe të Ligjit 9877, datë 18.02.2008.

25. Duke vlerësuar numrin e shkeljeve, natyrën e tyre, llojin e veprintarisë gjyqësore ku janë kryer këto shkelje, përvojës së gjatë të _j (që prezumon se _ ka patur të gjitha mundësitë për të kupuar drejt dhe për të mos i kryer këto shkelje) përballe ngarkesës në detyrë të gjyqtar_ dhe gjendjes së _j shëndetësor, Këshilli vlerëson se shkeljet konkrete janë të lehta, por që gjithësesi kanë diskredituar figurën dhe pozitën e gjyqtarit në kuptim të nenit 32 pika 4 shkronja ç) të ligjit nr. 9877/2008 «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh». Këto vlerësimë të Këshillit janë në përputhje edhe me konkluzionet e Kolegjeve të Bashkuar të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.5 datë 12.12.2013 (N.T. kundër KLD), në një çështje të ngashme, ku theksohet se:

«85. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vazhdim të analizës së mësipërme, vlerësojnë të theksojnë dhe njëherë se jo në çdo rast mosrespektimi i afateve procedurale të përmendura më lart e çon gjyqtarin përparrë procedimit disiplinor. Jo në çdo rast shkeljet që konstatohen në veprintarinë e gjyqtarit dhe në mënyrë të veçantë në veprintarinë e tij për të dorëzuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e arsyetuara do të konsiderohen si shkelje që kanë çuar ne humbjen e besimit dhe kredibilititetit ndaj gjyqtarit apo akte që kanë diskredituar rëndë figurën dhe sjelljen e tij. Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tillë që kalojnë «kufirin e të arsyeshmes», dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, duke çuar në cënimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.

86. Vonesa në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përbën shkelje disiplinore, kur përbën rast përsëritës, të rëndë, dhe të pajustifikuar. «Në çdo rast kufiri i të justifikueshmes do të konsiderohet i tejkualuar përsa kohë vonesa cenon të drejtë e palëve për të patur një proces që zhvillohet brenda afateve të arsyeshme sipas nenit 6 prg.1 të KDENJ»; Përsa i takon pretendimit për numrin e çështjeve dhe përmasave të vonesës në këto çështje, kufiri i të justifikueshmes do të konsiderohet i tejkualuar, në momen-tin që sjellja e gjyqtarit (pra faji i tij) ka të bëjë me paaftësinë e tij organizatore për të kryer në mënyrën e kërkuar, detyrën e gjyqtarit»(vendini nr.1768 datë 25.01.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit në Republikën e Italisë].

26. Në analizë të sa më sipër, Këshilli arrin në përfundimin se veprimet e gjyqtar_ L.H. gjatë ushtrimit të veprintarisë së _j gjyqësore, të konstatuara nga Ministri i Drejtëisë janë të tillë që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore. Këto shkelje vlerësohen si shkelje që parashikohen në nenin 32/4 të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, pasi përbëjnë «shkelje të lehta që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit». Për sa më

sipër, Këshilli pasi vlerësoi kërkesën e Ministrit të Drejtësisë përpara votimit, i cili në bazë të nenit 11 të Rregullores “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve” miratuar me Vendimin e KLD-së Nr.137, datë 21.02.2002, i ndryshuar, disponon me një masë tjetër disiplinore, ndaj gjyqtar_ L.H., atë të “Vërejtjes me paralajmërim”, në vend të “ulje e përkohshme për 1 deri në 2 vjet në detyrë në një gjykatëtë një niveli më të ulët” propozuar me shkresën nr. 42 prot, datë 08.01.2013, e rrëzoi atë kërkesë me shumicë votash.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë bazuar, në nenin 33, pikë 2/a të Ligjit Nr.9877, datë 18.02.2008 «Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë», në nenin 33 te Ligjit Nr.8811, datë 17.05.2001 «Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë» i ndryshuar si dhe në Rregulloren «Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve» miratuar me vendimin nr.137, datë 21.02.2003 i ndryshuar, duke qenë i mendimit se kërkesa e tjetër e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor dhe dhënien e masës disiplinore «Vërejtje» ndaj gjyqtar_ të Gjykatës së Apelit X, L.H., është e drejtë.

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masën disiplinore ndaj gjyqtar_ së Gjykatës së Apelit X, L.H..
2. Dhënien e masës disiplinore «Vërejtje» ndaj gjyqtares të Gjykatës së Apelit X L.H..
3. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet rregullisht gjyqtares.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga njoftimi i vendimit.

U shpall sot, më datë **28.05.2014**.

ZËVËNDËSKRYETARI

ELVIS ÇEFA



Vendim Nr. 65, datë 28.05.2014

**PËR DHËNIE TË MASËS DISIPLINORE
“VËREJTJE” NDAJ GJYQTAR_ K. A.**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë i mbledhur më datë 28.05.2014, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, nr.436, datë 31.01.2014 me dokumentacionin përkatës në procedimin disiplinor ndaj gjyqtar_ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, K.A. dhe marrjen ndaj saj të masës disiplinore “Vërejtje”, si dëgjoi pretendimet e gjyqtarit të proceduar,

VËRENSE:

I. Mbi rrethanat e çështjes

1. Ministri i Drejtësisë me shkresën nr.436 prot., datë 31.01.2014, ka depozitar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtar_ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, K. A.. Për fillimin e këtij procedimi është marrë shkas nga shkeljet që Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka konstatuar në veprimtarinë e saj gjyqësore, pasqyruar në shkresat drejtar Ministrisë së Drejtësisë dhe konkretisht: shkresa nr.1556/2 prot., datë 20.03.2013 (shkelje të pajustifikuar dhe të përsëritur të dispozitave urdheruese procedurale); shkresa nr.1710/1prot., datë 23.10.2013 (mosdorëzimin në afat të vendimeve gjyqësore, për zvarritje gjykimi).

2. Mbi bazën e këtyre shkeljeve dhe në mbështetje të nenit 31, pika 3 të Ligjit Nr.8811, datë 17.05.2001 «Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë», i ndryshuar, i ka propozuar fillimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë marrjen e masës disiplinore «Dërgimin për 1-2 vjet në një gjykatë të të njëjtë nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij», ndaj kësaj gjyqtareje. Më pas, vetë ministri i drejtësisë në seancë plenare, kërkoi ndryshimin e masës disiplinore të propozuar për gjyqtaren në fjalë nga «Dërgimin për 1-2 vjet në një gjykatë të të njëjtë nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij» në «vërejtje». Në kërkesën për procedim, argumentohet se _ gjyqtar_ ka shkelur nenin 32, të Ligjit Nr.9877, datë 18.02.2008, «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë».

3. Nga vlerësimi që i është bërë kërkesës së Ministrit të Drejtësisë, dokumentacionit shkresor të administruar, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Këshilli vlerëson se:

i) shqyrtimi i kërkesës së paraqitur në këtë procedurë, nga pikëpamja formale dhe ajo proceduriale është në kompetencën ligjore të KLD-së, në bazë të pikës «ç» të nenit 2 dhe neneve 31 e vijues të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 «Për organizimin

e Këshillit të Lartë të Drejtësisë».

ii) në referim të akteve shkresore, Ministri i Drejtësisë legjitimohet si nga pikë-pamja procedurale, ashtu edhe nga pikëpamja materiale, bazuar në pikën 3 dhe 4 të nenit 31 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 «Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë», si dhe në nenin 34 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë».

iii) kërkesa e depozituar në KLD nga Ministri i Drejtësisë, është brënda afatit të parashikuar në nenin 34 të ligjit nr.9877 datë 18.02.2008 «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë». Konkretisht nga data e kryerjes së shkeljes kanë kaluar më pak se 5 vjet dhe nga data e vënies në dijeni me shkeljen të Ministrit të Drejtësisë, në cilësinë e organit që ka të drejtën e nisjes së procedimit disiplinor, ka kaluar më pak se 1(një) vit.

4. Shqyrtimi i kërkesës për procedim ka qënë pjesë e rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit datë 28 maj 2014. Gjyqtar_ _është vënë në dijeni me shkresën nr.1845, datë 23.05.2014 (për seancën e mbledhjes së KLD).

5. Rregullorja «Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve» në nenin 5 të saj parashikon se: «Mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në të cilën do të shqyrtohet procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari duhet të caktohet jo më shpejt se dhjetë ditë nga data që gjyqtari i janë vënë në dispozicion materialet e plota të procedimit». Gjyqtar_ _ proceduar K. A., është njohur me kërkesën e Ministrit të Drejtësisë dhe me materialet e tjera të procedimit në adresë të _j, me shkresën nr.436/1 datë 05.02.2014 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, provohet se i janë vënë në dispozicion:

- i) Kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor;
- ii) Praktika e materialeve të procedimit dhe mendimi i gjyqtarit, depozituar në Ministrinë e Drejtësisë.

6. Gjithashtu në nenin 6 të Rregullores «Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve», parashikohet se: «Gjyqtari ndaj të cilët zhvillohet procedimi disiplinor duhet të njoftohet për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën 48 orë përra fillimit të saj», gjyqtar_ K. A., është njoftuar për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, brenda këtij afati, dhe konkretisht, me shkresën nr.1845, datë 23.05.2014, gjyqtar_ _është njoftuar për mbledhjen që do zhvillohej më datë 28.05.2014, në të cilën do të shqyrtohej kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj _j. Pra, më shumë se 48 orë para shqyrtimit të kërkesës është bërë njoftimi përmblledhjen e kësaj date.

7. Nga sa u parashtrua, rezulton se gjyqtar_ K. A. i janë garantuar të gjitha të drejtat procedurale të parashikuara nga ligji dhe nga rregullorja, duke u zhvilluar në këtë mënyrë një proces i rregullt ligjor nga ana procedurale.

8. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka përcjellë për kompetencë vlerësimi, mbi mundësinë e procedimit disiplinor, relacionet e verifikimeve të kryera për gjyqtar-



en e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, K.A., konkretisht:

a) Relacioni i parë dërguar nga Këshillit i Lartë i Drejtësisë në drejtim të Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr.1556/2 prot., datë 20.03.2013, është realizuar mbi bazën e konstatimeve të veprimitarës gjyqësore të gjyqtar_K.A., mbështetur në Urdhër Verifikimin e datës 29.10.2012 të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që parashikonte verifikimet lidhur me dorëzimin e vendimeve të arsyetuara, të përfunduara prej saj gjatë periudhës 01.02.2012 deri në datë 29.10.2012. Ky verifikim është kryer, duke marrë indicie nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, F.I. i cili ka parashtruar KLD-së, me shkresën nr.1556 prot, datë 04.10.2012 listën e dosjeve të pa dorëzuara nga gjyqtarët. Nga ky verifikim është konstatuar se:

i) gjyqtar_K.A. ka dorëzuar me vonesë 52 vendime civile. K_gjyqtar_gjykon në Dhomën Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, çështjet e seksionit familjar dhe për periudhën 01.02.2012 - 29.10.2012, ka dorëzuar tej afateve ligjore 51 vendime si dhe 1 vendim ishte ende i padorëzuar gjatë periudhës së verifikimit të kryer nga KLD-ja. Në të gjitha vendimet e shpallura nga gjyqtar_K.A., nuk është respektuar afati maksimal 10 ditor i parashikuar në nenin 308, paragrafi i dytë i K.Pr.Civile, për depozitimini e vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore. Në këtë dispozitë parashikohet se: "Në çështje të ndërlikuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se dhjetë ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në pesë ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai ia beson këtë njërit prej anëtarëve të trupit gjykues". Vonesat në dorëzimin e vendimit janë në diferenca kohore prej 14 ditë deri në rreth 8 muaj e 8 ditë kalendarike. Nga 52 vendime të arsyetuara jashtë afatit ligjor, kanë rezultuar se ndaj 3 prej këtyre vendimeve palët kanë ushtruar të drejtën e ankimit. Vendimet e padorëzuara nga k_gjyqtar_ndahan në këto kategori:

- 33 vendime pushim gjykimi dhe pér të cilat nuk ka patur ankrim nga palët në gjykatat më të larta (të dorëzuara me vonesë).

- 16 vendime përfundimtare me të cilat është zgjidhur çështja në themel (pranuar ose rrëzuar padia apo kërkesa), të cilat nuk janë ankimuar në gjykatat më të larta (të dorëzuara me vonesë).

- 2 vendime përfundimtare me të cilat është zgjidhur çështja në themel (pranuar apo rrëzuar padia apo kërkesa), të cilat janë ankimuar në gjykatat më të larta, konkretisht të dorëzuara me vonesë: (i) pas 2 muaj 22 ditësh dhe (ii) pas 2 muaj e 9 ditësh.

- 1 vendim përfundimtar në të cilin është zgjidhur çështja në themel (rrëzuar padia), i ankimuar në gjykatat më të larta çështje civile e cila deri në datën e inspektimit nga Inspektorati i KLD ishte ende e padorëzuar dhe në një vonesë prej 3

muaj e 20 ditë nga shpallja e j.

b) Relacioni i dytë i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në drejtim të Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr.1710/1 prot, datë 23.10.2013, është realizuar në bazë të Urdhrave të Verifikimit nr. 2595 prot., datë 20.09.2013 dhe nr. 2546 prot datë 17.09.2013 të Kryeinspektorit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë kryer verifikimet përkatëse për veprintarinë gjyqësore të gjyqtar_ K.A., lidhur me dorëzimin e vendimeve të arsyetuara. Verifikimet janë kryer, pasi Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, F.I. i ka parashtruar KLD-së, me shkresën nr.6871 prot, datë 03.06.2013 listën e dosjeve të pa dorëzuara nga gjyqtarët. Nga ky verifikim u konstatua se:

i) Gjyqtar_ K.A. ka dorëzuar me vonesë shtatë vendime civile, konkretisht: gjashtë prej tyre janë vendime përfundimtare, konkretisht vendimet nr.2198/2013; nr. 4325/2013; nr.4791/2013; nr. 4856/2013; nr. 5541/2013 dhe nr. 5727/2013, nga të cilat dy vendime janë ankimuar, ato me nr. 2198 dhe nr. 4325 dhe vendimet e tjera kanë marrë formë të prerë pa ankim, ndërsa një vendim është jo përfundimtar (nr. 3824/2013), i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Referuar afatit kohor, në të cilat rezultojnë të arsyetuara vendimet nga ana e gjyqtar_, është e qartë se ato janë dorëzuar në shkelje të nenit 308 të K.Pr.Civile. Konkretnisht, këto shtatëvendime janë dorëzuar për një afat kohor prej:

- 3 (tre) muaj dhe 21 (njëzetë e një) ditë, e ankimuar;
- 2 (dy) muaj dhe 3 (tre) ditë;
- 2 (dy) muaj dhe 5 (pesë) ditë, e ankimuar;
- 2 (dy) muaj dhe 14 (katërmbëdhjetë) ditë;
- 2 (dy) muaj dhe 26 (njëzetë e gjashtë) ditë;
- 1 (një) muaj dhe 26 (njëzetë e gjashtë) ditë;
- 2 (dy) muaj dhe 29 (njëzetë e nëntë) ditë.

9. Në përfundim të verifikimeve të kryera, është arritur në konkluzionin se, veprimeve e gjyqtar_ K.A. është realizuar në kundërshtim me ligjin dhe përbën shkelje disiplinore. Konkretisht, të gjithë këto veprime janë parashikuar si shkelje të rënda të disiplinës nga ligji Nr.9877, datë 18.02.2008, «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë», në nenin 32, pika 3, gjëma «a». Në shkronjën «a» të kësaj pike parashikohet se: «Janë shkelje të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë: a) zvarritja e pajustifikuar dhe përsëritur e veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit, kur zvarritja ka pasjellë ose mund të sillte pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënen e drejtësisë;».

10. Kundër kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor, gjyqtar_ K.A., në bazë të nenit 35 të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 «Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë», i janë ofruar të gjitha të drejtat



për një procedim disiplinor, dhe paraqiti para Këshillit pretendimet e j, të përmbledhura si më poshtë:

Pretendimi i pari lidhej me ngarkesën sasiore që ka ndikuar në vonesën e arsyetimit dhe të dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Vendimet e pushimit të gjykimit janë anashkaluar prej j, përfaktin se i është kushtuar më shumë vëmendje arsyetimit të vendimeve të themelit dhe shumica prej tyre janë vendime pushimi, për shkak të pajtimit të palëve, ndaj ato nuk sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve. Të gjitha këto sipas gjyqtar nuk të lënë hapësirën e nevojshme kohore që të respektohen afatet ligjore për zbardhjen në kohë të të gjitha vendimeve.

Pretendimi i dytë është që arsyet shëndetësore, të bashkëshort të gjyqtar kanë ndikuar në rendimentin e j të punës.

II. Vlerësimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

11. Këshilli i Lartë i Drejtësisë nga faktet e parashtruar konstaton se lidhur me çështjet e gjykuara dhe të dorëzuara me vonesë nga gjyqtar K.A., përbën shkelje të ligjit me pasojë cënimin e lirive dhe të drejtave themore të njeriut. Në këtë kontekst, neni 15, pika 2 e Kushtetutës parashikon «Organet e pushtetit publik, në përbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre». Ky parashikim kushtetues shihet i lidhur me detyrime të tjera që, akti themelor i shtetit i ngarkon në mënyrë të posaçme pushtetit gjyqësor. Konkrektisht, neni 43 i Kushtetutës, i njeh kujtdo të drejtën për tu ankuar kundër një vendimi gjyqësor, në një gjykatë më të lartë, të drejta këto të parealizuara për palët pjesëmarrëse në proceset e cituara më lart, të gjykuara prej tij.

12. Gjyqtar referuar relacionit të parë të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka mangësi në lidhje me dorëzimin me vonesë të 52 vendime civile vonesa të cilat prej periudhë kohore rrëth 14 ditë deri në rrëth 8 muaj e 8 ditë kalendarike, me pasoja për të drejtën kushtetuese të palëve në atë proces civil, për realizimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor. Nga 52 vendime të arsyetuara jashtë afatit ligjor, kanë rezultuar se ndaj 3 prej këtyre vendimeve palët kanë ushtruar të drejtën e ankimit. 2 vendime përfundimtare me të cilat është zgjidhur çështja në themel (pranuar apo rrëzuar padia apo kërkesa), të cilat janë ankimore më gjykatat më të larta, konkretisht të dorëzuara me vonesë: (i) pas 2 muaj 22 ditësh dhe (ii) pas 2 muaj e 9 ditësh. 1 vendim përfundimtar në të cilin është zgjidhur çështja në themel (rrëzuar padia), i ankimore më gjykatat më të larta deri në datën e inspektimit nga Inspektorati i KLD ishte ende e padorëzuar dhe në një vonesë prej 3 muaj e 20 ditë nga shpallja e j.

13. Gjyqtar referuar relacionit të dytë të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka mangësi në lidhje dorëzuar me vonesë shtatë vendime civile. Konkrektisht, këto shtatë vendime janë dorëzuar për një afat kohor prej: 3 (tre) muaj dhe

21 (njëzetë e një) ditë, e ankimuar; 2 (dy) muaj dhe 3 (tre) ditë; 2 (dy) muaj dhe 5 (pesë) ditë, e ankimuar; 2 (dy) muaj dhe 14 (katërmbëdhjetë) ditë; 2 (dy) muaj dhe 26 (njëzetë e gjashtë) ditë; 1 (një) muaj dhe 26 (njëzetë e gjashtë) ditë; 2 (dy) muaj dhe 29 (njëzetë e nëntë) ditë. Dorëzimi me vonesë i këtyre vendimeve krijon pasoja për të drejtën kushtetuese të palëve në atë proces civil, për realizimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor.

14. Këshilli konstaton se në total gjyqtar_ K.A. ka dorëzuar jashtë afatit ligjor 59 vendimeve gjyqësore civile, dorëzuar të arsyetuara në sekretari tej afatit 10 ditor të parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile. Kjo dispozitë urdhëron gjyqtarin e çështjes që të depozitojë vendimin e arsyetuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit dhjetë ditor nga shpallja e vendimit përfundimtar për konfliktin civil të zgjidhur prej tij. Lidhur me vendimet e pushimit të shpallur nga gjyqtar_ K.A. dhe të dorëzuara me vonesë rezulton se afati i dorëzimit është në shkelje edhe të nenit 301, të K.Pr. Civile, sipas të cilit: «Kundër vendimit me të cilin vendoset pezullimi, pushimi ose refuzimi i rifillimit të gjykimit, mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit, përvèç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj».

15. Shkeljet e konstatuara rezultojnë dhe dalin qartë në të gjitha aktet shkresore të marra në shqyrtim në këtë vendimmarrje të Këshillit, siç janë relacionet e inspektorëve të IKLD dhe shkresat përkatëse, procesverbalet e verifikimit të kryera prej tyre apo dhe vetë kërkesa e Ministrit drejtuar KLD.

16. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, thënë dhe më sipër, në nenin 43 ka njojur të drejtën e ankimit të një vendimi gjyqësor në një gjykatë të shkallës më të lartë. Nga vonesat e dorëzimit të vendimeve, provohet se pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve kanë ardhur për 5 vendimet e shpallura nga k_ gjyqtar_, ndaj të cilave palët kanë ushtruar të drejtën e ankimit, konkretisht: (i) ndaj tre vendimeve nr. 7151/2012 dhe vendimeve të pasqyruar me nr. 40 dhe nr. 41 në verifikimin e parë, si dhe (ii) ndaj dy vendimeve nr. 4325/2013 dhe nr. 2198/2013, të pasqyruar në verifikimin e dytë.

17. KLD vlerëson se respektimi i dispozitave procedurale të cilat lidhen me dorëzimin e vendimeve brenda një afati te arsyeshëm, në mënyrë që të mos cënohen të drejtat kushtetuese të palëve në proces dhe të mos pengohet dhënia e drejtësisë, është e lidhur drejtpërsëdrejti me respektimin e parimit të zhvillimit dhe përfundimit të një procesi brenda një afati të arsyeshëm. Me afat të arsyeshëm ligjor kuptohet jo vetëm koha që merr shqyrtimi i çështjes deri në shpalljen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës, por edhe koha që i nevojitet gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar. Gjithashtu, Këshilli është i vetëdijshëm se respektimi i afatit të arsyeshëm ligjor varet nga shumë faktorë të procesit të gjykimit të cilët janë të lidhur dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e këtij procesi, siç mund të jenë: sjelljet e palëve në proces, kompleksiteti i çështjes, përkushtimi dhe

aftësia e gjykatës dhe administratës gjyqësore përfundimin në kohë të procesit dhe ushtrimin e detyrës në përputhje me ligjin, etj.

18. Me veprimet e j gjyqtar K.A. ka kryer shkelje të disiplinës së gjyqtarit, për të cilat ajo duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore në raport të drejtë me shkeljen e kryer, siç urdhëron edhe nen 33 pika 1 e ligjit nr. 9877/2008 «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh».

19. Këshilli vlerëson se me veprimet e j gjyqtar K.A. ka kryer shkelje të disiplinës së gjyqtarit. Numri i shkeljeve të kryera nga gjyqtarja dhe natyra e tyre janë në atë masë që të përligjin kërkosën e Ministrit për masën disiplinore «vërejtje», duke marrë këtu në konsideratë volumin e punës të përballuar prej saj, si dhe gjendjen shëndetësore të bashkëshort, gjendje e cila mund të përkeqëohet më tej. Në këtë kontekst, Këshilli, konstaton se veprimet e kryera prej j nuk përbëjnë shkelje shumë të rëndë të disiplinës, sipas koncepteve të përdorura në nenin 32 dhe të Ligjit 9877, datë 18.02.2008. Këto vlerësimë të Këshillit janë në përputhje edhe me konkluzionet e Kolegjeve të Bashkuar të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.5 datë 12.12.2013 (N.T. kundër KLD).

20. Këshilli vlerëson se shkeljet konkrete kanë diskredituar gjithësesi figurën dhe pozitën e gjyqtarit konform nenit 32 pika 4 shkronja ç) të ligjit nr. 9877/2008 «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh». Këto vlerësimë të Këshillit janë në përputhje edhe me konkluzionet e Kolegjeve të Bashkuar të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.5 datë 12.12.2013 (N.T. kundër KLD), në një çështje të ngashme, ku theksohet se:

«85. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vazhdim të analizës së mësipërme, vlerësojnë të theksojnë dhe njëherë se jo në çdo rast mosrespektimi i afateve procedurale të përmendura më lart e çon gjyqtarin përpëra procedimit disiplinor. Jo në çdo rast shkeljet që konstatohen në veprimtarinë e gjyqtarit dhe në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e tij për të dorëzuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e arsyetuara do të konsiderohen si shkelje që kanë çuar ne humbjen e besimit dhe kredibilitetit ndaj gjyqtarit apo akte që kanë diskredituar rëndë figurën dhe sjelljen e tij. Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tilla që kalojnë «kufirin e të arsyeshmes», dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, duke çuar në cënimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij. 86. Vonesa në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përbën shkelje disiplinore, kur përbën rast përsëritës, të rëndë, dhe të pajustifikuar. «Në çdo rast kufiri i të justifikueshmes do të konsiderohet i tejkaluar përsa kohë vonesa cenon të drejtën e palëve për të patur një proces që zhvillohet brenda afateve të arsyeshme sipas nenit 6 prg.1 të KDENJ»; Përsa i takon pretendimit për numrin e çështjeve dhe përmasave të vonesës në këto çështje, kufiri i të justifikueshmes do të konsiderohet

i tejkaluar, në momentin që sjellja e gjyqtarit (pra faji i tij) ka të bëjë me paaftësinë e tij organizatore për të kryer në mënyrën e kërkuar, detyrën e gjyqtarit»(vendini nr.1768 datë 25.01.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit në Republikën e Italisë].

21. Në analizë të sa më sipër, Këshilli arrin në përfundimin se veprimet e gjyqtar_ K.A. gjatë ushtrimit të veprimtarisë së _j gjyqësore, të konstatuara nga Ministri i Drejtëisë janë të tillë që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore. Këto shkelje vlerësohen si shkelje që parashikohen në nenin 32/4 të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, pasi përbëjnë «shkelje të lehta që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit». Për sa më sipër, Këshilli pasi vlerësoi kërkasen e Ministrit të Drejtëisë përpara votimit, i cili në bazë të nenit 11 të Rregullores “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve” miratuar me Vendimin e KLD-së Nr.137, datë 21.02.2002, i ndryshuar, disponon me një masë tjetër disiplinore, ndaj gjyqtar_ K.A., atë të “Vërejtjes”, në vend të “Dërgimin për 1-2 vjet në një gjykatë të të njëjtë nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij” propozuar me shkresën nr.436 prot., datë 31.01.2014, kërkasë e cila konsiderohet e drejtë,

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë bazuar, në nenin 33, pika 2/a të Ligjit Nr.9877, datë 18.02.2008 «Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë», në nenin 33, te Ligjet Nr.8811, datë 17.05.2001 «Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë» i ndryshuar si dhe në Rregulloren «Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve» miratuar me vendimin nr.137, datë 21.02.2003 i ndryshuar, duke qenë i mendimit se kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor dhe dhënien e masës disiplinore «Vërejtje» ndaj gjyqtar_ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, K.A., është e drejtë.

V E N D O S I

1. Pranimin e kërkasës së Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore ndaj gjyqtar_ së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, K.A..
2. Dhënien e masës disiplinore «Vërejtje» ndaj gjyqtar_ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, K.A..
3. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet rregullisht gjyqtar_.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga njoftimi i vendimit.

U shpall sot, më datë 28.05.2014.

ZËVËNDËSKRYETARI

ELVIS ÇEFA



Vendim Nr. 104, datë 21.07.2014

**PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE
“VËREJTJE ME PARALAJMËRIM” NDAJ GJYQTARIT I.P.**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjen e dates 21.07.2014, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, I.P. dhe marrjen ndaj tij të masës disiplinore “Dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtë nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij”, në përpushje me nenin 31 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” të ndryshuar, si dëgjoi pretendimet e gjyqtarit të proceduar, që kerkoi rrëzimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë,

VËREN S E:

I.Mbi irrethanat e çështjes

1. Ministri i Drejtësisë me shkresën nr.1105 prot., datë 12.02.2014, i ka dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkesën për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, I.P.. Për fillimin e këtij procedimi është marrë shkas nga shkeljet që Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka konstatuar në veprimtarinë e tij gjyqësore, pasqyruar në shkresën drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe konkretisht me shkresën nr.1628/1 datë 20.03.2013. Nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë kryer verifikimet përkatëse, mbështetur në urdhrin e verifikimit datë 29.10.2012 të Kryeinspektores së K.L.D.-së “Për verifikimin e informacionit të paraqitur nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, për gjyqtarin I.P., për mosrespektim formal të ligjt.

2. Ministri i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 31, pika 3 të Ligjit Nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë marrjen e masës disiplinore “Dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtë nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij” ndaj gjyqtarit I. P.. Në kërkesën për procedim, bazuar në Ligjin Nr.9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nen 32, argumentohet se ky gjyqtar ka kryer shkelje të rënda të parashikuara në pikën 2, të kësaj dispozite.

3.Nga vlerësimi që i është bërë kërkesës së Ministrit të Drejtësisë, dokumentacionit shkresor të administruar, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Këshilli vlerëson se:

i)shqyrtimi i kërkesës së paraqitur në këtë procedurë, nga pikëpamja formale dhe ajo proceduriale është në kompetencën ligjore të KLD-së, në bazë të pikës “ç” të nenit

2 dhe neneve 31 e vijues të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

ii)në referim të akteve shkresore, Ministri i Drejtësisë legitimohet si nga pikëpamja procedurale, ashtu edhe nga pikëpamja materiale, bazuar në pikën 3 dhe 4 të nenit 31 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, si dhe në nenin 34 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

iii)kërkesa e depozituar në KLD nga Ministri i Drejtësisë, është brënda afatit të parashikuar në nenin 34 të ligjit nr.9877 datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Konkretisht nga data e kryerjes së shkeljes kanë kaluar më pak se 5 vjet dhe nga data e vëndosur në dijeni me shkeljen të Ministrit të Drejtësisë, në cilësinë e organit që ka të drejtën e nisjes së procedimit disiplinor, ka kaluar më pak se 1(një) vit.

4.Shqyrtimi i kërkesës për procedim ka qënë pjesë e rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit në datat 30.06.2014; 07.07.2014; 11.07.2014; 16.07.2014 dhe 21.07.2014. Gjyqtari është vënë në dijeni për të gjitha datat e mbledhjeve të KLD).

5.Në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”, i ndryshuar, dhe në nenit 31 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, gjyqtari I. P. është njoftuar për shkeljet e konstatuara në relacionin e KLD-së, duke i vënë në dukje edhe të drejtën e paraqitjes së pretendimeve dhe provave mbi to.

6.Rregullorja “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve” në nenin 5 të saj parashikon se: “Mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në të cilën do të shqyrtohet procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari duhet të caktohet jo më shpejt se dhjetë ditë nga data që gjyqtarit i janë vënë në dispozicion materialet e plota të procedimit”. Gjyqtari i proceduar I.P. është njohur me kërkesën e Ministrit të Drejtësisë dhe me materialet e tjera të procedimit në adresë të tij, me shkresën nr. 506/1 date 07.02.2014, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, provohet se i janë vënë në dispozicion:

- i)Kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor;
- ii)Praktika e materialeve të procedimit dhe mendimi i gjyqtarit, depozituar në Ministrinë e Drejtësisë.

7.Gjithashtu në nenin 6 po të Rregullores “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve”, parashikohet se: “Gjyqtari ndaj të cilët zhvillohet procedimi disiplinor duhet të njoftohet për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën dyzetë orë përpëra fillimit të saj”, gjyqtari I.P., është njoftuar për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, brenda këtij afati, dhe konkretisht,

i)Për mbledhjen e datës 30.06.2014 është njoftuar me shkresën nr.2191 prot., datë 25.06.2014; Në këtë mbledhje nuk u paraqit gjyqtari duke sjellë raport mjekësor pranë KLD për pamundësi paraqitje për shkak të shëndetit të tij.



ii)Për mbledhjen e datës 07.07.2014 është njoftuar me shkresën nr.2283 prot., datë 03.07.2014; Në këtë mbledhje nuk u paraqit gjyqtari duke sjellë raport mjekësor pranë KLD për pamundësi paraqitje për shkak të shëndetit të tij.

iii)Për mbledhjen e datës 11.07.2014 është njoftuar me shkresën nr.2366 prot., datë 08.07.2014; Mungesa e Ministrit të Drejtësisë bëri që shqyrtimi i procedimeve disiplinore të shtyhej.

iv)Për mbledhjen e datës 16.07.2014 me shkresën nr. 2450 prot., datë 11.07.2014;

v)Në këtë mbledhje nuk u paraqit gjyqtari duke sjellë raport mjekësor pranë KLD për pamundësi paraqitje për shkak të shëndetit të tij, si dhe kërkon që caktimin e një datë tjetër, në të cilën ai garantonte paraqitjen personale të tij.

vi)Për mbledhjen e datës 21.07.2014 me shkresën nr. 2520 prot., datë 17.07.2014;

Gjyqtari është njoftuar për mbledhjen që do zhvillohej më datë 21.07.2014, në të cilën do të shqyrtohej kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj tij. Pra, më shumë se 48 orë para shqyrimit të kërkesës është bërë njoftimi për mbledhjen e kësaj date.

8.Nga sa u parashtrua, rezulton se gjyqtarit I.P. i janë garantuar të gjitha të drejtat procedurale të parashikuara nga ligji dhe nga rregullorja, duke u zhvilluar në këtë mënyrë një proces i rregullt ligjor nga ana procedurale.

9.Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dëgjoi parashtrimet e Ministrit të Drejtësisë i cili në kërkesën për procedim, të bazuar në Ligjin Nr.9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 32, argumentohet se kjo gjyqtar ka kryer shkelje të rëndë të disiplinës në punë, të parashikuara në pikën 3, të kësaj dispozite, si më poshtë:

9.1 Gjyqtari I.P., ndër të tjera ka gjykuar 18 çështje me problematikë në afatin e dorëzimit të vendimeve të arsyetuara, nga të cilat 10 dosje janë dorëzuar me vonesë, ndërsa 8 dosje nuk janë dorëzuar, deri ditën e verifikimit nga ana e KLD-së. Në veprimtarinë e gjyqtarit I.P. provohet të ketë shkelje të ligjit, që përbëjnë shkelje të disiplinës, në kuptim të nenit 32 të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

9.2 Nga analiza e të dhënave të grumbulluara ka rezultuar se, gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, I.P., ka shpallur dhe ka depozituar me vonesë në sekretarinë gjyqësore 10 dosje, nga të cilat 9 civile dhe 1 kërkesë penale, me një afat kohor, nga 2 muaj e 28 ditëderinë 8 muaj e 7 ditë, konkretisht:

9.2.1Çështja civile që i përket palëve ndërgjyqëse: Paditës: Zyra Maloku, etj; i Paditur Hysni Sherli; Objekti: Lirim dhe dorëzim sendi, etj., gjyqtari është shprehur me vendimin nr.296 datë 06.02.2012, por fashikulli (e bashkë me të vendimi i arsyetuar) është depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 23.10.2012 (pra, 8 muaj e 7 ditë jashtë afatit ligjor).

9.2.2Çështja civile që i përket palëve ndërgjyqëse: Paditës: Agim Duka; i Paditur:

Bashkia Gramsh; Objekti: Detyrimin e të paditurit të paguajë 1 vit pagë, etj., gjyqtari eshtë shprehur me vendimin nr.909 datë 11.04.2012, por fashikulli (e bashkë me të vendimi i arsyetuar) eshtë depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 23.10.2012 (pra, 6 muaj e 2 ditë jashtë afatit ligjor).

9.2.3 Çështja civile që i përket palëve ndërgjyqëse: Paditëse: Djana Pole; i Paditur: Bashkia Gramsh; Objekti: Detyrimin e të paditurit të paguajë 1 vit pagë, etj., gjyqtari eshtë shprehur me vendimin nr.910 datë 11.04.2012, por fashikulli (e bashkë me të vendimi i arsyetuar) eshtë depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 23.10.2012 (pra, 6 muaj e 2 ditë jashtë afatit ligjor).

9.2.4 Çështja civile që i përket palëve ndërgjyqëse: Paditës: Aleksandër Kumrija; i Paditur: Bashkia Gramsh; Objekti: Detyrimin e të paditurit të paguajë 1 vit pagë, etj., gjyqtari eshtë shprehur me vendimin nr.921 datë 11.04.2012, por fashikulli (e bashkë me të vendimi i arsyetuar) eshtë depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 23.10.2012 (pra, 6 muaj e 2 ditë jashtë afatit ligjor).

9.2.5 Çështja civile që i përket palëve ndërgjyqëse: Paditës: Ramazan Bardhi; i Paditur: Sinan Samurri; Objekti: Lirim dhe dorëzim sipërfaqe toke, etj., gjyqtari eshtë shprehur me vendimin nr.1391 datë 28.05.2012, por fashikulli (e bashkë me të vendimi i arsyetuar) eshtë depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 22.10.2012 (pra, 4 muaj e 14 ditë jashtë afatit ligjor).

9.2.6 Çështja civile që i përket palëve ndërgjyqëse: Paditës: Drejtoria e Shërbimit Pyjor X; i Paditur: Qerim Topi; Objekti: Shpërblim dëmi, etj., gjyqtari eshtë shprehur me vendimin nr.1389 datë 28.05.2012, por fashikulli (e bashkë me të vendimi i arsyetuar) eshtë depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 23.10.2012 (pra, 4 muaj e 14 ditë jashtë afatit ligjor).

9.2.7 Çështja civile që i përket palëve ndërgjyqëse: Paditës: Prefekti i Qarkut X; i Paditur: Ramazan Kabashi, etj; Objekti: Deklarim pavlefshmërisë ligjore të aktit, etj., gjyqtari eshtë shprehur me vendimin nr.1423 datë 30.05.2012, por fashikulli (e bashkë me të vendimi i arsyetuar) eshtë depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 02.10.2012 (pra, 3 muaj e 22 ditë jashtë afatit ligjor).

9.2.8 Çështja civile që i përket palëve ndërgjyqëse: Paditëse: Enkeleida Xhika; i Paditur: Bardhyl Tafani; Objekti: Pavlefshmëri testamenti, etj., gjyqtari eshtë shprehur me vendimin nr.1807 datë 09.07.2012, por fashikulli (e bashkë me të vendimi i arsyetuar) eshtë depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 23.10.2012 (pra, 3 muaj e 3 ditë jashtë afatit ligjor).

9.2.9 Çështja civile që i përket palëve ndërgjyqëse: Paditës: Sami Bezati; i Paditur: Zyra Arsimore Gramsh; Objekti: Detyrimin e të paditurit të paguajë 1 vit pagë, etj., gjyqtari eshtë shprehur me vendimin nr.1914 datë 17.07.2012, por fashikulli (e bashkë me të vendimi i arsyetuar) eshtë depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 26.10.2012 (pra, 2 muaj e 28 ditë jashtë afatit ligjor).



9.2.10 Çështja penale që i përket palëve ndërgjyqëse: Ankuese: Hanife Ibaj; Kundër: Prokurorisë së Rrethit X; Persona të Interesuar: Kujtim Met'hasa e Skënder Sina; Objekti: Kundërshtim të vendimit të prokurorit, etj., gjyqtari është shprehur me vendimin nr.814 datë 23.05.2012, por fashikulli (e bashkë me të vendimi i arsyetuar) është depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 22.10.2012 (pra, 4 muaj e 21 ditë jashtë afatit ligjor).

9.3 Gjithashtu nga analiza e të dhënave të grumbulluara ka rezultuar se, gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, I.P., ka shpallur dhe nuk ka depozituar në sekretarinë gjyqësore deri ditën e verifikimit datë 31.10.2012, 9 dosje civile, me një afat kohor, nga 1 muaj e 15 ditëderinë 8 muaj e 14 ditë. Gjyqtari I.P., nuk ka arsyetuar e për rrjet-hojë nuk ka depozituar në sekretarinë gjyqësore (deri në momentin e verifikimit datë 31.10.2012), 8 vendimet për çështjet e mëposhtme:

9.3.1 Çështja civile me numër vendimi 317, datë 07.02.2012; Objekti: Kërkim page. Vendimi i shpallur për këtë konflikt civil nuk është depozituar në sekretarinë gjyqësore (deri në ditën e verifikimit kanë kaluar 8 muaj e 14 ditë).

9.3.2 Çështja civile me numër vendimi 741, datë 26.03.2012; Objekti: Kërkim page. Vendimi i shpallur për këtë konflikt civil nuk është depozituar në sekretarinë gjyqësore (deri në ditën e verifikimit kanë kaluar 6 muaj e 25 ditë).

9.3.3 Çështja civile me numër vendimi 1312, datë 21.05.2012; Objekti; Kërkim page. Vendimi i shpallur për këtë konflikt civil nuk është depozituar në sekretarinë gjyqësore (deri në ditën e verifikimit kanë kaluar 5 muaj).

9.3.4 Çështja civile me numër vendimi 1418, datë 29.05.2012; Objekti: Shpërblim dëmi. Vendimi i shpallur për këtë konflikt civil nuk është depozituar në sekretarinë gjyqësore (deri në ditën e verifikimit kanë kaluar 4 muaj e 23 ditë).

9.3.5 Çështja civile me numër vendimi 1463, datë 04.06.2012; Objekti: Shpërblim dëmi. Vendimi i shpallur për këtë konflikt civil nuk është depozituar në sekretarinë gjyqësore (deri në ditën e verifikimit kanë kaluar 4 muaj e 17 ditë).

9.3.6 Çështja civile me numër vendimi 1641, datë 21.06.2012; Objekti: Kërkim page. Vendimi i shpallur për këtë konflikt civil nuk është depozituar në sekretarinë gjyqësore (deri në ditën e verifikimit kanë kaluar 4 muaj).

9.3.7 Çështja civile me numër vendimi 1765, datë 04.07.2012; Objekti Kërkim page. Vendimi i shpallur për këtë konflikt civil nuk është depozituar në sekretarinë gjyqësore (deri në ditën e verifikimit kanë kaluar 3 muaj e 17 ditë).

9.3.8 Çështja civile me numër vendimi 2062, datë 06.09.2012; Objekti: Kërkim page. Vendimi i shpallur për këtë konflikt civil nuk është depozituar në sekretarinë gjyqësore (deri në ditën e verifikimit kanë kaluar 1 muaj e 15 ditë).

10. Me veprimet e tij, gjyqtari I.P., ka shkelur:

i)parashikimet e nenit 308/2 të K.Pr.Civile. Kjo dispozitë urdhëron gjyqtarin e çështjes që të depozitojë vendimin e arsyetuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit

dhjetë ditor nga shpallja e vendimit përfundimtar për konfliktin civil të zgjidhur prej tij. Mosdorëzimi i vendimeve gjyqësore brenda këtij afati është bërë në mënyrë të pajustifikuar dhe të përsëritur, në 17 raste.

ii)dispozitën urdhëruese të nenit 386 të K.Pr.Penale, në një rast, duke mos respektuar afatin e parashikuar në të, sipas të cilët, vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes.

iii)rregullimin ligjor, atë të nenit 113 të K.Pr.Penale, në të cilin parashikohet se: "Origjinalët e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre. Për aktet e ankueshme njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim".

11.Pra, veprimet e kryera nga gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, I.P., janë shkelje të rënda të disiplinës të parashikuara nga neni 32, pika 3, shkronja "a" të Ligjit Nr. 9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Gjyqtari I.P., ka gjykuar 18 çështje me problematikë në afatin e dorëzimit të vendimeve të arsyetuara, nga të cilat 17 civile dhe 1 kërkësë penale. Konkreksisht 10 dosje (9 civile dhe 1 kërkësë penale) janë dorëzuar me vonësë në sekretarinë gjyqësore, ndërsa 8 vendime civile, megjithëse rezultonin të shpallura, nuk figuronin të dorëzuara në sekretari deri ditën e verifikimit nga ana e KLD.

12.Për sa më sipër Ministri i Drejtësisë, në materialin e paraqitur me shkrim, konkludon se shkeljet e gjyqtarit I.P., parashikohen nga neni 32, pika 3, germa "a" të ligjit 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si raste të përgjegjësisë disiplinore në kategorinë e shkeljeve të rënda dhe i propozon Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në shkresën nr. shkresën nr.1105 prot.,datë 12.02.2014, drejtuar Këshillit, procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, I.P., dhe marrjen e masës disiplinore "Dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtë nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij".

13.Në referim të Vendimit nr.137, datë 21.02.2003 Rregullore "Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve" i ndryshuar, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë gjatë shqyrimit të këtij procedimi në seancën plenare të datës 21.07.2014, disponoi me propozimin e një mase tjeter disiplinore ndaj gjyqtarit, të ndryshme nga ajo e propozuar fillimisht, dhe konkretisht "Vërejtje me paralajmërim".

II.Vlerësime të Këshillit

14.Këshilli duke konstatuar se në disa mbledhje radhazi, në të cilat ishte parashikuar për të shqyrtaur procedimi disiplinor ndaj gjyqtarit, ky i fundit nuk ka qenë prezent dhe ka paraqitur raport mjekësor, për pamundësi paraqitje për shkak të shëndetit të tij, thekson si esencial faktin se gjyqtari, edhe në rastet kur ndaj tij është ndërmarrë një procedim disiplinor duhet të shëndetit të tij.

që mund të dëmtojë ose të hedhë dyshime mbi sjelljen e tij.

15.Këshilli i Lartë i Drejtësisë nga faktet e parashtruara konstaton se lidhur me çështjet e gjykuara dhe të padorëzuara apo dorëzuara me vonesë nga gjyqtari I.P., përbën shkelje të rëndë të ligjt me pasojë cënimin e lirive dhe të drejtave themore të njeriut. Në këtë kontekst, nen 15, pika 2 e Kushtetutës parashikon “Organet e push-tetit publik, në përm bushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe lir- itë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”. Ky parashikim kushtetues shihet i lidhur me detyrime të tjera që, akti themelor i shtetit i ngarkon në mënyrë të posaçme pushtetit gjyqësor. Edhe në nenin 42, pika 2 të Kushtetutës cito- het: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë..., ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

16.Gjatë veprimitarës gjyqësore në mënyrë të përsëritur, gjyqtari i Gjykatës së Rre- thit Gjyqësor X, I.P., ka shkelur disa dispozita të detyrueshme për zbatim të legjisla- cionit procedural në fuqi në Republikën e Shqipërisë:

i)Kodin e Procedurës Civile, nenin 1, ku parashikon se rregullat e tij janë të detyrueshme për t'u zbatuar. Neni 4 i këtij kodi, i vë detyrë gjyqtarit të realizojë një proces të rregullt ligjor, duke marrë masat e nevojshme për zhvillimin e tij, deri në finalizimin, me arsyetimin e vendimit dhe dorëzimin e tij sipas afateve ligjore, “Gjyka- ta kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos përafatet dhe urdhëron marrjen e ma- save të nevojshme”.

ii)Me veprimet e tij, gjyqtari I.P., ka shkelur edhe parashikimit e bëra në nenin 308 të K.Pr.Civile. Kjo dispozitë urdhëron gjyqtarin e çështjes që të depozitojë vendimin e arsyetuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit dhjetë ditor nga shpallja e vendimit përfundimtar për konfliktin civil të zgjidhur prej tij. Mosdorëzimi i vendimeve gjyqë- sore brenda këtij afati është bërë në mënyrë të pajustifikuar.

iii)Konstatohen shkelje edhe të dispozitave procedurale penale konkretisht nen 2 i K.Pr.Penale, përcakton detyrueshmërinë e zbatimit të rregullave të parashikuara në të, nga organet shtetërore, ku natyrisht një rol të rëndësishëm luan gjykata. Duke mos arsyetuar vendimet për masat e sigurimit personal dhe kërkkesat administrative penale, gjyqtari ka shkelur disponimet urdhëruese të nenit 386 të K.Pr.Penale duke mos respektuar afatin e parashikuar në të, për depozimin e vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore. Njëkohësisht ai ka shkelur nenin 113 të K.Pr.Penale, duke mos depozituar fashikullin në Sekretarinë Gjyqësore brenda afatit 5 ditor: «Origjinalitet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brënda pesë ditëve nga bërrja e tyre. Për ak- tet e ankuashme njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankım». Referuar këtij parashikimi të fundit ligjor, konsiderohet si afat përfundimtar brënda të cilit, gjyqtari duhet të depozitojë vendimin e arsyetuar në sekretari bashkë

me dosjen përkatëse, afati pesë ditor nga data e shpalljes. Në asnjë dispozitë tjetër të K.Pr.Penale nuk ekziston ndonjë përjashtim nga ky rregull, pra nga ky afat.

17. Shkaku kryesor për masën disiplinore është kryesisht mosrespektimi nga ana e gjyqtarit të dispozitave procedurale në gjykimin e çështjeve dhe konkretisht “moskryerja në kohë dhe në mënyrë të përsëritur të detyrës nga ana e gjyqtarit, lidhur me arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përfundimtare”. Këto veprime të tij janë kryer në mënyrë të përsëritur dhe të pajustifikuar duke sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim si dhe për dhëni e drejtësisë. Sa më sipër këto shkelje disiplinore janë konsideruar nga ligjvënësi si akte dhe sjellje që diskretojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, në kuptim të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008.

18. Shkeljet e konstatuara rezultojnë dhe dalin qartë në të gjitha aktet shkresore të marra në shqyrtim në këtë vendimmarrje të Këshillit, siç është relacioni i inspektorëve të IKLD dhe shkresat përkatëse, procesverbalet e verifikimit të kryera prej tyre apo dhe vetë kërkesa e Ministrit drejtar KLD.

19. Shkeljet e konstatuara ku gjyqtari I.P., ka gjykuar 18 çështje me problematikë në afatin e dorëzimit të vendimeve të arsyetuara, nga të cilat 17 civile dhe 1 kërkesë penale, konkretisht 10 dosje (9 civile dhe 1 kërkesë penale) janë dorëzuar me vonesë në sekretarinë gjyqësore, ndërsa 8 vendime civile, megjithëse rezultonin të shpallura, nuk figuretonin të dorëzuara në sekretari deri ditën e verifikimit nga ana e KLD, kanë konsistuar në mosrespektimin në mënyrë të vazhdueshme, të përsëritur dhe të pajustifikuar të dispozitave procedurale (civile dhe penale), duke sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim si dhe për dhëni e drejtësisë. Këto shkelje kanë diskredituar rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit.

20. KLD vlerëson se respektimi i dispozitave procedurale të cilat lidhen me dorëzimin e vendimeve brenda një afati te arsyeshëm, në mënyrë që të mos cënohen të drejtat kushtetuese të palëve në proces dhe të mos pengohet dhënia e drejtësisë, është e lidhur drejtpërsëdrejti me respektimin e parimit të zhvillimit dhe përfundimit të një procesi brenda një afati të arsyeshëm. Me afat të arsyeshëm ligjor kuptohet jo vetëm koha që merr shqyrtimi i çështjes deri në shpalljen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës, por edhe koha që i nevojitet gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar. Gjithashtu, Këshilli është i vetëdijshme se respektimi i afatit të arsyeshëm ligjor varet nga shumë faktorë të procesit të gjykit të cilët janë të lidhur dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e këtij procesi, siç mund të jenë: sjelljet e palëve në proces, kompleksiteti i çështjes, përkushtimi dhe aftësia e gjykatës dhe administratës gjyqësore për përfundimin në kohë të procesit dhe ushtrimin e detyrës në përpunhje me ligjin, etj. Afati i arsyeshëm që merret në konsideratë për zhvillimin e një procesi të irregullt ligjor fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi merr formë të prerë. (Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut neni 6 “1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka



të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht,...”.

21.Këshilli thekson se afatet brenda të cilit duhet të dorëzohen vendimet e arsyetuara janë përcaktuar në dispozitat procedurale si nen 308 i K.Pr.Civile, neni 113, 386 i K.Pr.Penale dhe se nuk është konstatuar se nga gjyqtari është marrë ndonjë masë për të eliminuar çdo lloj shkaku objektiv, nëse ka ekzistuar, që ato të dorëzohen brenda një afati të arsyeshëm në mënyrë që në çdo rast, dorëzimi i vendimeve të mos marrë më shumë kohë se sa ka marrë vetë procesi gjyqësor, apo ato të mbahen pafundësisht të bllokuara dhe të padorëzuara. Eficencia në drejtësi është një kriter i rëndësishëm për zhvillimin dhe konsolidimin e një procesi të rregullt ligjor si dhe për rivendosjen e të drejtave të palëve të pretenduara të shkelura. Prandaj këto vonesa ndikojnë dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë tek palët në proces pasi u cënohen këtyre të fundit të drejtat e tyre kushtetuese dhe përfundimisht procesi gjyqësor degradon në një proces joefektiv.

22.Në sjelljen e gjyqtarit I.P., KLD konstatohet një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tillë që kalojnë “kufirin e të arsyeshmes”, dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, sjellje e cila çon në cënimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.

23.Nisur nga analiza e mësipërme, vlerësohet se vonesat e gjyqtarit në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore konsiderohen si shkelje disiplinore në kuptim të kuptim të nenit 32/1/b si dhe nenit 32/3/a të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 dhe e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore pasi:

- i)këto vonesa janë të vazhdueshme, të përsëritura dhe të pajustifikuara;
- ii)këto vonesa kanë sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënier e drejtësisë;
- iii)këto vonesa janë jashtë çdo afati të arsyeshëm logjik dhe objektiv;
- iv)këto vonesa kanë cënuar imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut të drejtësia

24.Këshilli i Lartë i Drejtësisë konkludon se:

i)shkeljet e konstataura në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit I.P. vlerësohen se kanë shkaktuar shqetësim në një masë të madhe të njerëzve të interesuar, duke dëmtuar besimin e publikut tek dhënia e administrimi i drejtësisë, duke ulur imazhin e sisteminit gjyqësor, duke prekur interesat e një mase të madhe njerëzish (vendime të zbardhura me vonesë përtëj afateve të parashikuara në ligj, por edhe përtëj afateve të arsyeshme. Këto kanë shkaktuar dëme për palët, kanë cënuar të drejtat e tyre kushtetuese).

ii)Sjellja e gjyqtarit ka diskredituar rëndë pozitën dhe figurën e tij, dhe ka treguar paaftësinë e tij për të përballuar punën e tij të përditshme.

25.Këto veprime të gjyqtarit I.P., përbëjnë shkelje disiplinore dhe parashikohen në

kuptim të nenit 32 të Ligjit Nr.9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Në faktet që i atribuohen gjyqtarit I.P. plotësohen të gjitha kushtet e këtij parashikimi ligjor:

- i.shkelja e pajustifikuar të dispozitave urdhëruuese procedurale;
- ii.shkelja e përsëritur të dispozitave urdhëruuese procedurale dhe;
- iii.ardhja ose mundësia e ardhjes së pasojave për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë.

Në këto kushte, propozimi i Ministrit të Drejtësisë për masën disiplinore "Vërejtje më paralajmërim" është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, në Ligjin Nr.9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Vendimin nr.137, datë 21.02.2003 Rregullore "Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve" i ndryshuar, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

VENDOSI:

- 1.Pranimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, I.P..
- 2.Dhënien e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim" ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, I.P..
- 3.Një kopje e këtij vendimi i komunikohet rregullisht gjyqtarit.
- 4.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga njoftimi i vendimit.

U shpall sot, më datë 21.07.2014.

ZËVËNDËSKRYETARI

ELVIS ÇEFA



Vendim Nr. 105, datë 21.07.2014

PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE “VËREJTJE ME PARALAJMËRIM” NDAJ GJYQTARES H.C.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjen e dates 21.07.2014, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, për procedimin disiplinor të gjyqtares të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.C. dhe marrjen ndaj saj të masës disiplinore “Dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtë nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij”, në përputhje me nenin 31 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” të ndryshuar, pasi dëgjoi pretendimet e gjyqtares së proceduar dhe të avokates së saj av. Erinda Ballanca, që kërkoi rrëzimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë,

VËREN SE:

I. Mbi rrrethanat e çështjes

1. Ministri i Drejtësisë me shkresën nr.949 prot., datë 06.02.2014, i ka dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkesën për procedimin disiplinor ndaj gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.C.. Kërkesa për procedim, ka marrë shkas nga shkeljet që ka konstatuar Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në veprimtarinë e saj gjyqësore, pasqyruar në shkresat drejtuar Ministrisë së Drejtësisë e konkretisht: nr.697 prot., datë 05.03.2013; nr.262/1 prot., datë 20.03.2013 dhe 262/2 prot., datë 30.04.2013; nr.2372 prot., datë 26.08.2013.

2. Mbi bazën e shkeljeve të konstatuara, Ministri i Drejtësisë, ka kërkuar që ndaj gjyqtares të lartpërmendur, të merret masa disiplinore «Dërgimin për 1-2 vjet në një gjykatë të të njëjtë nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij», mbështetur në nenin 147 pika 6 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 33, të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë». Në kërkesën për procedim, pasqyrohet se gjyqtarja H.C. ka kryer shkelje të rënda të disiplinës në punë.

3. Nga vlerësimi që i është bërë kërkesës së Ministrit të Drejtësisë, dokumentacionit shkresor të administruar, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Këshilli vlerëson se:

i) shqyrtimi i kërkesës së paraqitur në këtë procedurë, nga pikëpamja formale dhe ajo proceduriale është në kompetencën ligjore të KLD-së, në bazë të pikës «ç» të nenit 2 dhe neneve 31 e vijues të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 «Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë».

ii) në referim të akteve shkresore, Ministri i Drejtësisë legitimohet si



nga pikëpamja procedurale, ashtu edhe nga pikëpamja materiale, bazuar në pikën 3 dhe 4 të nenit 31 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 «Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë», si dhe në nenin 34 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë». iii) kërkesa e depozituar në KLD nga Ministri i Drejtësisë, është brenda afatit të parashikuar në nenin 34 të ligjit nr. 9877 datë 18.02.2008 «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë». Konkretisht nga data e kryerjes së shkeljes kanë kaluar më pak se 5 (pesë) vjet dhe nga data e vënies në dijeni me shkeljen të Ministrit të Drejtësisë, në cilësinë e organit që ka të drejtën e nisjes së procedimit disiplinor, ka kaluar më pak se 1 (një) vit.

4. Shqyrtimi i kërkesës për procedim ka qenë pjesë e rendeve të ditës të dy mbledhjeve së Këshillit të datave: 16.07.2014 e 21.07.2014. Meqenëse shqyrtimi i kësaj pike të rendit të ditës së mbledhjes së datës 16.07.2014 e cila u shty për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore të gjyqtares, shqyrtimi i këtij procedimi disiplinor u përfundua në mbledhjen e Këshillit të datës 21.07.2014. Për këtë, gjyqtarja është vënë në dijeni me shkresat: nr.2455 datë 14.07.2014 dhe nr. 2519 datë 17.07.2014.

5. Rregullorja «Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve» në nenin 5 të saj parashikon se: «Mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në të cilën do të shqyrtohet procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari duhet të caktohet jo më shpejt se dhjetë ditë nga data që gjyqtarit i janë vënë në dispozicion materialet e plota të procedimit”. Gjyqtarja e proceduar H.Ç., është njohur me kërkesën e Ministrit të Drejtësisë dhe me materialet e tjera të procedimit në adresë të saj, me shkresën nr.507/1 datë 07.02.2014, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, provohet se i janë vënë në dispozicion:

- i) Kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor;
- ii) Praktika e materialete të procedimit, të ardhura nga Ministria e Drejtësisë.

6. Gjithashtu në nenin 6 po të Rregullores «Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve», parashikohet se: «Gjyqtari ndaj të cilit zhvillohet procedimi disiplinor duhet të njoftohet për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën dyzetetë orë përpara fillimit të saj», gjyqtarja H.Ç., është njoftuar për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, brenda këtij afati, dhe konkretisht, me shkresën nr. 2519 datë 17.07.2014, gjyqtarja është njoftuar për mbledhjen që do zhvillohej më datë 21.07.2014, në të cilën do të shqyrtohej kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj saj. Pra, më shumë se 48 orë para shqyrtimit të kërkesës është bërë njoftimi për mbledhjen e kësaj date.

7. Nga sa u parashtrua, rezulton se gjyqtares H.Ç. i janë garantuar të gjitha të drejtat procedurale të parashikuara nga ligji dhe nga rregullorja, duke u zhvilluar në këtë mënyrë një proces i rregullt ligjor nga ana procedurale.



8. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dëgjoi parashtrimet e Ministrit të Drejtësisë që relatoi relacionet e dërguara nga Inspektorati i Këshillit në drejtim të tij për inicimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtares H.Ç.. Këto relacione lidhen me verifikimin e 4 ankesave, si më poshtë.

8.1 Relacioni i parë i eshtë dërguar Ministrit të Drejtësisë me shkresën nr.697 prot., datë 05.03.2013 (për çështjen civile me ankues Kiço Billa). Nga verifikimi që ka bërë Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të urdhavrave të verifikimit të datës 04.09.2012 dhe 22.10.2012, mbi verifikimin e ankesës së paraqitur nga shtetasi Kiço Billa, për veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.Ç., për zvarritje gjykimi, kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

8.1.1. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X eshtë regjistruar çështja civile me nr. 3120 akti datë 04.10.2011, me palë ndërgjyqëse: Paditës Violeta Serjani, të paditur Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme X, me objekt: «Detyrim për rregjistrimine pasurisë së paluajtshme». Pas dorëheqjes së një gjyqtari tjetër më datë 17.10.2011 në këtë çështje, me shortin e hedhur më datë 18.10.2011 i ka kaluar gjyqtares H.Ç.. Më datë 24.10.2011 gjyqtarja ka vendosur kalimin e çështjes ne seancë përgatitore më datë 14.12.2011, me arsyetimin “..për shkak të ngarkesës shumë të madhe të punës». Gjykimi ka zgjatur 6 muaj e 26 ditë dhe janë zhvilluar 6 seanca përgatitore, konkretisht në datat 14.12.2011, 15.02.2012; 05.03.2012; 10.04.2012; 03.05.2012 dhe 10.05.2012. Në seancën e pestë, të datës 03.05.2012 eshtë konstatuar se dy personat e tretë të thirrur për gjykim Bede Veliaj dhe Aliko Veliaj kishin vdekur. Gjyqtarja e ka konsideruar këtë fakt si të metë të padisë dhe i ka lënë paditëses 7 ditë, që deri në seancën e rradhës, të datës 10.05.2012 që të sillte dëshminë e trashëgimnisë. Në seancën e datës 10.05.2012 gjyqtarja pasi ka konstatuar se të metat e padisë (dëshmia e trashëgimnisë) nuk eshtë plotësuar ka vendosur kthimin e padisë në bazë të nenit 154/a të K.Pr. Civile. Çështja eshtë riparaqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X më datë 04.06.2012 dhe pa short i ka kaluar gjyqtares H.Ç.. Gjykimi ka zgjatur 1 muaj, me 2 senaca përgatitore (datë 25.06.2012 dhe 04.07.2012. Në seancën e datës 04.07.2012 përfaqësuesi i palës Kiço Billa ka depozituar kërkesë me shkrim për përjashtimin e gjyqtares. Gjyqtarja me vendim ka pranuar kërkesën për përjashtim bazuar në nenet 74, 76 të K.Pr.Civile.

8.1.2. Sa më sipër eshtë konkluduar se, nga ana e gjyqtares H.Ç. eshtë konstatuar zvarritje e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale, të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj, të cilat mund të sjellin pasoja për të drejtën kushtetuese të palëve për një proces të rregullt ligjor berenda një afati të arsyeshëm. Ky konkluzion bazohet në argumentet e mëposhtëm:

a) Gjykimi i çështjes ka zgjatur për një periudhë prej 6 muaj e 26 ditë, në

shkelje të afatit 6 mujor të parashikuar në vendimin e KLD-së «Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore».

b) Seancën e dytë në gjykimin e parë gjyqtarja e ka planifikuar më datë 15.02.2012, pra pas 2 muajsh e 1 ditë. Në këtë rast, nuk jepet asnjë shpjegim prej gjyqtares për afatin e gjatë të planifikimit të seancës, për rrjedhojë ky afat është i pajustifikuar.

c) Vendimmarrja e gjyqtares për lënien e afatit 7 ditë paditësit për plotësimin e të metave, sjelljen e dëshmive të trashëgimisë, është në shkelje të neneve 154/a dhe 199 të K.Pr.Civile. Së pari, nuk ka referencë të qartë ligjore ku është bazuar gjyqtarja, që konsideron si «të metë të padisë», sjelljen e dëshmisë së trashëgimisë me qëllim «kalimin procedural», i cili është një veprim procedural që parashikohet nga nen 199 i K.Pr.Civile. Në një rast të tillë, gjykata është e detyruar të thërrasë në gjykim trashëgimtarët e palës së vdekur, të cilët legjitimohen si palë në gjykim. Në zbatim të neneve 388 të K.Pr.Civile dhe 348 të K.Civil. Kodi i Procedurës Civile parashikon që nga dita që gjykata jep një vendim përfundimtar civil e deri në ditën që ai të marrë formë të prerë pa u ankimuar, duhet të kalojnë 15 ditë. Pra rezulton se afati që i ka lënë gjyqtarja paditëses për sjelljen e dëshmisë së trashëgimisë ishte objektivisht dhe ligjërisht i pamundur për t'u realizuar prej përfaqësuesit të saj. Së dyti, gjyqtarja H.Ç. nuk ka zbatuar dispozitat urdhëruese procedurale të sanksionuara në nenin 297 gëрма “c” të K.Pr.Civile në të cilin parashikohet se: “Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur, njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik”.

d) Në gjykimin e dytë gjyqtarja ka pranuar kërkësen e palës paditëse për përjashtimin e saj, pa asnjë shkak ligjor të parashikuar nga nen 72 i K.Pr.Civile. 8.1.3 Konkludohet se, nga ana e gjyqtares H.Ç. është konstatuar zvarritje e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale, të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj, të cilat mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve.

8.2 Relacioni i dytë i është dërguar Ministrit të Drejtësisë me shkresën nr. 262/1 prot., datë 20.03.2013 [për çështjen civile me ankuese Odeta Haxhi (Dogga)]. Nga verifikimi që ka bërë Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të urdhrit të verifikimit të datës 18.02.2013, mbi verifikimin e ankesës së paraqitur nga shtetasja Odeta Haxhi (Dogga), për veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.Ç., për zvarritje gjykimi, kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

8.2.1 Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X është regjistruar çështja civile nr. 1461 akti, datë 22.02.2011 me palë ndërgjyqëse: Paditës Hristi Dogga, të paditur Edmond Beno, person i tretë: Banka Popullore Himarë, me objekt: «Detyrimin e të paditurit për shpërblim për përdorim sendi, si dhe të ardhurat nga dhënia me



qira e sendit në bashkëpronësi». Me shortin e hedhur më datë 22.02.2011 çështja i ka kaluar gjyqtares H.Ç.. Më datë 24.02.2011 gjyqtarja ka vendosur kalimin e çështjes në seancë përgatitore më datë 24.03.2011. Gjykimi ka zgjatur 1 vit, 9 muaj e 5 ditë dhe janë zhvilluar 3 seanca përgatitore dhe 20 seanca gjyqësore. 2 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të moskthimit të fletëthirrjeve nga posta; 10 seanca gjyqësore janë shtyrë me kërkesë të ndryshme të paditëses dhe avokates së saj; 3 seanca gjyqësore janë shtyrë me kërkesë të avokatit mbrojtjes të të paditurit; 3 seanca gjyqësore janë shtyrë mbasi gjyqtarja nuk është paraqitur në punë për shkaqe shëndetësore, 2 senaca gjyqësore janë shtyrë mbasi kanë rezultuar festa zyrtare dhe 1 senacë gjyqësore është shtyrë me kërkesë të ekspertit teknik. Nga 23 seancat e planifikuar, 4 prej tyre janë shtyrë mbi 1 (një) muaj e gjysmë.

8.2.2 Sa më sipër është konkluduar se nga ana e gjyqtares H.Ç. është konstatuar zvarritje e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale, të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj, të cilat mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve. Ky konkluzion bazohet në argumentet e mëposhtëm:

a) Gjykimi i çështjes ka zgjatur për një periudhë prej 1 vit 9 muaj e 5 ditë, në shkelje të afatit të caktuar nga vendimi i KLD-së «Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore».

b) Organizimi jo i mirë i punës nga gjyqtarja ka ndikuar që gjykimi të mos përfundojë brenda një afati kohor më të arsyeshëm.

8.2.3 Konkludohet se, nga ana e gjyqtares H.Ç. është konstatuar zvarritje e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale, të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj, të cilat mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve.

8.3 Relacioni i tretë i është dërguar Ministrit të Drejtësisë me shkresën nr.262/2 prot., datë 30.04.2013 (për çështjen civile me ankuese Myzejen Zyka). Nga verifikimi që ka bërë Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të urdhrit të verifikimit të datës 27.04.2011, mbi verifikimin e ankesës së paraqitur nga shtetasja Myzejen Zyka, për veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.Ç., për zvarritje gjykimi, kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

8.3.1. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X është regjistruar çështja civile nr. 778 akti datë 29.12.2009 me palë ndërgjyqëse, Paditës: Muhamet Tiganë, etj., të paditur: Qamil Ferhataj, etj., me objekt: «Goditje për falsitet të vendimit nr.80 datë 30.05.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave X. Kundërshtimin (shfuqizimin) e vendimit nr.77 datë 13.04.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave X dhe detyrimin e të paditurve të njohin pronar mbi një sipërfaqe trualli 1344 m², trashëgimtarët ligjorë të ishpronarëve z. Emin

Tigani, Sali, Mustafa, Tahir, Qazim Tigani. Çëregjistrimin e sipërfaqes prej 1344 m² në emër të të paditurve dhe regjistrimin e saj në emër të trashëgimtarëve të ish pronarëve Emin Tigani, Sali, Mustafa, Tahir, Qazim Tigani në Zyrat e rregjistrimit të pasurive të Paluajtshme X». Me shortin e hedhur më datë 12.01.2010 çështja i ka kaluar gjyqtares H.Ç., e cila ka caktuar seancën përgatitore më datë 01.02.2010. Gjykimi ka zgjatur 1 vit, 10 muaj, e 10 ditë dhe janë zhvilluar 5 seanca përgatitore dhe 26 seanca gjyqësore. Një nga seancat përgatitore është zhvilluar në prani të palëve dhe me vendimin e datës 19.04.2010, gjykata ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore për më datë 12.05.2010, dhe 4 (katër) seancat e tjera nuk janë zhvilluar për shkaqe: 3 seanca përgatitore janë shtyrë për njoftime të palëve, 1 (një) senacë përgatitore për mungesë të gjyqtares e cila ka pasur një fatkeqësi familjare. Në 26 seanca gjyqësore rezulton se, 13 seanca gjyqësore janë zhvilluar në prani të palëve dhe 13 seanca nuk janë zhvilluar përkëto shkaqe:

- 5 seanca janë shtyrë me kërkesë të palës së paditur;
- 2 seanca janë shtyrë janë shtyrë për t'i dhënë kohë të paditurve për të paguar ekspertin;
- 1 seancë është shtyrë për mungesë të paditurit sepse ishte shtruar në spital;
- 2 seanca gjyqësore janë shtyrë për mungesë të gjyqtares, për arsyeshëndësore, raport mjekësor;
- 2 seanca janë shtyrë për njoftime; dhe
- 1 senacë është shtyrë me kërkesë të palës paditëse.

8.3.2 Sa më sipër është konkluduar se ana e gjyqtares H.Ç. është konstatuar zvarritje e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale, të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj, të cilat mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve. Ky konkluzion bazohet në argumentet e mëposhtëm:

a) Gjykimi i çështjes ka zgjatur nga data 12.01.2010 – 22.11.2011, për një periudhë prej 1 vit, 10 muaj, e 10 ditë, në shkelje të afatit të caktuar nga vendimi i KLD-së «Mbi kriteret matëse të veprimitarës gjyqësore».

b) Organizimi jo i mirë i punës nga gjyqtarja ka ndikuar që gjykimi të mos përfundojë brenda një afati kohor më të arsyeshëm.

8.3.3 Konkludohet se, nga ana e gjyqtares H.Ç. është konstatuar zvarritje e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale, të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj, të cilat mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve.

8.4 Relacioni i katërt i është dërguar Ministrit të Drejtësisë me shkresën nr.2372 prot., datë 26.08.2013 (për çështjen civile me ankuesë Dodona Ramadani). Nga verifikimi që ka bërë Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të urdhrvatë verifikimittë datës 15.04.2011 dhe 14.12.2012 mbiverifikimin e ankesës



së paraqitur nga shtetasja Dodona Ramadani, për veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.Ç., kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

8.4.1. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X është regjistruar çështja civile nr. 3950 akti datë 29.12.2009 me palë ndërgjyqëse, Paditës: Dodona Ramadani, kundër të paditurit: Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, me objekt: «Ndryshim i pikës 1 të vendimit nr 73 datë 23.02.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, kthimin në natyrë të sipërfares prej 225 m², në emër të trashëgimlënësit Isa Ramadani, vendimit nr.73 datë 23.02.1995, në emër të Resul Ramadani për sipërfaqen 225 m², në pikën 1/b, vendimin nr.88 datë 04.10.1995 në emër të Brahim Ramadani, në pikën 1/b për sipërfaqen 500 m²». Me shortin e hedhur më datë 21.01.2010 çështja i ka kaluar gjyqtares H.Ç.. Me vendimin nr.697 datë 25.03.2011 gjyqtarja ka vendosur; «Rrezimin e padisë që i përket: paditëses Ilda Bejjaj, e paditur: Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave X me objekt: Ndryshimin e pikës 1/b të vendimit me nr.73 datë 23.02.1995, KKPPronave X. Kthimin në natyrë të sipërfares prej 225 m² në emër të trashëgimlënësit Resul Ramadani». Gjyka e Apelit X me vendimin nr.160 datë 05.03.2013 ka vendosur prishjen e vendimit nr.697 datë 25.03.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë X. Gjykimi ka zgjatur 1 vit e 3 muaj, dhe janë zhvilluar 5 seanca përgatitore dhe 21 seanca gjyqësore. Në 5 seanca përgatitore, 2 seanca përgatitore janë zhvilluar, 2 seanca përgatitore janë shtyrë për mosparaqitjen e gjyqtares (rast vdekje dhe një rast raport mjekësor), 1 seancë është shtyrë për njoftimin e Avokaturës së Shtetit. Në 21 sencat gjyqësore, 10 senaca janë zhvilluar, 3 seanca janë shtyrë për t'u dhënë kohë ekspertëve për të përgatitur aktin, 3 seanca janë shtyrë për njoftim palësh ndërgjygjëse, 2 senaca janë shtyrë me kérkesën e paditëses për të marrë avokat, 1 senacë për të rregulluar të metat e padisë, 2 seanca janë shtyrë për mungesë të gjyqtares pas ka qënë me raport mjekësor. Gjyqtarja H.Ç. me vendim të ndërmjetëm në datën 17.11.2010, bazuar në nenin 159 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur veçimin e çështjes civile me nr.3999 akti datë 28.12.2009, datë 28.12.2009, që i përket kërueses Ilda Bejjaj, për ndryshimin e nr.73 datë 23.02.1995, KKPPronave X. Kthimin në natyrë të sipërfares prej 225 m² në emër të trashëgimlënësit Resul Ramadani». Kjo çështje e veçuar nga gjyqtarja në shortin e hedhur nga gjykata më datë 20.01.2011 i ka kaluar gjyqtarit Shkëlzen Selimi i cili pasi mban në dorë për një periudhë 1 muaj e 10 ditë, në seancë përgatitore urdhëron kryesekretarin që të bëjë kalimin e akteve tek gjyqtarja H.Ç. pasi në vendimin e ndërmjetëm të veçimit të çështjes nuk është bërë ndarja e kërkimeve, por heqje dorë nga gjykimi i çështjes, jo në formën e kërkuar nga ligji. Vendimi i gjyqtares për veçim çështje është absolutisht i pavlefshëm. Gjyqtarja e kalon çështjen në sekretari me shkresën nr.36 akti datë 02.03.2011 dhe për këtë situatë më datë 09.03.2011 ka njoftuar Kryeins-

pektoren e KLD, Valbona Vata. Në periudhën 02.03.2011 deri më 05.07.2011 çështja ka qëndruar në sekretari të gjykatës pa asnjë lloj veprimi. Shorti i hedhur më datë 05.07.2011 i ka kaluar këtë çështje përsëri gjyqtares H.Ç. dhe në seancën përgatitore ankuesja Dodona Ramadani ka paraqitur kërkesë për përjashtim gjyqtari, kërkesë e cila është miratuar nga gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës ë datë 15.09.2011. Çështja pas shortit i kalon gjyqtares Marinela Nuni, e cila pas mbajtjes së saj 1 muaj e 14 ditë, me vendim të KLD të datës 14.11.2011 është transferuar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë. Më datë 17.11.2011 çështja e veçuar i ka kaluar me short gjyqtarit Arqile Basha, i cili pas 5 muaj e 6 ditë me datë 23.04.2012 ka marrë vendimin nr.1211, "Pranimin e padisë", vendim i cili ka marrë formë të prerë më datë 05.06.2016.

8.4.2. Sa më sipër është konkluduar se nga ana e gjyqtares H.Ç. është konstatuar zvarritje e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale, të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj, të cilat mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve. Ky konkluzion bazohet në argumentet e mëposhtëm:

a) Gjykimi i çështjes ka zgjatur për një periudhë prej 1vit e 3 muaj (prej 7 muaj e 18 ditë nga gjyqtarja H.Ç.) në shkelje të dukshme të afatit të caktuar nga vendimi i KLD-së « Mbi kriteret matëse të veprimitarisë gjyqësore»;

b) Gjyqtarja Cela ka gabuar në vendimin e ndërmjetëm të datës 17.11.2010, me të cilin ka vendosur: «Veçimin e çështjes civile me nr.3993 datë 28.12.2009. Dërgimin e dosjes gjyqësore në kryesekretarinë e gjykatës për kryerjen e vepprimeve duke e rihedhur në short pjesën e veçuar të padisë së paditëses». Ajo ka vendosur në kundërshtim me nenin 159 të K.Pr.Civile për veçimin e çështjes. Lidhur me këtë vendim edhe Gjykata e Apelit X «...çmon se vendimi për veçimin e çështjes nga Gjykata e Shkallës së Parë është jo vetëm në kundërshtim me detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit, por aq kondradiktorë dhe në mungesë të plotë të ligjit procedural, kur vetë gjykata arsyeton kontradiktat e palëve në lidhje me objektin e gjykimit Janë pikërisht arsyet e pretenduara në ankimin e paditëses, të cilat do të çonin gjykatën në gjykimin e çështjes si një e tërë dhe jo në veçimin e saj....».

8.4.3. Konkludohet se, nga ana e gjyqtares H.Ç. është konstatuar zvarritje e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale, të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj, të cilat mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve.

9. Për këto shkelje të evidentuara në verifikimin e 4 ankesave Ministri i Drejtësisë ka konkluduar se veprimet e kryera nga gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.Ç., janë shkelje të rënda të disiplinës të parashikuara nga neni 32, pika 3, shkronja «a» të Ligjit Nr. 9877, datë 18.02.2008, «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë», si raste të përgjegjësisë dis-



iplinore në kategorinë e shkeljeve të rënda dhe i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në shkresën nr. shkresën nr.949 prot., datë 06.02.2014, drejtar Këshillit, procedimin disiplinor të gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.C., dhe marrjen e masës disiplinore «Dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtë nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij».

10. Në referim të Vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.137, datë 21.02.2003 Rregullore «Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve» i ndryshuar, Ministri i Drejtësisë në përfundim të shqyrtimit të këtij procedimi në seancën plenare të datës 21.07.2014, ndryshoi kërkimin e tij për llojin e masës disiplinore, duke kërkuar përfundimisht marrjen e masës disiplinore «Vërejtje me paralajmërim» ndaj gjyqtares.

II. Vlerësime të Këshillit

11. Këshilli vlerëson se lidhur me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.C., në çështjen civile me nr. 3120 akti datë 04.10.2011, me palë ndërgjyqëse: Paditës Violeta Serjani, të paditur Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme X, me objekt: «Detyrim për rregjistrimine pasurisë së paluajtshme»:

a) gjykimi i çështjes ka zgjatur për një periudhë prej 6 muaj e 26 ditë, në shkelje të afatit 6 mujor të parashikuar në vendimin e KLD-së «Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore».

b) Gjyqtarja është në shkelje të neneve 154/a dhe 199 të K.Pr.Civile, në vendimmarrjen e saj për lënien e afatit 7 ditë paditësit për plotësimin e të metave, sjelljen e dëshmive të trashëgimisë. Në zbatim të neneve 388 të K.Pr. Civile dhe 348 të K.Civil. Kodi i Procedurës Civile parashikon që nga dita që gjykata jep një vendim përfundimtar civil e deri në ditën që ai të marrë formë të prerë pa u ankimuar, duhet të kalojnë 15 ditë. Pra del se afati që i ka lënë gjyqtarja paditëses për sjelljen e dëshmisi së trashëgimisë ishte objektivisht dhe ligjërisht i pamundur për tu realizuar prej përfaqësuesit të saj.
c) Gjyqtarja ka pranuar kërkesën e palës paditëse për përjashtimin e saj, pa asnjë shkak ligjor të parashikuar nga neni 72 i K.Pr.Civile.

12. Këshilli vlerëson se lidhur me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.C., në çështjen civile me nr. 1461 akti datë 22.02.2011 me palë ndërgjyqëse: Paditës Hristi Dogga, të paditur Edmond Beno, person i tretë: Banka Popullore Himarë, me objekt: «Detyrimin e të paditurit për shpërblim për përdorim sendi, si dhe të ardhurat nga dhënia me qira e sendit në bashkëpronësi», gjykimi i çështjes ka zgjatur për një periudhë prej 1 vit 9 muaj e 5 ditë, në shkelje të afatit të caktuar nga vendimi i KLD-së «Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore», kjo sjellje konsiderohet si zvarritje e pajustifikuar

dhe e përsëritur e veprimeve procedurale të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj.

13. Këshilli vlerëson se lidhur me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.Ç., në çështjen civile me nr.778 akti datë 29.12.2009 me palë ndërgjyqëse, Paditës: Muhamet Tigani, etj., të paditur: Qamil Ferhataj, etj., me objekt: «Goditje për falsitet të vendimit nr.80 datë 30.05.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave X. Kundërsh-timin (shfuqizimin) e vendimit nr.77 datë 13.04.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave X dhe detyrimin e të paditurve të njohin pronar mbi një sipërfaqe trualli 1344 m², trashëgimtarët ligjorë të ishpronarëve z. Emin Tigani, Sali, Mustafa, Tahir, Qazim Tigani. Çëregjistrimin e sipërfaqes prej 1344 m² në emër të të paditurve dhe regjistrimin e saj në emër të trashëgimtarëve të ish pronarëve Emin Tigani, Sali, Mustafa, Tahir, Qazim Tigani në Zyrat e rregjisi-trimit të pasurive të Paluajtshme X», gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 vit, 10 muaj e 10 ditë në shkelje të afatit të caktuar nga vendimi i KLD-së «Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore», kjo sjellje konsiderohet si zvarritje e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj.

14. Këshilli vlerëson se lidhur me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.Ç., në çështjen civile me nr. 3950 akti datë 29.12.2009 me palë ndërgjyqëse, Paditës: Dodona Ramadani, kundër të paditu-rit: Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, me objekt: «Ndryshim i pikës 1 të vendimit nr 73 datë 23.02.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, kthimin në natyrë të sipërfaqes prej 225 m², në emër të trashëgimlë-nësit Isa Ramadani, vendimit nr.73 datë 23.02.1995, në emër të Resul Ramadani për sipërfaqen 225 m², në pikën 1/b, vendimin nr.88 datë 04.10.1995 në emër të Brahim Ramadani, në pikën 1/b për sipërfaqen 500 m²», gjykimi i çështjes ka zgjatur për një periudhë prej 1vit e 3 muaj (prej 7 muaj e 18 ditë nga gjyqtarja H.Ç.) në shkelje të dukshme të afatit të caktuar nga vendimi i KLD-së « Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore», kjo sjellje konsiderohet si zvarritje e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj.

15. Këshilli i Lartë i Drejtësisë nga faktet e parashtruara konstaton se lidhur me çështjet e gjykuara dhe të zvarritura nga gjyqtarja H.Ç., përbën shkelje të rëndë të ligjit me pasojë cënimin e lirive dhe të drejtave themore të njeriut. Në këtë kontekst, neni 15, pika 2 e Kushtetutës parashikon «Organet e pushtetit publik, në përmbrushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre». Ky para-shikim kushtetues shihet i lidhur me detyrime të tjera që, akti themelor i shtetit

i ngarkon në mënyrë të posaçme pushtetit gjyqësor. Edhe në nenin 42, pika 2 të Kushtetutës citohet: « Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë..., ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj».

16. Gjatë veprimitarës gjyqësore në mënyrë të përsëritur, gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.Ç., ka shkelur disa dispozita të detyrueshme për zbatim të legjislacionit procedural në fuqi në Republikën e Shqipërisë: Kodin e Procedurës Civile, nenin 1, ku parashikon se rregullat e tij janë të detyrueshme për t'u zbatuar. Neni 4 i këtij kodi, i vë detyrë gjyqtarit të realizojë një proces të rregullt ligjor, duke marrë masat e nevojshme për zhvillimin e tij, deri në finalizimin, me arsyetimin e vendimit dhe dorëzimin e tij sipas afateve ligjore, «Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme».

17. Shkeljet e konstatuara rezultojnë dhe dalin qartë në të gjitha aktet shkresore të marra në shqyrtim në këtë vendimmarrje të Këshillit, siç janë relacionet e inspektoreve të IKLD dhe shkresat përkatëse, procesverbalet e verifikimit të kryera prej tyre apo dhe vetë kërkesa e Ministrit drejtuar KLD.

18. Shkeljet e konstatuara nga gjyqtarja H.Ç., kanë konsistuar në mosrespektimin në mënyrë të vazhdueshme, të përsëritur dhe të pajustifikuar të dispozitive procedurale civile, duke sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim si dhe për dhënien e drejtësisë. Këto shkelje kanë diskredituar rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit.

19. KLD vlerëson se respektimi i dispozitive procedurale të cilat lidhen me gjykimin e një çështje brenda një afati te arsyeshëm, në mënyrë që të mos cënohen të drejtat kushtetuese të palëve në proces dhe të mos pengohet dhënia e drejtësisë, është e lidhur drejtpërsëdrejtë me respektimin e parimit të zhvillimit dle përfundimit të një procesi brenda një afati të arsyeshëm. Me afat të arsyeshëm ligjor kuptohet jo vetëm koha që merr shqyrtimi i çështjes deri në shpalljen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës, por edhe koha që i nevojitet gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar. Gjithashtu, Këshilli është i vetëdijshme se respektimi i afatit të arsyeshëm ligjor varet nga shumë faktorë të procesit të gjykimit të cilët janë të lidhur dhe ndikojnë drejtpërsëdrejtë në zhvillimin e këtij procesi, siç mund të janë: sjelljet e palëve në proces, kompleksiteti i çështjes, përkushtimi dhe aftësia e gjykatës dhe administratës gjyqësore për përfundimin në kohë të procesit dhe ushtrimin e detyrës në përputhje me ligjin, etj. Afati i arsyeshëm që merret në konsideratë për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi merr formë

të prerë. (Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut nenit 6 «1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht,...».

20. Këshilli thekson se nuk është konstatuar se nga gjyqtarja është marrë ndonjë masë për të eliminuar çdo lloj shkaku që çështjet të mos zvarriten por të gjykohen brenda një afati të arsyeshëm. Eficencia në drejtësi është një kriter i rëndësishëm për zhvillimin dhe konsolidimin e një procesi të rregullt ligjor si dhe për rivendosjen e të drejtave të palëve të pretenduara të shkelura. Prandaj këto vonesa ndikojnë dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë tek palët në proces pasi u cënohen këtyre të fundit të drejtat e tyre kushtetuese dhe përfundimisht procesi gjyqësor degradon në një proces joefektiv.

21. Në sjelljen e gjyqtares H.Ç., KLD konstaton një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tillë që kalojnë «kufirin e të arsyeshmes», dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, sjellje e cila çon në cënimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.

22. Nisur nga analiza e mësipërme, vlerësohet se zvarritjet e proceseve gjyqësore konsiderohen si shkelje disiplinore në kuptim të nenit 32/1/b si dhe nenit 32/3/a të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 dhe e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore pasi:

- i) këto vonesa janë të vazhdueshme, të përsëritura dhe të pajustifikuara;
- ii) këto vonesa kanë sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë;
- iii) këto vonesa janë jashtë çdo afati të arsyeshëm logjik dhe objektiv;
- iv) këto vonesa kanë cenuar imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut të drejtësie

23. Këshilli i Lartë i Drejtësisë konkludon se: - shkeljet e konstatuar në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtares H.Ç. vlerësohen se kanë shkaktuar shqetësim në një masë të madhe të njerëzve të interesuar, duke dëmtuar besimin e publikut tek dhënia e administrimi i drejtësisë, duke ulur imazhin e sisteminit gjyqësor, duke prekur interesat e një mase të madhe njerëzish (vendime të zvarritura përtrej afateve të arsyeshme. Këto kanë shkaktuar dëme për palët, kanë cenuar të drejtat e tyre kushtetuese). - Sjellja e gjyqtares ka diskredituar rëndë pozitën dhe figurën e saj, dhe ka treguar paaftësinë e saj për të përballuar punën e tij të përditshme.

24. Këto veprime të gjyqtares H.Ç., përbëjnë shkelje disiplinore dhe parashikohen në kuptim të nenit 32/1/b si dhe nenit 32/3/a të Ligjit nr.9877/2008 «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë». Në faktet që i



atribuohen gjyqtares H.Ç. plotësohen të gjitha kushtet e këtij parashikimi ligjor:

- i. shkelja e pajustifikuar të dispozitave urdhëruese procedurale;
- ii. shkelja e përsëritur të dispozitave urdhëruese procedurale dhe;
- iii. ardhja ose mundësia e ardhjes së pasojave për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë. Në këtë kontekst, Këshilli është i mendimit se, propozimi i Ministrit të Drejtësisë për masën disiplinore «Vërejtje më paralajmërim» është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.8811, datë 17.05.2001 «Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë», i ndryshuar, në Ligjin Nr.9877, datë 18.02.2008, «Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë», si dhe në Vendimin nr.137, datë 21.02.2003 Rregullore «Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve» i ndryshuar, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

V E N D O S I :

1. Pranimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor X, H.Ç..
2. Dhënien e masës disiplinore «Vërejtje me paralajmërim» ndaj gjyqtares të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor X, H.Ç..
3. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet rregullisht gjyqtarit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga njoftimi i vendimit.

U shpall sot, më datë 21.07.2014.

ZËVËNDËSKRYETARI

ELVIS ÇEFA

Vendim Nr. 18, datë 04.02.2015

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR PROCEDIM DISIPLINOR
NDAJ GJYQTARIT N.C.**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë i mbledhur më datë 04.02.2015, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, nr. 2547/3 prot., datë 21.10.2014, me dokumentacionin përkatës për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, N.C., dhe marrjen ndaj tij të masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”, si dëgjoi pretendimet e gjyqtarit të proceduar,

VËREN SE :

1. Me shkresën nr. 2547/3 prot., datë 21.10.2014, Ministri i Drejtësisë, ka depozituar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, N.C. Për fillimin e këtij procedimi është marrë shikas nga shkeljet që Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka konstatuar në veprimtarinë e tij gjyqësore, pasqyruar në shkresën 2547/2, datë 27.12.2013 drejtar Ministrisë së Drejtësisë për kompetencë vlerësimi.

2. Ministri i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 147, pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 31, pika 3 të Ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë marrjen e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” ndaj gjyqtarit N.C.. Në kërkesën për procedim disiplinor, bazuar në Ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 32, argumentohet se ky gjyqtar ka kryer shkelje të rënda të parashikuara në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite.

3. Nga vlerësimi që i është bërë kërkesës së Ministrit të Drejtësisë, dokumentacionit shkresor të administruar, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Këshilli vlerëson se:

i) shqyrtimi i kërkesës së paraqitur në këtë procedurë, nga pikëpamja formale dhe ajo proceduriale është në kompetencën ligjore të KLD-së, në bazë të pikës “ç” të nenit 2 dhe neneve 31 e vijues të Ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.
ii) në referim të akteve shkresore, Ministri i Drejtësisë legjitimohet si nga pikëpamja procedurale, ashtu edhe nga pikëpamja materiale, bazuar në pikën 3 dhe 4 të nenit 31 të Ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin



e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", si dhe në nenin 34 të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".
 iii) kërkesa e depozitarit në KLD nga Ministri i Drejtësisë, është brenda afatit të parashikuar në nenin 34 të Ligjit nr. 9877 datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Konkrektisht nga data e kryerjes së shkeljes kanë kaluar më pak se 5 vjet dhe nga data e vëndosjes në dijeni me shkeljen të Ministrit të Drejtësisë, në cilësinë e organit që ka të drejtën e nisjes së procedimit disiplinor, ka kaluar më pak se 1(një) vit.
 iv) shyrtimi i kërkesës ka qënë pjesë e rendit të ditës në mbledhjen e Këshillit, datë 04.02.2015, në të cilën gjyqtari N.C. ka qënë vetë i pranishëm.

4. Shyrtimi i kërkesës për procedim ka qenë pjesë e rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit datë 04.02.2015 (ora 16.00). Gjyqtari është vënë në dijeni më datë 02.02.2015 ora 10.30 për datën e zhvillimit të mbledhjes ku do të shqyrtohet dhe kërkesa për procedim disiplinor ndaj tij.

5. Konform Rregullores "Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve" e ndryshuar, në nenin 6 në të cilin parashikohet se "Gjyqtari ndaj të cilit zhvillohet procedimi disiplinor duhet të njoftohet për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën 48 orë para fillimit të saj", është njoftuar gjyqtari N.C. për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, brenda këtij afati, njoftime të cilat u cituan më sipër, specifikohen sërisht më poshtë:
 i) shkresanr. 203/1, datë 21.01.2015 (për seancën e mbledhjes së KLD datë 26.01.2015);
 ii) shkresa e datës 02.02.2015 (për seancën e mbledhjes së KLD datë 04.02.2015);

6. Gjithashtu, KLD konstaton se mbështetur në nenin 5 të Rregullores "Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve" e ndryshuar, ku parashikohet se: "Mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në të cilën do të shqyrtohet procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari duhet të caktohet jo më shpejt se dhjetë ditë nga data që gjyqtarit i janë vënë në dispozicion materialet e plota të procedimit", gjyqtari i proceduar N.C. është njojur për kërkesën e Ministrit të Drejtësisë dhe dokumentacionin përkatës (shoqëruesh) nëpërmjet shkresës nr. 2547/4 prot., datë 23.10.2014, duke i vënë në dispozicion:

- i) Kërkesën e Ministri i Drejtësisë për procedimin disiplinor nr. 2547/3 prot., date 21.10.2014.
- ii) Relacionin e KLD-së dërguar Ministrit të Drejtësisë me shkresën nr. 2547/2 prot., datë 27.12.2013.
- iii) Pretendimet e gjyqtarit N.C., me shkresën nr. 6376/2 prot., date 23.01.2014, drejtuar Ministrit të Drejtësisë, si dhe provat shoqëruuese.

7. Nga sa u parashtrua, rezulton se gjyqtarit N.C. i janë garantuar të drejtat pro-

cedurale të parashikuara nga ligji dhe rregullorja, duke u zhvilluar në këtë mënyrë një proces i rregullt ligjor, në pikëpamjen procedurale.

I. Fakte dhe Rrethana.

8. Në mbledhjen e datës 04.02.2014, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dëgjoi parashtrimet e Ministrit të Drejtësisë që relatoi relacionin e dërguara nga Inspektorati i Këshillit në drejtim të tij për iniciimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit N.C.. Relacioni i është dërguar Ministrit të Drejtësisë me shkresën nr. 2547/2, datë 27.12.2013. Nga verifikimi që ka bërë Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka rezultuar se gjyqtarit N.C., përgjatë gjykimit të 11 çështjeve civile i janë konstatuar shkelje të dispozitave procedurale civile, me pasojë zvarritjen e gjykimit të çështjeve dhe konkretisht:

a) Ka shpallur dhe ka depozituar me vonesë në sekretarinë gjyqësore 9 vendime, të cilat nga verifikimi rezultojnë se:

i) Janë vendime përfundimtare me palë kundërshtare të cilat kanë zgjidhur çështjen në themel dhe kundër të cilave është ushtruar ankim. Afati minimal i dorëzimit të vendimeve të arsyetuara, variojnë në diferenca kohore nga 1 muaj deri në 3 muaj e 7 ditë.

ii) Rezulton se afati 5 ditor për shtyrjen e seancës për shpalljen e arsyetuar të vendimit nuk është respektuar në vendimet e mësipërme.
iii) Mosdorëzimi i vendimit të arsyetuar nga gjyqtari N.C. ka kapërcyer afatin ligjor të ankimit të parashikuar në nenin 443/1 Kodi i Procedurës Civile. Në 3 raste palët kanë ankimuar vendimin pa pasur një vendim të arsyetuar në kohën e duhur. Vetëm në një rast ankimia është paraqitur pas arsyetimit të vendimit.

b) Evidentohen 2 vendime përfundimtare të paankimuara, dorëzimi i të cilave ka vonesë nga 1 muaj e 1 ditë deri 1 muaj e 11 ditë vonesë, gjë që ka sjellë ekzekutimin me vonesë të tyre.

9. Në përfundim, nga ana e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është arritur në konkluzionin se veprimet e gjyqtarit N.C., janë në shkelje të nenit 32, pika 3, shkronja "a" të ligjit 98/77, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Sipas këtij nenit këto shkelje klasifikohen si shkelje të rënda dhe konkretisht: Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë:

a) zvarritja e pajustifikuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit, kur zvarritja ka passjellë ose mund të sillte pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë.

10. Këto shkelje të konstatuara dhe të referuara në pikën 8 të këtij vendimi, vlerësohen nga Ministri, se nuk përbëjnë shkelje të rëndë të disiplinës, sipas kon-



cepteve të përdoruara në nenin 32, pika 3 të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", kjo në përputhje edhe me konkluzionet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 5, date 12.12.2013 (N. T., kundër KLD). Vlerësohet se shkeljet konkrete kanë diskretituar figurën dhe pozitën e gjyqtarit konform nenit 32, pika 4 shkronja ç të ligjit të mësipërm.

11. Dorëzimi i vendimeve gjyqësore brenda një afati të përcaktuar është pjesë e procesit gjyqësor, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në administrimin e drejtësisë. Mosplotësimi dhe mosbatimi i këtyre rregullave procedurale, sjell si pasojë një veprimitari të realizuar në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin dhe përbëjnë shkelje të disiplinës. Arsyetimi në kohë i vendimit nga gjyqtari, është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe sidomos e parimit kushtetues të "gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm kohor", e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës në të cilin thuhet: "Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritur kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.", si dhe në nenin 6 pika 1, të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm në të cilin parashikohet: "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dégjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdoakuze të natyrës penale që i është drejtuar". Mungesa e arsyetimit dhe dorëzimit të vendimit brenda afatit kohor të përcaktuar në K.P.Civile pengon palët të gëzojnë ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit, si pjesë e procesit të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

12. Për gjyqtarin N.C., arrihet në përfundimin se veprimet gjatë ushtrimit të veprimitarisë gjyqësore janë të tillë që e ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore, për të cilat ai duhet të mbajë përgjegjësi në raport të drejtë me shkeljen e kryer, siç përcakton edhe nen 33 pika 1 e Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu Ministri i Drejtësisë vlerëson se në dhënien e masës disiplinore ndaj tij duhen marrë në konsideratë: numri i shkeljeve të kryera, volumi i punës i përballuar nga gjyqtari, kompleksiteti i çështjeve, cilësia e vendimeve, vlerësimi shumë mirë i gjyqtarit në vlerësimin e parë të bërë nga KLD, apo gjendja familjare e shëndetësore.

13. Gjyqtarit N.C. në bazë të nenit 35 të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i janë ofruar të gjitha

të drejtat për një procedim disiplinor. Ai ushtroi të drejtën për t'u dëgjuar prej Këshillit dhe paraqiti pretendimet e tij si më poshtë:

Së pari: Kundërshtimet bazohen në aspektin procedural duke kërkuar pavlefshmérinë e kërkesës së paraqitur nga ana e Ministrit të Drejtësisë, pasi ajo bazohet në akte procedurale absolutisht të pavlefshme. Kërkesa e Ministrit të Drejtësisë bazohet pikërisht në kërkesat e nenit 16, pika 1 të Ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", dispozitë kjo e emërtuar "Detyrat e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë", e cila kërkon që kusht i domosdoshëm për vënien në lëvizje të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të jetë ankesa e shtetasit ose subjekteve të njohura nga ligji. Në kushtet kur fillimi i procedimit nuk është bazuar në bazën e një ankesë por është bazuar në bazën e një informacioni, automatisht arrihet në përfundimin që nuk ekzistonin kushtet për fillimin e procedimit disiplinor, dhe se procedura e nisur është absolutisht e pavlefshme. Së dyti: Lidhur me aspektin material parashtrimet e Ministrit të Drejtësisë, edhe në relacionin e përcjellë nga ana e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që ka përbërë edhe shkakun për fillimin e procedimit disiplinor, nuk është arsyetuar se pse veprimet e mia duhet të konsiderohen akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit. Në të nuk ka një përkufizim dhe më pas një analizë të hollësishme të shkaqeve të cilat kanë qenë të karakterit objektiv, apo të karakterit subjektiv. Pra, nëse nuk kam dashur të jem korrekt me dispozitën, apo ka qenë pamundësia reale objektive e imja për të respektuar afatet. Së treti: Në arritjen e përfundimit nëse shkeljet e konstatuara duhet të konsiderohen ose jo si shkelje që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, duhet t'i referohemi përfundimeve të arritura nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimet nr. 5, datë 12.12.2013, rasti T. kundër Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe atij nr. 4, datë 13.10.2014, rasti Ç. kundër Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në këto vendime Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë përcaktuar shprehimisht se: "Pavarësisht afateve të parashikuara në ligjet tona procedurale, qofshin civile dhe penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë dhe janë të ndërgjegjshme se jo gjithmonë këto afate mund të respektohen me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimitarisë së tyre; jo gjithmonë këto dispozita janë efektive gjatë ushtrimit të kësaj veprimitarie dhe jo gjithmonë mosrespektimi i tyre është shkak ligjor për marrjen e masave disiplinor ndaj gjyqtarëve nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë". Gjithashtu ato theksojnë se "Pamundësia për të respektuar me rigorozitet maksimal këto dispozita, mund të justifikohet nga ekzistanca e shkaqeve objektive të cilat nuk varen nga gjyqtarët dhe që mund të pengojnë ata në respektimin rigoroz të këtyre normave, siç mund



të jetë ngarkesa e madhe në punë, kompleksiteti i çështjeve në ngarkim, sjellja e palëve gjatë procesit, pamundësia objektive e gjykatave për zhvillimin e procesit gjyqësor, shkaqe të justifikuara shëndetësore apo familjare, të cilat mund të kenë ndikim direkt tek gjyqtari dhe nuk e lejojnë atë të ushtrojë normalisht detyrën e tij". Së katërti: Lidhur me çështjen e shtruar për shqyrtim në aspektin material – Rastet e vendimeve të evidentuara nga ana e inspektorëve në materialin e përcjellë pranë Ministrit të Drejtësisë, si dhe të evidentuara në kërkesën për procedim disiplinor, rezulton t'i përkasin vitit 2013 dhe numri i rasteve është 11. Në analizë duhet të merret ngarkesa, pra, numri i çështjeve të përfunduara për vitin 2013. Për vitin 2013, pas realizimit të procedurave të shortit, janë paraqitur për shqyrtim 698 dosje të natyrave të ndryshme, nga të cilat të përfunduara me vendim përfundimtar rezultojnë të janë 509. Numri real i vendimeve të dhëna nga ana ime si gjyqtar për vitin 2013 rezulton të jetë shumë më i lartë. Konkretisht, numri real i ngarkesës, numri real i vendimeve të dhëna nga ana ime si gjyqtar për vitin 2013, rezulton të jetë 729 çështje dhe 540 vendime. Së pesti: Në analizë duhet të merret mungesa e kohës së nevojshme për arsyetimin e vendimeve. Për periudhën janar-tetor 2013, rezulton se për shkak të ngarkesës tepër të madhe të çështjeve të paraqitura për shqyrtim, si dhe në kushtet kur numri i çështjeve që kam patur në mënyrë të njëkohshme për gjykim, rezulton të kenë qenë 250 dosje, kam qenë i detyruar për planifikimin e zhvillimit të 12 deri në 15 të seancave gjyqësore çdo ditë. Planifikimi i 12 - 15 seancave gjyqësore në ditë, në disa raste edhe 17 seancave gjyqësore, ka pas sjellë edhe lodhje të tejskajshme mendore si dhe në shumë raste mungesë të kohës fizike për t'u marrë me arsyetimin e vendimeve. Së gjashti: Situata familjare e shëndetësore - Shumë raste në vonesa mund të ketë qenë edhe situata shëndetësore përkatëse.

II. Vlerësimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

14. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konstaton se gjyqtari N.C., përgjatë gjykimit të 11 çështjeve civile i atribuohen shkelje të dispozitave procedurale civile, me pasojë zvarritjen e gjykimit të çështjeve duke shpallur dhe depozituar me vonesë në sekretarinë gjyqësore 11 vendimeve.

15. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, lidhur me detyrimin e gjykatave për të realizuar një gjykim brenda një afati të arsyeshëm në vendimin e saj, nr. 12, datë 05.03.2012, shprehet: «Gjykata Kushtetuese thekson se, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 42 si dhe KEDNJ-ja neni 6, vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit, në mënyrë të tillë, që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu dhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm». Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë, që të gjitha subjktet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë

çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen artikulimin e saj edhe në dispozitat procedurale e civile, e konkretisht në nenin 4 të K.Pr.Civile, sipas të cilit «Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme» dhe në nenin 171/a të K.Pr.Civile, sipas të cilit «Gjyka ta ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kérkuara prej saj».

16. Këshilli thekson se jo në çdo rast shkeljet që konstatohen në veprimtarinë e gjyqtarit do të konsiderohen si shkelje që kanë çuar ne humbjen e besimit dhe kreditibilitetit ndaj gjyqtarit apo akte që kanë diskredituar rëndë figurën dhe sjelljen e tij. Që këto shkelje të konsiderohen si tilla duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tilla që kalojnë “kufirin e të arsyeshmes”, dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, duke çuar në cenimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.

17. Nga faktet e parashtruara konstatohet se shkeljet e kryera nga gjyqtari N.C., nuk përbëjnë shkelje të tilla që pasjellin procedimin disiplinor të tij. Gjyqtari rezulton se ka pasur ngarkesë tepër të lartë të çështjeve që ka gjykuar për vitin 2013, ku përfshihen edhe rastet e vendimeve me vonesa në dorëzimin e arsyetuar të tyre. Evidentohet nga statistikat se në gjykatën e Tiranës përfundojnë brenda 1 viti kalendarik rrëth 600-700 çështje, ndërkohë që niveli i vendimmarrjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë përfundon me 250 dosje ngarkesa maksimale.

18. Duke vlerësuar numrin e shkeljeve, natyrën e tyre, llojin e veprimtarisë gjyqësore ku janë kryer këto shkelje, ngarkesën në detyrë të gjyqtarit, Këshilli çmon se gjyqtari ka kryer shkelje të disiplinës së gjyqtarit, por se shkeljet e konstatuara, nuk janë të tilla, nuk janë deri në atë shkallë që të përligji kërkesat përfundimtare të masës disiplinore ndaj tij.

19. Në analizë të sa më sipër, Këshilli arrin në përfundimin se veprimet e gjyqtarit N.C. gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij gjyqësore, të konstatuara nga Ministri i Drejtësisë janë të tilla që nuk ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në atë masë përfundimtare, që vërejtjen me paralajmërim. Për sa më sipër, Këshilli pasi vlerësoi kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, e rrëzoi atë kërkesë me shumicë votash.

20. Bazuar në nenin 26, pika 2 të Ligjit «Për organizmin e Këshilli të Lartë të Drejtësisë», ku është përcaktuar se: «Në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë rrëzon masën disiplinore të propozuar nga Ministri, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të

vendosë një masë më të lehtë», Këshilli procedoi me propozimin e një mase disiplinore tjetër, me të lehtë ndaj gjyqtarit N.C., atë «vërejtjes», masë e cila u rrëzua me shumicë votash.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë bazuar, në nenin 33, të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 «Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë», në nenin 33 të Ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 «Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë», i ndryshuar si dhe në Rregulloren «Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve» miratuar me vendimin nr.137, datë 21.02.2003 i ndryshuar, duke qenë i mendimit se kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, N.C., si dhe kërkesa tjetër e pozuar, janë të pabazuara,

V E N D O S I

1. Rrëzimin e kérkesës së Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masën disiplinore «Vërejtje me paralajmërim», ndaj gjyqtarit N.C..
2. Rrëzimin e kérkesës së Këshillit për dhënien e masës «Vërejtje», ndaj gjyqtarit N.C., gjyqtar në Gjykatën Gjykatën e Rrethit Gjyqësor xxx.
3. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet rregullisht gjyqtarit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin i tij.

U shpall sot, më datë 04.02.2015.

KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË